ISSN 1857-6443

## Moskou Tajms

### Maqedonia në NATO, dështim për Rusinë

Fq.4

## RISOCIALIZIMI NË BURGJE

### Idrizova problem me narkomanët

Fq.5

## Në udhëkryq për dialogun Rajon

Fq.16

# Koha

www.koha.mk

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XIII · Numri 3582 · e martë, 12 shkurt 2019 · -1°c | 7°c · 15 DEN

## KOHA për kulturë

Fq.12-15

EDITORIAL

## Cilësia



Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton edhe cilësinë e ajrit.
Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton dhe cilësinë në arsim dhe në shëndetësi.
Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton edhe cilësinë në zhvillimin ekonomik dhe social.
Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton edhe cilësinë e prurjeve të reja të resurseve që jodomosdoshmërisht duhet të jenë anëtar partie.
Tani ka ardhur koha të flasim për cilësi. Mjaft u morëm me sasi.
Tani ka ardhur koha të flasim për cilësinë e profesorëve nëpër universitete. Për cilësinë e mjekëve nëpër spitale, për cilësinë e gjykatësve në gjyqe, për cilësinë e gazetarëve në media.

Fq.2

AKTUALE

## Çdo e dyta grua ka qenë viktimë e dhunës familjare

Fq.8

RAJON

## Franca nuk bëhet rahat

Fq.17



### HIQEN TABELAT KUFITARE DHE INSTITUCIONALE

# LAMTUMIRE "REPUBLIKA E MAQEDONISË"

**Qeveria e Maqedonisë është institucioni i parë i lartë shtetëror që ka hequr nga godina mbishkrimin "Republika e Maqedonisë" dhe së shpejti ta zëvendësojë me "Republika e Maqedonisë Veriore". Pas 6 muajve do të ndryshohen edhe mbishkrimet e tabelave edhe në pushtetin lokal**

Fq.3

## Kur gropat sanohen me bekatona

*Tetovë, 11 shkurt* - Infrastruktura rrugore vazhdon edhe më tutje të mbetet një ndër problemet kryesore, me të cilën po ballafaqohet Tetova si qytet. Ndër rrugët me të frekuentuara të Tetovës janë dy rrugët që shpijnë për në Spitalin e Tetovës, e të cilat janë në gjendje të rënë për shkak se për vite me radhë nuk janë ndërmarrë masa serioze dhe konkrete për rikonstruimin e këtyre rrugëve nga ana e institucioneve përgjegjëse. I vetmi investim që është bërë nga Komuna e Tetovës në këto rrugë është mbulimi i disa gropave me bekatone, mirëpo kjo nuk është zgjidhje për shkak se këto dy rrugë në masë të madhe janë të shkatërruara. Vozitësit apelojnë që komuna duhet në kohë dhe në mënyrë të rregullt të kontrollojë problemet në infrastrukturë brenda në qytet, sidomos në hapësirat publike që të vërtetojnë dëmtimet...

Fq.7



EDITORIAL

# CILËSIA

Emin AZEMI

**Brrylagjinjtë gjithmonë paaftësinë e tyre do ta shumëzojnë me lojalitet zvarranikësh kundrejt liderit, kurse këtij të fundit i mbetet të shqyrtojë se kush rrotullohet më tepër rreth tij: zvarranikët këpucëlëpirës, apo petritët sypatrembur që rrezikun e nuhasin nga lart**

Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton edhe cilësinë e ajrit.

Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton dhe cilësinë në arsim dhe në shëndetësi.

Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton edhe cilësinë në zhvillimin ekonomik dhe social.

Cilësia e përfaqësimit institucional përcakton edhe cilësinë e prurjeve të reja të resurseve që jodomosdoshmërisht duhet të jenë anëtar partie.

Tani ka ardhur koha të flasim për cilësi. Mjaft u morëm me sasi.

Tani ka ardhur koha të flasim për cilësinë e profesorëve nëpër universitete. Për cilësinë e mjekëve nëpër spitale, për cilësinë e gjykatësve në gjyqe, për cilësinë e gazetarëve në media.

Mirëpo si arrihet cilësia në shoqërinë tonë dhe kush është garantues i cilësisë?

Nëse partitë politike vazhdojnë të jenë në pafundësi matës të cilësisë dhe nëse në këto matje nuk përfshihen edhe njerëz nga shoqëria e gjerë, atëherë në vend se të flasim për cilësi, flasim për meritokraci partiake. Sepse nëpër parti politike ka plot njerëz që janë meritor për ardhjen në pushtet të partisë së tyre. Dhe normalisht që ata meritojnë të shpërblehen. Por, debati këtu fillon të bëhet më i vështirë, sepse meritorët sot i ke gjithkund, prej shoferit e deri te ministri. Problemi nuk qëndron pse dikush punësohet si shofer për meritat e treguara gjatë proceseve zgjedhore, por kryet bëhet bisht në momentin kur lobi i shoferëve në një parti vendos se cilët intelektualë duhet të angazhohen në detyra e funksione të caktuara.

Pra, cilësia e shumëdëshiruar dhe shumëproklamuar, ngadalë ia zë vendin brrylosjes dhe për pasojë na bie që jashtë partive politike të shohim shumë vajza e djem të talentuar, të cilët ose janë pa punë, pasi e kanë kryer universitetin me notë mesatare 9.8, sepse nuk e kanë të afërm asnjë njeri të fuqishëm partiak, ose bëhen gati të shkojnë në ndonjë McDonald's në Gjermani të punojnë për 1300 euro në muaj.

Cilësia nuk arrihet pa reforma brendapartiake.

Cilësia nuk arrihet pa e definuar qartë rolin e një aktivisti partiak dhe një kuadri shkencor e profesional.

Cilësia nuk arrihet pa avancimin shoqëror të gruas shqiptare, e cila vazhdon të margjinalizohet si në shërbimin diplomatik, si në poste dhe organet drejtuese të institucioneve.

Le të na rrojë cilësia që buron nga objektivat e sinqerta të atyre që projektojnë politika kadrovike.

Le të varroset njëherë e përgjithmonë brrylosja e atyre që frikën nga konkurrenca e prezantojnë (kamuflojnë) te lideri si papërshtatshmëri e filanit se 'valla nuk është me neve'. Brrylagjinjtë gjithmonë paaftësinë e tyre do ta shumëzojnë me lojalitete zvarranikësh kundrejt liderit, kurse këtij të fundit i mbetet të shqyrtojë se kush rrotullohet më tepër rreth tij: zvarranikët këpucëlëpirës, apo petritët sypatrembur që rrezikun e nuhasin nga lart.



## BE, RUSIA, SERBIA, KOSOVA....

"SFRJ & JNA, vegjetuan gjatë, në kopshtin e luftës së ftohtë. Ato u zhdukën, vetem kur ra perdja e hekurt bipolare. Me rikthimin e luftës se re të ftohtë, diplomacia serbe po ripozicionohet si tampon zonë e re, mes lindjes dhe perendimit, duke maksimaluzuar interesimin e SHBA dhe te Rusisë. E vetmja negocion me Brukselin- pa zbatuar sanksionet ndaj Moskës; dhe e vetmja synon anëterësimin në BE- pa u anëtaresuar paraprakisht në NATO. Shqiptarët nuk shfrytëzuan tri dekadat e kaluara për pozicionim strategjik dhe u vonuan; si gjithnjë gjatë kthesave të medha historike", shkruan në profilin e tij në Facebook, profesori universitar, Blerim Reka.

## VEÇ FAKTE! 06.02.1999

"Pas shumë presioneve të Grupit të Kontaktit, Serbia e lejon udhëtimin tonë për në Rambuje nga Aeroporti i Prishtinës. Fluturojmë me dy aeroplanë francezë, të porositur nga Presidenti i Francës, Zhak SHIRAK. Në njërin aeroplan janë: Ibrahim RUGOVA, Idriz AJETI, Rexhep QOSJA, Mehmet HAJRIZI dhe Adnan MEROVCI. Këmbëngula tek organizatori i udhëtimit, Ambasadori Gabriel KELLER, që RUGOVA të jetë në të njëjtin aeroplan me anëtarët e UÇK-së. Qëllimi im është t'i relaksoj raportet e tyre deklarativisht të acaruara. Pas pak në aeroplan na u bashkuan: Azem SYLA, Jakup KRASNIQI, Ramë BUJA, Zhak UNCINGER, Shën BËRNS, zyrtar amerikan dhe Florina KRASNIQI.Të tjerët: Fehmi AGANI, Edita TAHIRI, Hydajet HYSENI, Bajram KOSUMI, Veton SURROI, Blerim SHALA, Skënder HYSENI dhe Dukagjin GORANI shkuan me aeroplanin tjetër.



Të dy aeroplanët u nisën nga Aeroporti i Prishtinës në orën 13:30 për të arritur në një aeroport ushtarak të Parisit në orën 16:30. Nga ky aeroport me autobus udhëtuam në qytezën e vogël dhe shumë interesante të Rambujesë. Aty arritëm në orën 18:00.

Hapjen zyrtare të konferencës e bëri Presidenti i Francës, Zhak SHIRAK, i cili pati një fjalim përmbajtjesor, me mesazhin: 'Jemi takuar për paqe dhe këtë do ta arrijmë së bashku!'", ka postuar në Facebook, një pjesë nga libri i tij, Adnan Merovci: "Kështjella e (mos) Marrëveshjes" që do të dal së shpejti nga shtypi.

## NGJASHMËRIA DHE DALLIMI I POLICËVE DHUNUES

"Vitin e kaluar një polic britanik është dënuar për dhunimin e një vajze 13 vjeçare. Por, aktakuza ka përmbajtur 37 vepra penale për të cilat veprime polici u dënua me 25 vite burg.

Rasti i policit britanik ka ngjajshmëri me atë të policit në Kosovë i cili u burgos para disa ditësh. Edhe vajza britanike 13 vjeçare, sikur kjo e Kosovës, ka qenë viktimë e policit nga i cili është kërkuar ndihma. Pra, në të dy rastet vajzat e mitura janë dhunuar nga zyrtarët shtetëror të cilët është dashur të ofrojnë mbrojtje e jo vazhdim të dhunës. Megjithatë, këto dy raste karakterizohen edhe nga nje dallim i madh. Policin britanik e kanë kapur kolegët e tij të cilët i kishin hapur një hetim pa e dijtur ai. Në rastin e Kosovës, sipas të gjitha gjasave, polici nuk do të përfundonte kurrë në burg për shkak të kolegëve të tij", ka shkruar një status në Facebook, studiuesi në Londër, Daut Dauti.

MEDIACitate

## Nuk duhet të frikohemi nga ndryshimi i kufijve

Nuk ka asnjë arsye që të ketë droje nga ndryshimi i kufijve, si një zgjidhje e mundshme mes Kosovës dhe Serbisë – thotë studiuesi në i Shkollës Ekonomike të Londrës dhe i Shkencave Politike, eksperti për Evropën Juglindore, James Ker-Lindsay.

"Nëse deklarata e njëanshme e pavarësisë së Kosovës të vitit 2008 nuk përbën shqetësim në lidhje me politikën ndërkombëtare dhe nuk ka çuar në konflikt, pse duhet që marrëveshja mes të Beogradit dhe Prishtinës të përbëjë shqetësim për opinionit publik ndërkombëtar?", pyeti ai në një intervistë për Tanjugun, duke iu referuar mundësisë së ndryshimit të kufijve. Sipas tij, është e kuptueshme që ka shqetësime në lidhje me ndryshimimin e kufijve, apo ndryshe shkëmbimin e territoreve si një zgjidhjee mundshme, por thotë se ka "argumente të forta" që sugjerojnë se nuk duhet të ekzistojë frikë nga ndonjë konflikt si rezultat i një zgjidhje të tillë.

Bashkësia ndërkombëtare, shton ai, duhet të pranojë çdo zgjidhje mes Serbisë dhe Kosovës, nëse palët dakortësohen, përfshirë dhe shkëmbimin e territoreve. Ker-Lindsay thekson se shumë e shohin idenë e ndryshimit të kufijve dhe shkëmbimin e territoreve me ndjenja të përziera, por është e rëndësishme që udhëheqësit e të dyja palëve të diskutojnë të gjitha opsionet.

"Nëse palët bien dakord, ne duhet t'i pranojmë dhe t'i mbështesim ndërkombëtarisht", tha ai.

Ai shton se nuk ka dyshim se çdo ndryshim kufijsh në Ballkan shihet me nervozizëm, se ka shqetësime që kjo mund të ketë një ndikim negativ në Bosnje. Por sipas tij, kjo nuk ka pse ndodh.

"Nëse Beogradi dhe Prishtina arrijnë një marrëveshje e cila do të pranohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ajo do të jetë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe kështu nuk do të ketë ndonjë pasojë për Bosnjen apo se kjo do të ndikonte në situatën në Bosnje", tha ai.

Profesor Ker-Lindsay beson se arritja e një marrëveshjeje mes Serbisë dhe Kosovës do ta bënte Ballkanin Perëndimor një rajon më të sigurt dhe më të qëndrueshëm.

Ai gjithashtu thotë se zgjidhja e konfliktit midis Maqedonisë dhe Greqisë ka krijuar një "moment pozitiv" në rajon, i cili duhet të përdoret.

"Zgjidhja e çështjes së emrit të shtetit të Maqedonisë është një lajm fantastik për rajonin. Ajo zgjidh një problem që ka ekzistuar për më shumë se 25 vjet. Shumica e atyre që kanë ndjekur zhvillimet në Ballkanin Perëndimor e dinë që ne kemi pasur tre probleme të mëdha. Një prej tyre ishte çështja e emrit të Maqedonisë, tjetri është problemi midis Beogradit dhe Prishtinës, dhe i treti është Bosnja. Marrëveshja mes Athinës dhe Shkupit ka ulur numrin e problemeve në rajon", theksoi ai.

Tani, ai është i bindur, ai duhet t'i kushtojë vëmendje zgjidhjes së dy problemeve të mbetura, në mënyrë që, të themi, të "përfundojmë punën në Ballkanin Perëndimor".

"Zgjidhja e problemit të Kosovës duhet të jetë pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes Athinës dhe Shkupit", shtoi shpjegon analisti britanik.

*(Zëri, 11 shkurt)*

HIQEN TABELAT KUFITARE DHE INSTITUCIONALE

# LAMTUMIRË "REPUBLIKA E MAQEDONISË", MIRË SE VJEN "MAQEDONIA E VERIUT"!

Qeveria e Maqedonisë është institucioni i parë i lartë shtetëror që ka hequr nga godina mbishkrimin "Republika e Maqedonisë" dhe së shpejti ta zëvendësojë me "Republika e Maqedonisë Veriore". Pas 6 muajve do të ndryshohen edhe mbishkrimet e tabelave edhe në pushtetin lokal

Koha Zejnulla VESELI

*Shkup, 11 shkurt* - Nga e hëna "Republika e Maqedonisë" si term i mbetet së kaluarës. Pas hyrjes në fuqi të plotë të Marrëveshjes së Prespës, kur edhe parlamenti Grek i dha dritë jeshile Protokollit për anëtarësimin e vendit në NATO-s, qeveria e kryeministrit Zoran Zaev nga e hëna ka filluar heqjen e mbishkrimeve në të gjitha tabelat kufitare dhe institucionet shtetërore, duke i zëvendësuar me emrin e ri "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Qeveria është institucioni i parë i lartë shtetëror që ka hequr nga godina mbishkrimin "Republika e Maqedonisë", dhe pritet së shpejti të zëvendësohet me tabelën e re " Republika e Maqedonisë Veriore".

Këto ndryshime që pritet të ndodhin shpejt, i konfirmojnë edhe nga kabineti i Qeverisë së Maqedonisë. Me heqjen e tabelës kryesore, zëdhënësi i Qeverisë, Muhamet Hoxha, informon se mbishkrimi që do të vendoset lart në hyrje të Qeverisë a duhet të jetë edhe në gjuhën shqipe, konform Ligjit për gjuhët.

„Shkronjat lartë në hyrjen e Qeverisë së Maqedonisë janë hequr në kuadër të përgatitjeve për përdorimin e emrit të ri kushtetues. Heqja e shkronjave është bërë sot në mëngjes për shkak se parashihet të mbahet aktiviteti përgatitor, gjegjësisht ceremonia e ngritjes së flamurit të NATO-s para godinës se Qeverisë së Maqedonisë", thotë Hoxha. E gjithë kjo sipas tij ndodhi pas hyrjes në fuqi të emrit të ri të vendit, Republika e Maqedonisë së Veriut, që do të thotë se Qeveria dhe institucionet tjera do të fillojnë me zbatimin e obligimeve që burojnë nga Marrëveshja e Prespës. "Në këtë drejtim, Qeveria në seancën e fundit ka formuar edhe një grup pune të përbërë nga përfaqësues prej shumë institucioneve, që do të ketë për detyrë të koordinojë të gjitha aktivitetet që janë obligim, e që dalin nga Marrëveshja e Prespës" thotë Hoxha.

Pas hyrjes në fuqi të emrit të ri të vendit, ministritë përkatëse, organet dhe institucionet shtetërore, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, gjithashtu duhet të bëjnë ndryshimin e tabelave në kalimet kufitare të vendit tonë, përfaqësive diplomatike-konsulore dhe të tabelave në hyrje të institucioneve të larta shtetërore. "Procesi i zbatimit të obligimeve që burojnë nga Marrëveshja e Prespës do të jetë në përputhshmëri me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Maqedonisë, ndërsa në afat prej shtatë ditëve institucionet shtetërore, vendkalimet kufitare dhe përfaqësitë konsullore e diplomatike do të duhet t'i ndërrojnë tabelat me emrin e ri të shtetit – Republika e Maqedonisë së Veriut", thotë Hoxha. Ai nuk pret probleme nga institucionet shtetërore gjatë përdorimit të emrit të ri të shtetit sepse përdorimi i emrit të ri të shtetit do të harmonizohet edhe me Ligjin për përdorimin e gjuhëve që do të thotë se tabelat do të shkruhen në godinat e pushtetit qendror do të jenë edhe në gjuhën shqipe.

"Ndërsa pas 6 muajve do të ndryshohen edhe mbishkrimet e tabelave edhe në pushtetin lokal", njofton zëdhënësi Hoxha. Siç bëhet e ditur, me plotësimin e të gjitha kushteve juridike dhe hyrjes në fuqi që dalin nga Marrëveshja e Prespës, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia do të dorëzojnë letër të përbashkët deri te sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara me çka do të informojnë Antonio Guteresh për datën e hyrjes së marrëveshja në fuqi dhe më ketë i jepet fund kontestit bilateral shumëvjeçar midis këtyre dy vendeve.

## KE PËR DISA DITË DO TË PËRDORË EMRIN "MAQEDONIA E VERIUT"

**Komisioni Evropian po përgatitet për disa ditë të fillojë ta përdorë emrin e ri "Republika e Maqedonisë së Veriut". Pasi të dyja vendet e kanë ratifikuar marrëveshjen, Komisioni Evropian pret të përfundojnë të gjitha procedurat e parapara midis Shkupit dhe Athinës për hyrje në fuqi të përdorimit të emrit të ri në institucionet evropiane. Maqedonia duhet tani t'i njoftojë Kombet e Bashkuara dhe të gjitha organizatat rajonale dhe ndërkombëtare se Marrëveshja e Prespës ka hyrë në fuqi dhe të kërkojë prej tyre ta përdorin termin "Maqedonia e Veriut". Sipas burimeve diplomatike, KE-ja pret njoftim nga Shkupi deri të mërkurën e kësaj jave, paralelisht me njoftimin deri te KB-ja. Megjithatë, disa punë nuk janë sqaruar deri në fund, informojnë nga KE-ja, gjegjësisht është e paqartë nëse ndryshimi i termit do të ndodhë menjëherë apo nëse do të pritet vendimi i Kolexhit të komisarëve apo megjithatë të Këshillit për punë të jashtme të BE-së, të paparë më 18 shkurt, ku me konkluzionet do të mund të miratohet përdorimi zyrtar i emrit të ri nga ana e ministrave të punëve të jashtme të BE-së. Edhe në Këshill edhe në Komision punohet në përcaktimin e procedurave, informojnë nga këto institucione.**

## DOKUMENTET ME EMRIN E RI TË SHTETIT, PAK MË VONË

**Dokumentet e identifikimit mund të nxirren me "Republika e Maqedonisë" edhe pasi të futet në fuqi këtyre ditëve emri i ri kushtetues me shpalljen e tij në Gazetën Zyrtare, sepse MPB ende nuk ka shpallur tender për formularët. Pasaportat, letërnjoftimet, lejet e vozitjes me emrin "Republika e Maqedonisë së Veriut" do të lëshohen në përdorim vetëm në periudhën pasi të përfundojë i tërë procesi i tenderimit dhe do të realizohet furnizimi, ndërsa deri atëherë mbetet procedura aktuale. Zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski për "Meta" është përgjigjur se pasi të dërgohet nota dhe të shpallet në Gazetë Zyrtare, pastaj MPB duhet të shpallë furnizim publik për dokumentet e reja. "MPB duhet të sigurojë pasaporta të reja, dokumente të reja. Nuk ka kufizime për atë nëse qytetarët do të mund të pajisen me dokumente të reja derisa të zgjatë shpallja e furnizimit, sepse do të lëshohen dokumentet sipas procedurës së vjetër, të cilat pastaj do të duhet t'i ndërrojnë në afat prej pesë viteve", është shprehur Boshnjakovski. Për momentin, nuk ka informacione se sa do të zgjasë procedura për sigurim të dokumenteve të reja.**

## Gjorgji Filipov, kandidati i parë i LSDM-së për president

*Shkup, 11 shkurt* - Ish-ambasadori Gjorgji Filipov është kandidati i parë për president të shtetit në konkursin partiak të LSDM-së, që është i hapur deri më 19 shkurt. Ai konsideron se do të jetë president i mirë konsensual edhe pse përmendi se do të ishte më adekuate të përdoret termi kandidat i përbashkët, sepse siç tha, "konsensual" ende nuk është term i definuar qartë, që do të duhej të thotë mbështetje prej 75 për qind të popullatës apo partive politike.

"Do të veproj sipas parimit se jemi një shoqëri. Të gjithë dëshirojnë të jetojnë në paqe dhe siguri, me ajër të pastër dhe të shëndetshëm, arsim cilësor, shëndetësi të mirë", tha Filipov në konferencën e sotme për shtyp. I pyetur përse ka vendosur të kandidojë në konkursin e LSDM-së, e jo të shkojë si kandidat i pavarur apo ndërkaq të lajmërohet në konkursin e VMRO-DPMNE-së, ai theksoi se qëndrimet dhe vizionet e tij ishin më të afërta me ato që për momentin i promovon LSDM për perspektivat euroatlantike të Maqedonisë.

"Përveç që kam vizion për zhvillimin e Republikës së Maqedonisë sipas zgjedhjes sime, kam edhe plan dhe strategji për realizimin e tij", theksoi ai. Filipov është doktor i shkencave teknike. Ishte ambasador në Gjermani prej vitit 2005 deri nëm vitin 2010 dhe në Austri prej vitit 2010 deri në vitin 2014.

## Gruevski nuk ndjehet fajtor për arrestimin e ish-bashkëpunëtorëve

*Budapest, 11 shkurt* - Ish kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski ka dhënë intervistë të re në Budapest për portalin Infomaks. Në pyetjen e parashtruar nëse ndjehet fajtor pasi që në momentin kur ai ka ikur nga Maqedonia, janë arrestuar ish bashkëpunëtorët e tij, ai thotë se nuk ndjehet fajtor.

"Ata duhet të ndjehen fajtor, unë ndjej hidhërim që jam pjesë e kësaj kohe në të cilën në vendin tim, në të cilën kam jetuar, kam punuar dhe kam bërë çdo gjë që të ecë përpara, erdhi një pushtet marionetë, i cili përveç se bëri disa punë tepër negative për identitetin nacional maqedonas, emrin dhe kështu me radhë, pa mëshirë sillet ndaj kundërshtarëve politik, gjë që nuk ka ndodhur që nga vitet e 50-ta të shekullit të kaluar", është shprehur Gruevski.

"MOSKOU TAJMS" PËR MARRËVESHJEN SHKUP-ATHINË

# MAQEDONIA NË NATO, DËSHTIM PËR RUSINË TË CILIN E SHKAKTOI VETË

"E gjithë kjo u shndërruar edhe në një burim irritimi në marrëdhëniet e stërngarkuara midis Rusisë dhe Perëndimit. Tentimi i Rusisë ta kundërshtojë të pashmangshmen vetëm e përshpejtoi zhvillimin e tij, duke shtuar edhe një pikë të përuljes ndërkombëtare për Rusinë dhe duke i shkaktuar dëm interesave të saj në rajon", thuhet në tekstin e Samorukov, të publikuar në "Moskou Tajms"

*Moskë, 11 shkurt* - Mediat botërore flasin për një dështim të ri për Rusinë, duke theksuar se NATO e ka tejkaluar rezistencën ruse dhe përsëri po përhapet në Ballkan, duke e përshëndetur Maqedoninë në radhët e saj, Në fund të përrallës, të gjitha 29 anëtaret e NATO-s, si edhe Greqia - me të cilën kishte më së shumti probleme në këtë tregim - në mënyrë simbolike do ta nënshkruajnë protokollin për anëtarësim, thuhet në tekstin e Maksim Samorukov, redaktor në qendrën Karnegi në Moskë, të publikuar në "Moskou tajms".

"Në mes të kësaj skene idilike, Rusia është lënë ta luaj rolin e zanës së keqe, e cila tentoi ta shkatërrojë celebrimin për të gjithë nga inati, por përjetoi dështim të rëndë. Dhe si në përrallë, fundi fatlum për Maqedoninë dhe NATO-n ishte i dukshëm që në fillim. Megjithatë, Rusia zgjodhi të ndalet në anën e gjykuar për dështim", theksohet në tekst. Autori vlerëson se ky rast tregon se konfrontimi me Perëndimin është i lindur për Rusinë, pa dallim të rezultatit dhe se nëse ka mundësi të poentojë, qoftë kjo pa kuptim dhe e bërë thjeshtë për t'i frustruar të gjithë të tjerët, Moska do ta bëjë atë. "Në stilin e Dostoevskit, sa më shumë që angazhimet janë të pashpresa, aq më i ëmbël është dështimi i vetëshkaktuar", thotë Samorukov.

Ai përkujtoj se kur para 10 vitesh Shqipëria dhe Kroacia u inkuadruan në NATO, ajo ishte pa ndërhyrjen e veçantë të Rusisë dhe se pritej e njëjta të ndodh edhe me Maqedoninë, duke e pasur parasysh atë se Moska "nuk ka ndonjë interes të veçantë dhe as ndikim atje". Por, pasi shpërtheu kriza me Ukrainën në vitin 2014, e cila në mënyrë serioze i prishi marrëdhëniet e Rusisë me Perëndimin, ndërsa në vitin 2015 filluan protesta në Maqedoni kundër qeverisë së kryeministrit të atëhershëm Nikolla Gruvski, Moska si edhe revolucionet e tjera të ngjyrosura, protestat i vlerësoi si vaj i forcave të huaja. "Fakti se BE-ja me vite e lavdëronte Gruevskin si reformator properëndimor nuk e inkurajoi Rusinë, as fakti se kryeministri i atëhershëm dhe VMRO-DPMNE e tij e mbështetën anëtarësimin e vendit në Aleancë", thuhet në tekst.

Samorukov thekson se deklaratat përplot me kritika nga Ministria e Punëve të Jashtme e Rusisë, publikimet gjykuese në mediat ruse me pronë shtetërore, aktiviteti i dyshimtë në mediat sociale dhe vizita në Kremlin nga presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov - cili është i afërt me Gruevskin - ishin të mjaftueshme për ta bindur Perëndimin për përzierjen e madhe të Rusisë në Maqedoni me qëllim të ndryshimit të orientimit gjeopolitik të vendit. Më pas nuk kishte kthim. Perëndimi u mobilizua për t'i ndihmuar koalicionit në pushtet, i përbërë prej socialdemokratëve dhe partive shqiptare, jo vetëm të vijnë në pushtet, por edhe të bëjnë progres të vërtetë në rrugën drejt BE-së dhe NATO-s, u detyrua të fokusohet në pengesën e mbetur për integrimin e Maqedonisë në këto dy trupa - kontestin me Greqinë për emrin e Maqedonisë", thuhet në tekstin në "Moskou tajms".

"Dhe derisa Perëndimi u angazhua fort në ndërmjetësimin midis Greqisë dhe Maqedonisë në këtë kontest, Rusia zgjodhi taktikë që madje edhe teoritikisht nuk lejoi mundësi për sukses. Moska u propozoi të dyja vendeve të mos bëjnë asgjë dhe thjeshtë të presin derisa kjo çështje nuk bëhet pak më e ndjeshme, si edhe njëzet e shtatë vitet e kaluara të mos ishin të mjaftueshme", u potencua në tekst. Në të shtohet se Marrëveshja e Prespës për ndërrimin e emrit nga Maqedoni në Maqedoninë e Veriut është nënshkruar prej të dyja qeverive, ndërsa megjithatë Rusia e kritikon si të papranueshëm, duke iu referuar zemërimit të nacionalistëve në të dyja vendet. Samorukov vlerëson se në kritikat e Moskës ka pasur edhe poenta korrekte, veçanërisht në pjesën e rezultateve të referendumit, në të cilin pati dalje prej vetëm 38 për qind, por prej atyre që e kanë dhënë votën e tyre, mbi 90 për qind votuan pozitivisht. Ai përkujton edhe për sigurimin e shumicës në parlamentet e Maqedonisë dhe Greqisë për marrëveshjen, që u shoqërua me vështirësi.

Qeveria e Maqedonisë e sheh Rusinë si armik, ndërsa opozita e Maqedonisë nuk ka për qëllim të orientohet drejt Moskës dhe të vazhdojë ta mbështesë hyrjen e Maqedonisë në NATO. Vendi do t'i bashkohet Aleancës shumë më shpejtë se që mund të ëndërronin njerëzit. "E gjithë kjo u shndërruar edhe në një burim irritimi në marrëdhëniet e stërngarkuara midis Rusisë dhe Perëndimit. Tentimi i Rusisë ta kundërshtojë të pashmangshmen vetëm e përshpejtoi zhvillimin e tij, duke shtuar edhe një pikë të përuljes ndërkombëtare për Rusinë dhe duke i shkaktuar dëm interesave të saj në rajon", thuhet në tekstin e Samorukov, të publikuar në "Moskou Tajms".

AMBASADORI RUS NË ATHINË

## Anëtarësimi në NATO nuk mund të jetë faktor i stabilitetit

*Athinë, 11 shkurt* - Integrimi edhe i një vendi në NATO pa dyshim nuk mund ta përforcojë stabilitetin dhe sigurinë në Ballkan, thotë ambasadori rus në Greqi, Andrej Maslov në intervistën për portalin informativ "Sputnik". Ambasadori i Rusisë sqaron se ata si anëtar i përhershëm i Këshillit të Sigurimit konsiderojnë se janë shkelur qartësitë ligjore në procesin e miratimit të marrëveshjes, lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina. Maslov shton se të dyja palët kanë arritur deri në marrëveshje, kanë gjetur emër të ri dhe kjo është çështje që ka të bëjë në të dyja palët "dhe duket se nuk ka asgjë të keqe në të". "Problemi, megjithatë është se procesi i zyrtarizimit të marrëveshjes ishte me shkelje serioze në të drejtën ndërkombëtare të njërit nga vendet. Referendumi për emrin atje ishte i pasuksesshëm. Edhe krahas kësaj, procesi i ratifikimit e injoroi verdiktin e pjesës më të madhe të popullatës në vend. Rusia si anëtare e përhershme e Këshillit të Sigurimit të KB-së -ndërsa edhe emri gjithsesi është në agjendën e Këshillit të Sigurimit nga viti 1993 - e thekson faktin se ishin shkelur qartësitë ligjore të proceseve për miratimin e marrëveshjes. Dhe gjithsesi, siç thash, pranim të tillë të përshpejtuar dhe të furishëm të vendit ballkanik në NATO nuk mund të jetë faktor i stabilitetit", thotë Maslov në intervistën për "Sputnik", transmeton MIA.

ESHS TËRHIQET NGA PLANI PARAPRAK

# Përkatësia etnike në duar të Parlamentit

*Shkup, 11 shkurt* - Zgjidhja përfundimtare për atë se cilat pyetje do të përfshihen në Regjistrimin që duhet të realizohet në vitin 2020, do ta sjellë Parlamenti i Maqedonisë së Veriut me miratimin e Ligjit për Regjistrim 2020. Kështu thonë nga Enti Shtetëror i Statistikës, ndërsa i hedhur poshtë si spekulime të gjitha pohimet se Regjistrimi i ardhshëm i popullatës do të jetë pa pyetjen për përkatësinë etnike janë spekulime. Në njoftimin e Entit Shtetëror të Statistikës qëndron se, në procesin e përpilimit të Regjistrimit të ardhshëm të popullatës, amvisërive dhe banesave në "Maqedonia 2020", gjithçka do të përfshihet. Enti Shtetëror i Statistikës vitin e kaluar ka filluar debat të gjerë publik lidhur me zgjidhjet e propozuara për pyetjet që do të përfshihen në Regjistrimin, por edhe për aspektet organizative-teknike të Regjistrimit të ardhshëm. "Në këto debate, ESHS si institucion profesional nga fusha e statistikës dhe e vetme kompetente për zbatimin e Regjistrimit të popullatës, i ka dhënë propozimet e veta mes të cilave edhe propozimin që formulari i regjistrimit të mos e ketë të përfshirë pyetjen për përkatësinë etnike. ky propozim është përfshirë edhe në Propozim-ligjin për Regjistrim, që ishte vendosur në debat publik, ndërsa edhe dorëzuar deri te të gjitha institucionet relevante për vërejtje dhe sugjerime", theksojnë nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Në ndërkohë, në disa deklarata të mëparshme, drejtori i ESHS-së kishte thënë se "pyetja për përkatësinë etnike nuk do të përfshihet në regjistrim, por vetëm gjuha të cilën e flasin qytetarët". Kjo kishte ngjallur reagime të shumta kryesisht nga shqiptarët, të cilët kishin akuzuar se ESHS po përpiqet të fsheh numrin real të shqiptarëve në Maqedoni.

RISOCIALIZIMI NË BURGJE ASSESI TË FUNKSIONOJË

# IDRIZOVA PROBLEM ME NARKOMANËT

I burgosuri i fundit, i cili ndërroi jetë gjatë vikendit - vjen nga kategoria e të dënuarve që janë pranues të terapisë së metadonit. I ndjeri ka konsumuar ilaçe më tepër se sa duhet dhe si rezultat i mbidozës, ai ka ndërruar jetë. Për arsye gati të njëjta, si pasojë e mbidozës - javë më parë ndërroi jetë edhe një i burgosur tjetër

Koha Omer XHAFERI

*Shkup, 11 shkurt* - Rreth 150 persona që vuajnë dënime me burg në burgun e Idrizovës, e që janë të varur nga substancat narkotike, vazhdojnë të paraqesin problem serioz për këtë Institucion ndëshkuese përmirësues (INP). Pavarësisht se me këtë institucion deri më tani kanë udhëhequr drejtorë të ndryshëm, asnjëri prej tyre nuk ka arritur të gjej formulën përfundimtare se si të zgjidhet problemi me të këtë kategori të të burgosurve. Rasti i fundit, i cili u regjistrua në këtë burg ishte tentimi për ndezjen e repartit ku janë të vendosur të burgosurit që pranojnë terapi metadoni. Si rezultat i intervenimit të shpejtë të Njësive të zjarrfikësve, flaka e zjarrit është lokalizuar shpejtë dhe një pjesë e tavanit të ndezur në burgun e Idrizovës është shuar.

Zëvendësdrejtori i burgut të Idrizovës, Femi Jonuzi, për gazetën KOHA, thotë se zjarri i fundit në Idrizovës është izoluar menjëherë, gjegjësisht dy prej të burgosurve të përfshirë në këtë skenar (pranues të terapisë së metadonit) janë vendosur në dhomat e vetmisë.

"Po ashtu, i burgosuri i fundit i cili ndërroi jetë gjatë vikendit vjen nga kjo kategori e të burgosurve që janë pranues të terapisë së metadonit. Pas pranimit të terapisë, i ndjeri me vetë dëshirë ka pranuar barna, ka konsumuar ilaçe më tepër se sa duhet dhe si rezultat i mbidozës, ai ka ndërruar jetë. Për arsye gati të njëjta, si pasojë e mbidozës - javë më parë ndërroi jetë edhe një i burgosur tjetër", shprehet Jonuzi, i cili shton se për të gjitha ngjarjet në Idrizovë, me kohë informohet institucionet përkatëse siç është MPB, Prokuroria Publike, Instituti i mjekësisë ligjore e kështu me radhë.

Në mesin e shumë vërejtjeve që i dedikohen burgjeve në Maqedoni, pa dyshim janë kushtet në të cilët të burgosurit i vuajnë dënimet e tyre. Ndërkohë, edhe pse shqiptimi i masave ndëshkuese sipas normave ligjore parashihet të jetë një masë për risocializimin e të burgosurve, në sistemin penitenciar në Maqedoni, vite me radhë mungon koncepti i shëndoshë i risocializimit. Ky qëndrim ndonëse theksohet në çdo raport të Avokatit të Popullit dhe organizatave tjera për të drejtat të njeriut, më mirë mund të vërehet nga numri i lartë i të burgosurve recidiv (përsëritës të veprave penale).

Me qëllim zbutjen dhe përmirësimin e kushteve të të burgosurve, vitin e kaluar në burgun e Idrizovës u hap godina e re, ku deri më tani janë vendosur një pjesë e të burgosurve. Megjithatë, në këtë pjesë të burgut, siç njoftojnë nga udhëheqësia e këtij burgu, ka ende hapësirë për vendosjen e të burgosurve tjerë.

"Ambulanca e burgut javë më parë u furnizua me batanije dhe pajisje tjera, të cilët kryesisht janë në shërbim të të burgosurve që janë pranues të terapisë së metadonit. Brenda kohës po bëhet përpjekje për përmirësimin e kushteve në përgjithësi. Pjesa e re e burgut të hapur tashmë është lëshuar. Gjatë javëve në vazhdim do të fillojmë me transferimin e burgosurve tjerë në pjesën gjysmë të hapur. Me këto veprime mendojmë të krijojmë më tepër hapësirë për të burgosurit tjerë që do të mbesin në pjesën e mbyllur të burgut", thekson Jonuzi.

Ndryshe, në shkurt të vitit të kaluar, Parlamenti i Maqedonisë e miratoi Ligjin për amnisti të një pjesë të të burgosurve. Ky proces i amnistisë i përfshiu mbi 800 të burgosur, një pjesë e të cilëve u lirua plotësisht dhe pjesës tjetër të të dënuarve dënimet ju zvogëluan për 30 për qind. Sidoqoftë, edhe pse kjo masë e Qeverisë ndikoi në shkarkimin e burgjeve, sipas njohësve të rrethanave, institucionet relevante duhet në vazhdimësi të përcjellin situatën në Institucionet Ndëshkuese Përmirësuese.

FEMI JONUZI

**Ambulanca e burgut javë më parë u furnizua me batanije dhe pajisje tjera, të cilët kryesisht janë në shërbim të të burgosurve që janë pranues të terapisë së metadonit. Brenda kohës po bëhet përpjekje për përmirësimin e kushteve në përgjithësi. Pjesa e re e burgut të hapur tashmë është lëshuar. Gjatë javëve në vazhdim do të fillojmë me transferimin e burgosurve tjerë në pjesën gjysmë të hapur. Me këto veprime mendojmë të krijojmë më tepër hapësirë për të burgosurit tjerë që do të mbesin në pjesën e mbyllur të burgut**

## Fundjava në Shkup me 22 aksidente, dy të lënduar rëndë

*Shkup, 11 shkurt* - Dy persona janë lënduar rëndë, ndërsa nëntë më lehtë në gjithsej 22 aksidente që kanë ndodhur në fundjavën e kaluar në rajonin e SPB Shkup. Në 11 aksidente është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se këtë fundjavë policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër i madh i kundërvajtjeve. Janë sanksionuar 194 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, 15 shoferë të cilët kanë kaluar në udhëkryq në dritë të kuqe, shtatë shoferë të cilët nuk kanë dhënë përparësi të kalimit të këmbësorëve në vendkalimin e shënuar për këmbësorë, katër shoferë për renditje të parregullt, një shofer për parakalim të parregullt, 10 shoferë për mosposedim të pajisjes dimërore në automjet, 20 shoferë për mosmbajte të rripit të sigurimit dhe 44 shoferë kanë shfrytëzuar celularë gjatë drejtimit të automjetit. Janë sanksionuar 229 automjete të parkuara në mënyrë të paregullt, ndërsa me automjetin special "karrotrec" janë larguar 154 automjete. Nga trafiku janë përjashtuar 30 shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, 29 shoferë para se ta marrin të drejtën e drejtimit të automjetit, katër shoferë fillestarë, si dhe 30 automjete të paregjistruara dhe një automjet teknikisht i parregullt.

## KRONIKË

### Plagosje me thikë në Padalishtë

Të dielën rreth orës 18.00, në Spitalin e përgjithshëm "Ferid Murad" në Gostivar, është pranuar 35 vjeçari F.M. nga fshati Padalishtë, me plagë thike në krahun e majtë, të cilën ja ka shkaktuar 41 vjeçari B.S. nga i njëjti fshat. Deri te lëndimi i personit F.M. ka ardhur pas një zënke verbale, që ka ndodhur paraprakisht mes dy minorenëve, familjarë të personit B.S, i cili menjëherë është privuar nga liria, ku është mbajtur në stacionin policorë në Gostivar për procedurë të mëtutjeshme, gjegjësisht deri në zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të rastit.

### Lëndohet në një objekt ndërtimi

Në Spitalin e përgjithshëm "Ferid Murad", dje rreth orës 08 e 30 minuta, është pranuar 49 vjeçari E.H. nga Gostivari, i cili duke hyrë në një objekt, respektivisht në ndërtesë banimi në ndërtim e sipër, në të cilën ka punuar dhe duke shkelur në dru, ka rënë dhe ka marrë lëndime të rënda trupore - frakturë në nyjën e këmbës së djathtë.
Pas dhënies së ndihmës mjekësore, i njëjti është dërguar në Klinikat e Shkupit. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes ku është lënduar personi E.H. dhe rasti është duke u zbardhur.

### Dënime për lokalet me muzikë të lartë

Pjesëtarët e policisë së Tetovës, të dielën pas mesnate kanë kryer kontroll të zhurmës në dy objekte hotelerike, me lokacion në rrugën "Dimo Gavroski" në Tetovë, pronë e 42 vjeçarit D.Z. nga fshati Falisht dhe 41vjeçarit A.A. nga Tetova. Gjatë kontrollit, me anë të fonometrit janë matur 10, gjegjësisht 20 decibel muzikë më e zhurmshme nga maksimalja e lejuar dhe pronarëve të këtyre dy objekteve, do t`iu përgatiten gjoba adekuate, në pajtueshmëri me Ligjin për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike. *(U.H)*

SHLYERJA E KAMATAVE

# JO VETËM PËR NDËRMARRJET SHTETËRORE, POR EDHE PRIVATE

Një pjesë e sindikalistëve kërkojnë që shlyerja e borxheve të vlejë njësoj si për ndërmarrjet në pronësi të shtetit, ashtu edhe ato private, ku duhet në bazë të ligjit, që qytetarët menjëherë të lirohen nga këto harxhime të panevojshme

Koha Fisnik PASHOLLI

*Shkup, 11 shkurt* - Pas miratimit në Kuvend të Ligjit për faljen e kamatave në emër borxheve të vjetra për shërbime komunale , nga fillimi i muajit dhjetor, edhe në praktikë filluan të vlejnë dispozitat e reja ligjore. Qytetarët janë të liruar prej kamatave ndëshkuese të llogarive të vjetra për shërbimet komunale, por vetëm për kompanitë në pronësi të shtetit. Me fjalë të tjera, për të gjitha vendimet e lëshuara për realizim , nga ana e gjyqit deri më datën 25 maj të vitit 2006, ndërsa të përfunduara, dhe të bartura në noter apo përmbarues , duhet që qytetarët të lirohen nga kamatat dhe harxhimet e përmbarimit.

Bëhet fjalë për kamatat ndëshkuese për borxhet e ngrohjes, rrymës, ujit, telefonisë fikse dhe celulare, ujitjen si dhe mirëmbajtjen e hapësirave të përbashkëta. Ndërmarrjet komunale të ujit, bie fjala, apo ndërmarrjet e tjera publike, janë të obliguara që vetë të shlyejnë borxhet e kamatave ndëshkuese, ndërsa kompanitë private që kanë detyrime prej qytetarëve , do të duhet vetë të vendosin se a do të shlyejnë borxhet të qytetarëve. Të drejtën e shlyerjes së borxhit, sipas ligjit, mund ta realizojë çdo borxhli që do të shlyejë borxhin kryesor dhe harxhimet e tjera në procedurë pre 12 muajsh prej ditë së shpalljes së vendimit të këshillit drejtues së debitorit. Të drejtën e shlyerjes së kamatës, borxhliu apo personi fizik e realizon me parashtrimin e kërkesës deri tek debitori. Ndaj kërkesës ai parashtron edhe dëshminë për pagesën e realizuar të borxhit kryesor. Debitori në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të dëshmisë së pagesës, është i obliguar me shkrim ta informojë me letër rekomandimi, në adresën e regjistruar të borxhliut, për miratimin e tërësishëm, të pjesërishëm apo për refuzimin e shlyerjes së borxhit. Për shlyerjen e borxhit nevojitet që në afat deri më tetë ditë të informohet edhe noteri apo përmbaruesi, tek i cili ka qenë i transferuar vendimi për realizim i lëshuar nga gjyqi, se është paguar borxhi kryesor, është shlyer kamata, andaj kërkohet ndalimi i procedurës në noter apo përmbaruesi. Në ndërkohë, dy muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, ai zbatohet pjesërisht nga kompanitë. Një pjesë e sindikalistëve kërkojnë që shlyerja e borxheve të vlejë njësoj si për ndërmarrjet në pronësi të shtetit, ashtu edhe ato private, që nuk duhet vetë të vendosin për anulimin e kësaj ngarkese të madhe për qytetarët, por duhet në bazë të ligjit, që qytetarët menjëherë të lirohen nga këto harxhime të panevojshme.

"Kërkojmë që ligji të mos varet nga vullneti i mirë i kompanive private, ndërsa qeveria nevojitet të intervenojë me qëllim që ligji të vlejë për të gjithë kompanitë shtetërore, dhe private njësoj", thotë Marjan Ristevski nga Konfederata e Organizatave Sindikale të Maqedonisë. Sipas tij, nevojitet që sa më shpejt të miratohet edhe çmimorja e re me qëllim, që përmbaruesit të mos paguajnë akoma kosto të lartë të punës së tyre.

Njohësit e kësaj problematike shpjegojnë se bëhet fjalë për një problem me të cilin , qytetarët ballafaqohen që nga viti 2011, kur lëndët ekzekutive nga gjyqet janë transferuar në noter dhe përmbarues, ndërsa qytetarët u rënduan me kamata të mëdha për lëndët, për të cilat shpesh as nuk e kanë ditur se ekzistojnë , dhe as që ka propozime për pagesë të dhunshme. Para tetë vitesh, spekulohej se bëhet fjalë për 100 mijë deri 100 mijë lëndë, ndërsa jo zyrtarisht flitet së bëhet fjalë për 150 mijë lëndë të plotfuqishme që gjenden në gjyq për zbatim.

## Kumanova, qyteti më i ndotur në Maqedoni

*Kumanovë, 11 shkurt* - Dje dhe parmbrëmë Kumanova ishte qyteti më i ndotur në Maqedoni. Niveli i grimcave PM 10 për momentin janë shumëfishuar dhe janë 242 mg/m3. Mbrëmë, ishin edhe më të larta dhe lëvizniin prej 411 deri në 380 mg/m3. Në orët e vona të mbrëmjes në Kumanovë kundërmonte erë tymi, por shpërndahej edhe erë specifike. Qytetarët kërkojnë nga autoritetet kontrolle të përforcuara inspektuese. Paraprakisht në disa raste gjatë vitit, komuna ka kryer aeroizolim. Në ditët e kaluara NP "Pastrim dhe Gjelbërim" i pastronte rrugët në orët e mbrëmjes, që është gjithashtu pjesë e masave për uljen e ndotjes së ajrit.
Në mesin e masave urgjente të jashtëzakonshme është edhe mbjellja e fidanëve dhe kontrolle të përforcuara inspektuese, që në njërën nga fidanët i sollën këshilltarët, ndërsa shumë shpesh janë kërkesë e qytetarëve. Periudhën e kaluar ishin mbjellë fidanë në disa lokacione të lagjes "Karposh" dhe "Tode Mendol". Por, edhe krahas këtyre masave të ndërmarra afatshkurta dhe afat mesme për uljen e ndotjes së ajrit, Kumanova mbrëmë ishte qyteti më iu ndotur në Maqedoni.
Sipas qytetarëve, gazifikimi i amvisërive dhe konsumatorëve të mëdhenj është kyç për uljen e ndotjes së ajrit. Komuna ka subvencionuar 10.000 denarë për secilën amvisëri e cila do të përfshihet në rrjet, ndërsa sipas paralajmërime të fundit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe spitalit ku është locuar edhe stacioni matës, do të gazifikohet.

FIRMOSET PROJEKTI NË VLERË 13 MILIONË EURO

# GJINEKOLOGJIA E ÇAIRIT NUK DO TA NDOTË MË AJRIN

*Shkup, 11 shkurt* - Spitali i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Çair nuk do të jetë më ndotës i ajrit. Gazeta KOHA merr vesh se Ministria e Shëndetësisë më 8 shkurt ka nënshkruar një projekt për vendosjen e një kaldaje të re në vlerë prej 13 milionë denarë, si parakusht teknik për përhapjen e tymit në ambient të hapur.

Këtë e konfirmoi edhe njeriu i dytë i kësaj ministrie, Asim Musa, i cili i hodhi poshtë të gjitha spekulimet se gjoja ky spital do të mbyllet nga ana e autoriteteve të Qytetit të Shkupit, si pasojë e ndotjes së ajrit. Megjithatë, Qytetit të Shkupit deri më tani nuk ka marrë ndonjë

njoftim zyrtar për këto veprime të Ministrisë së Shëndetësisë dhe presin që Spitali i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Çair përfundimisht të pajiset me kaldanë e re, e cila do të ishte një zgjidhje për parandalimin e tymrave nga oxhaqet e këtij spitali.

Zëdhënësi i Qytetit të Shkupit, Valon Saliu, ka ndjekur nga afër problemin dhe pret që autoritet kompetente, si të spitalit ashtu edhe të ministrisë përkatëse të veprojnë konform standardeve. Në Spitalin e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Çair janë të vetëdijshëm për pasojat që shkaktojnë tymrat që dalin nga oxhaqet e spitalit, andaj ata presin që në një afat të shkurtër të ndërrohe kaldaja, si pjesë enjë projekte që shkon përmes Ministrisë së Shëndetësisë. Zëdhënësi i këtij spitali, Ilir Shurdhani na njofton se po punohet që spitali të funksionojë normalisht, kurse furnizimi me ujë të ngrohtë për 4000 nënat dhe 4000 foshnjat të rrjedhë normalisht edhe pas ndërrimit të kaldajave.

Sikundër dihet, në këtë spital ka tre vite që oxhaqet punojnë pa filtra, sepse asnjë kompani nuk e ka marrë përsipër të garantojë për mirëfunksionimin e tyre. Spitali punon me të njëjtin sistem për ngrohje që kur është ndërtuar në vitin 1954. Mirëpo në të ardhmen ky problem do të tejkalohet falë angazhimit të zv.ministrit të Shëndetësisë, Asim Musa, i cili si prioritet në punën e tij ka pasur këtë projekt që përfundimisht do të parandalojë tymosjen nga oxhaqet e Spitalit Obstretrik dhe Gjinekologjik të Çairit. *(D.K)*

RRUGËT E SHKATËRRUARA NË TETOVË

# KUR GROPAT SANOHEN ME BEKATONA

Nga Komuna e Tetovës arsyetohen se mbulimi i gropave me bekatona është bërë për shkak se ende nuk janë hapur bazat e asfaltit, ndërsa premtojnë se me fillimin e pranverës, do të fillojë sanimi i rrugëve me asfalt

Koha Urim HASIPI

*Tetovë, 11 shkurt* - Infrastruktura rrugore vazhdon edhe më tutje të mbetet një ndër problemet kryesore, me të cilën po ballafaqohet Tetova si qytet. Ndër rrugët me të frekuentuara të Tetovës janë dy rrugët që shpijnë për në Spitalin e Tetovës, e të cilat janë në gjendje të rënë për shkak se për vite me radhë nuk janë ndërmarrë masa serioze dhe konkrete për rikonstruimin e këtyre rrugëve nga ana e institucioneve përgjegjëse. I vetmi investim që është bërë nga Komuna e Tetovës në këto rrugë është mbulimi i disa gropave me bekatone, mirëpo kjo nuk është zgjidhje për shkak se këto dy rrugë në masë të madhe janë të shkatërruara.

Vozitësit apelojnë që komuna duhet në kohë dhe në mënyrë të rregullt të kontrollojë problemet në infrastrukturë brenda në qytet, sidomos në hapësirat publike që të vërtetojnë dëmtimet dhe në kohë të sanohen. Sipas vozitësve, kjo dukuri nuk është e panjohur në qytetin e Tetovës, pasi shpeshherë gropat që duhet të sanohen - me ditë të tëra qëndrojnë të prera dhe mbulohen me asfalt me shumë vonesë, ndërkohë ata kanë shumë vështirësi, por edhe dëmtojnë automjetet e tyre. Këtë gjendje edhe më tepër e rëndon parkimi i veturave, të cilat në mënyrë jo të rregullt parkohen përgjatë këtyre dy rrugëve dhe për pasojë - pengojnë si qarkullimin e automjeteve, por edhe të këmbësorëve, prandaj qytetarët apelojnë që autoritetet përkatëse të vënë dorë edhe në këto rrugë.

Në një përgjigje me shkrim nga Komuna e Tetovës thonë se mbulimi i gropave me bekatona është bërë për shkak se ende nuk janë hapur bazat e asfaltit. "Arsyeja e mbulimit të gropave në të gjitha rrugët me bekatona është preventive, derisa të hapen bazat e asfaltit dhe të hyjmë në sezonin e pranverës që të mund të fillojmë me asfaltimin. Pra, kjo është masë e përkohshme që është ndërmarrë dhe menjëherë sa të lejojnë kushtet klimatike, do të fillohet edhe me rikostruimin, por edhe me sanimin e gropave", thonë nga shërbimi për informim në Komunën e Tetovës.

Në ndërkohë, nga Sektori për Tokë Ndërtimore dhe Komunikacion në Tetovë kanë thënë se është hapur tenderi dhe pritet që muajin e ardhshëm të fillohet me sanimin e gropave. "Janë ndarë mjetet e nevojshme për sanimin e gropave në rrugët e qytetit dhe në rrugët tjera që janë në kompetencë të Komunës së Tetovës. Kur të lejojnë kushtet, do të fillohet me mbushjen e këtyre gropave dhe kjo është në bazë të programës për punë për këtë vit", thonë nga ky sektor. E njëjta situatë paraqitet edhe në rrugën mbi Gjykatën Themelore të Tetovës, ku edhe kjo rrugë edhe pse më pak e frekuentuar, në masë të madhe është e amortizuar dhe prej vitesh është kthyer në një shqetësim për drejtuesit e automjeteve dhe këmbësorët që kalojnë atypari pasi të njëjtët janë të detyruar të kalojnë nëpër gropat e shumta. Ajo që është më problematike, në vazhdimësi gropat hapen në ato rrugë edhe ku janë asfaltuar jo më shumë se një vit, siç është rruga nga Shkolla e Muzikës e deri tek stadiumi i qytetit, ku sërish hasen gropa.

Situata e këtillë përsëritet gati se çdo vit pas shkrirjes së borës. Edhe pse çdo pushtet lokal në Tetovë ka ndarë mjete për sanimin e gropave, megjithatë të njëjtat janë prezente në çdo rrugë dhe njëkohësisht befasojnë vozitësit ngase mungojnë edhe paralajmërimet se rruga është e dëmtuar apo e njëjta është me gropa.

## Pollogu kryeson me leje ndërtimi

*Shkup, 11 shkurt* - Janë dhënë 292 leje për ndërtim në dhjetor vitin e kaluar, ose 13.6 për qind më shumë në raport me muajin dhjetor 2017, ka bërë të ditur Enti Shtetëror për Statistikë (ESHS). Sipas lejeve të dhëna për ndërtim, vlera e paraparë e objekteve në dhjetor vitin e kaluar arrin 8.519.871.000 denarë, ose për 392.4 për qind më shumë se në dhjetor të vitit 2017.

Nga numri i përgjithshëm i lejeve për ndërtim, 172 (58.9 për qind), u dedikohet objekteve të ndërtimeve të larta 42 (14,4 për qind) për objekte të ndërtimeve të ulëta dhe 78 (26.7 për qind) për objekte për rikonstruim. Nga gjithsej 292 objekte, 185 (63.4 për qind) si investitorë paraqiten persona fizik, ndërsa në 107 (36,6 për qind) investitorë janë subjekte biznesore.

Në raport është paraparë ndërtim i 331 banesave me sipërfaqe prej 37.669 metra katrorë. Më shumë banesa, 161 do të ndërtohen në rajonin Jugperëndimor, në Strugë 98 dhe Ohër 58. Në rajonin e Pollogut do të ndërtohen 51 banesa, në atë Juglindor 43, në rajonin e Shkupit 38...

GOSTIVARI SHËNOI "DITËN PA MAKINA"

# PA MAKINË NË PUNË

*Gostivar, 11 shkurt* - Me iniciativë të kryetarit Arben Taravari, Komuna e Gostivarit në bashkëpunim me Stacionin policor dhe organizatat joqeveritare, ka realizuar aktivitetin "Dita pa makina", që ka për qëllim ndërgjegjësimin e qytetarëve për zvogëlimin e ndotjes së ajrit ambiental. Në kuadër të këtij aktiviteti prej në ora 12:00 deri në ora 15:00 është ndaluar trafiku në pjesën qendrore të qytetit, ndërsa kryetari i komunës dhe administratorët komunalë në punë erdhën sot pa makina.

Në deklaratën për media, kryetari Arben Taravari theksoi se qëllimi i këtij aktiviteti është zvogëlimi i ndotjes së ajrit si një nga synimet kryesore për këtë mandat katërvjeçar.

"Mbetem i përkushtuar të realizojë tre nga synimet e përcaktuara për këtë mandat, respektivisht zvogëlimin e ndotjes së ajrit, zgjidhjen e problemit me deponinë dhe uji i filtruar për pije. Në lidhje me ajrin e ndotur, inspektorët tanë kanë qenë aktiv në terren dhe në pjesën ku kompetencat i ka Komuna e Gostivarit është gjithçka në rregull. Krahas kësaj jemi duke përgatitur një plan aksional për aerondotjen, ku do t'i përfshijmë edhe organizatat joqeveritare të cilat në fokus të veprimtarisë së tyre kanë mbrojtjen e mjedisit jetësor. Njëherit kemi aplikuar në një projekt me bashkëpunim ndërkufitar me një Bashki të Shqipërisë për aplikimin e trafikut urban në Gostivar dhe shpresojmë që ai të miratohet, me çka dukshëm do të zvogëlohej aerondotja", theksoi kryetari Taravari. Ai nënvizoi se ndonëse kemi ajër të ndotur në periudha të caktuara të vitit, siç ishte sidomos rasti gjatë muajit janar, megjithatë Gostivari nuk është në majën e listës së qyteteve të ndotura në nivel të vendit. (U.H)

MUNGESA E TOLERANCËS NDAJ GJINISË MË TË BUTË

# ÇDO E DYTA GRUA KA QENË VIKTIMË E DHUNËS FAMILJARE

Zbatimi i dhunës, përveç se mund të sjell deri te pasoja serioze shëndetësore ose psiqike, pasojat më të mëdha i shkaktojnë tek fëmijët-dëshmitarë, të cilët e durojnë atë dhe tek të cilët mund të vjen deri të shkatërrimi emocional dhe ndryshimi në sjellje, theksohet në faqen e Organizatës botërore të shëndetësisë

Koha — Qefsere ABDYLI

*Shkup, 11 shkurt* - Kur flitet për dhunën ndaj gruas, zakonisht kjo asocon te dhuna fizike. Por psikologët thonë që dhuna e parë dhe më e shpeshtë me të cilën ballafaqohen gratë në shoqërinë tonë është dhuna psiqike. Njëkohësisht, kjo lloj dhune mund të jetë si prag për llojet tjera të dhunës. Në rendin tonë shoqërinë ende vazhdon stili patriarkal i komuniteteve familjare. Në këto lloje të familjeve, gruaja ka një rol të varur, nuk ka aq shumë të drejta dhe mendimi i saj nuk respektohet. Ndoshta tingëllon çuditshëm të flitet për këto lloje të temave në një shoqëri moderne, por sipas psikologëve, në hapësirat tona në komunikim të përditshëm mund të vërehet që ende ekzistojnë mendime nga ky lloj i veprimit shoqëror.

"Pa dyshim fokus të veçantë duhet t`i japim edhe dhunës psikologjike. Në media shpesh flitet për dhunën fizike dhe parandalimin e saj, por fitohet përshtypje që një pjesë e madhe e shoqërisë tonë ka tolerancë ndaj dhunës psikologjike duke e nënvlerësuar seriozitetin e saj, në veçanti në zonat rurale ose te familjet e prekura nga gjendja sociale. Për fat të keq, edhe në kohën moderne në të cilën jetojmë, ende në kontekste të përcaktuara mbahen vlerat 'patriarkale' dhe qëndrimi që roli i gruas është të shërbejë dhe të durojë, e cila sigurisht është e papranueshme. Mes të tjerave, shpesh segmente të dhunës psikologjike, sigurisht në një konotacion të ndryshëm dhe tjetër kontekst, të imponuara në mënyrë suptile, edhe në mënyrën e shprehjes së humorit të popujve të Ballkanit, ndërsa besoj që ajo mund të kontribuojë për detektim dhe tolerancë të vështirësuar të të njëjtave", thotë Jasmina Jonuz, magjistër për psikologji këshilluese.

Kur në përditshmëri vërehen komente negative, sharje ose lloje tjera të komenteve të papërshtatshme kur bëhet fjalë për marrëdhënien e përditshme mes burrit dhe gruas, atëherë mund të konstatohet që ende vazhdojnë atë vlerat "patriarkale". Disa nga njerëzit, burra ose gra, nuk e kuptojnë që ajo përfaqëson një lloj dhune. Por problemi thellohet kur çdo ditë e më shumë pranohen këto vlera dhe bëhen standard i rregullt i sjelljes. Sipas rezultateve të hulumtimit "Jeta në hije", dhuna psikologjike me një vëllim prej 56 për qind ka vëllim më të lartë të dhunës së raportuar dhe çdo e dyta grua ka qenë viktimë e atij lloji të dhunës familjare (ECE, 2006). Hulumtimi i realizuar në vendet e Ballkanit Perëndimor ka treguar që 40 për qind të grave vuajnë nga dhuna fizike, ndërsa mbi 56 për qind nga dhuna psiqike. Këto të dhëna tregojnë që ky lloj i problemit paraqet problem shoqëror.

"Të domosdoshme janë edukimi dhe ngritja e vetëdijes që dhuna familjare nuk është vetëm sulm fizik - dhuna psiqike, kërcënimet, komentet negative, dhuna ekonomike dhe dhuna seksuale janë gjithashtu forma të dhunës familjare", thotë Jasmina Jonuz.

Por zakonisht shpesh dhuna psiqike është lloji i parë i dhënës, i cili më tutje mund të zhvillohet në forma të ndryshme, siç është dhuna fizike. Sipas asaj duhet të përkushtohet vëmendje dhe të mos lihen pas dore të gjitha llojet e dhunës më të lehtë, siç është ajo verbale, e cila te ne është shumë e shfaqur, shtojnë psikologët. Nëse vazhdohet dhe lejohet kjo qasje, këto forma më të lehta shpejt mund të kalojnë në forma më serioze të dhunës. Nëse nuk reagohet përkatësisht në disa raste edhe dhuna fizike mund të kalon në lëndime trupore, por edhe vrasje. Sipas MPB - Shkup, në vitin 2017 janë realizuar 538 vepra penale me lëndime trupore prej të cilave 16 janë me lëndime trupore më të rënda dhe 6 vrasje.

Gjithashtu, zbatimi i dhunës, përveç se mund të sjell deri te pasoja serioze shëndetësore ose psiqike, pasojat më të mëdha i shkaktojnë tek fëmijët-dëshmitarë, të cilët e durojnë atë dhe tek të cilët mund të vjen deri të shkatërrimi emocional dhe ndryshimi në sjellje, theksohet në faqen e Organizatës botërore të shëndetësisë. Nga informacionet e më shumë hulumtimeve konfirmohet premisa që është i nevojshëm fokus më i madh ndaj dhunës psikologjike në vendin tonë. Në këtë mënyrë mund të ndikohet dhe të pamundësohet kalimi prej një në lloj tjetër më serioz të dhunës. Por që të mundësohet kjo, është e nevojshme informimi dhe motivimi i viktimave për njohjen e saj dhe denoncimin e atyre të cilët e kryejnë dhunën. Është e nevojshme ngritja e vetëdijes dhe edukim më i madh i qytetarëve në lidhje me dhunën.

Publicitet

Në bazë të nenit 172 paragrafi 1, nenit 175 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018) dhe nenit 26 paragrafi 1, nenit 27, nenit 28 dhe nenit 29 të Rregullores për kriteret e veçanta dhe procedura për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" (Fleta universitare nr. 411 nga data 5 nëntor 2018) , Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit Filozofik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

1) Për zgjedhje të një (1) mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat mësimore shkencore: *Psikologjia e përgjithshme me shifrën 51000 dhe Psikologjia e arsimit dhe edukimit me shifrën 51005*, për kohë të përcaktuar me ligj.

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara në nenin 164, nenin 165 dhe nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror, Rregullores për kriteret e veçanta dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fleta universitare nr.411 nga data 5 nëntor 2018).

Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët duhet të parashtrojnë:
- biografi të shkurtër /CV/, me kopje të vendimit për zgjedhje në tituj mësimor-shkencor ose bashkëpunuese, nëse kanë zgjedhje të mëparshme në tituj mësimor-shkencor ose bashkëpunuese,
- dëshmi për shkallë përkatëse të arritur të arsimit – doktor i shkencave,
- vërtetim për njohje të gjuhës së huaj në pajtim me nenin,
- deklaratë për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme,
- dëshmi për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, nga një kopje prej punimeve,
- Formular 1 të plotësuar (përmbushje e kushteve të përgjithshme sipas Ligjit për arsim sipëror ("Gz. Zyrtare e RM" nr. 82/2018),
- Formular 2 të plotësuar për kushtet e veçanta të përmbushura për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunuese dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodij" në Shkup (Fleta universitare nr.411 nga data 5 nëntor 2018).

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret e veçantë dhe procedura për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe demonstratorëve të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fleta universitare nr. 411 nga data 5 nëntor 2018).

Orari i punës së mësimdhënësit në titujt mësimor-shkencor është përcaktuar në pajtim me aktet e Fakultetit filozofik.

Bruto pagesa fillestare e mësimdhënësit për pikën 1 është rreth 48.346,00 denarë.

Procedura e Konkursit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor zgjatë 6 muaj duke konsideruar nga dita e publikimit të konkursit.

Dokumentet parashtrohen në Fakultetin filozofik në Shkup, bul. "Goce Dellçev" nr. 9A – Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

Informacionet shtesë në telefonin 02 3116-520

Publicitet

Në bazë të nenit 38 dhe 43 të Ligjit për veprimtari hulumtuese shkencore (46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 27/2014, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16), IPSH Instituti i Historisë Nacionale shpall

**KONKURS PUBLIK**
**PËR ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME NË TITULL SHKENCOR NË IPSH INSTITUTI I HISTORISË NACIONALE**

- ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME të 1 (një) KËSHILLTAR SHKENCOR/PROFESOR I RREGULLT NË KLASËN PËR HISTORI TË POPULLIT MAQEDONASE PREJ 1913-1941, sfera shkencore shkenca humanitare, sfera shkenca historike.

Kandidatët duhet t'i plotësojë kushtet e Ligjit për veprimtari hulumtuese shkencore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 27/2014, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16), Ligjit për arsim të lartë, Rregullores për mënyrën e zgjedhjes në titullin me të lartë ("Gazeta zyrtare" 82/2009), Rregullores për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunëtorë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 173/2011) dhe Rregullores për përcaktim të kushteve shtesë për zgjedhje në titull shkencor më të lartë dhe për zgjedhje të parakohshme në titull shkencor në IPSH Instituti i historisë nacionale.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:
- fletëparaqitje për konkurs,
- biografi (në formë të shtypur dhe elektronike)
- bibliografi (në formë të shtypur dhe elektronike)
- diplomë apo vërtetim të marrjes së titullit doktor shkencor (dokument origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- kopje të çdo punimi shkencor

Dokumentet dorëzohen në Institutin e Historisë Nacionale rr. Gligor Përliçev nr. 3 Shkup (tel. 3115-831) në afat prej 8 ditësh nga dita e shpalljes së konkursit.

INSTITUTI I HISTORISË NACIONALE

BEKTESHI PRITI NË TAKIM MINISTRIN KOSOVAR, VALDRIN LLUKA

# PROJEKTE TË REJA ENERGJETIKE KOSOVË-MAQEDONI

Pas përfundimit të takimit të punës, ministri Bekteshi dhe ministri Lluka nënshkruan edhe Memorandum mirëkuptimi në fushën e energjetikës mes dy ministrive, i cili pritet të intensifikojë marrëdhëniet dypalëshe në sektorin e energjisë, në përputhje me politikat dhe strategjitë kombëtare, duke përcaktuar fushat prioritare për bashkëpunim të tillë si sektorin e energjisë elektrike, thëngjillin, gaz natyror, burime të ripërtëritshme të energjisë...

Koha Zejnulla VESELI

*Shkup, 11 shkurt* - Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, ka pritur dje në takim ministrin e Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, Valdrin Lluka. Me këtë rast, ministri Bekteshi prezantoi projektet aktuale energjetike dhe mundësitë për bashkëpunim me palën kosovare, ndërsa paralajmëroi projekte të shumta energjetike me Kosovën. "Në periudhën e ardhshme, projekti aktual për realizimi nga të dyja vendet është lidhja e sistemeve energjetike mes dy vendeve me revitalizimin e linjave 220 kv drejt Kosovës. Kjo do të nënkuptonte edhe një lidhje tjetër me sistemet energjetike të BE-së, sepse Kosova nëpërmjet Shqipërisë do të lidhet me Italinë, që do të thotë rritje e besueshmërisë në sistemin tonë të transmetimit të energjisë elektrike", u shpreh ministri Bekteshi.

Gjithashtu, tha ai, së shpejti nga ana jonë do të shpallet tender ndërkombëtar për ndarjen e premive për energji elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike të energjisë, që do të thotë nëpërmjet tenderit i jepet e drejta prodhuesit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtritshme të energjisë të shfrytëzojë premitë si shumë fikse shtesë të çmimit të cilin e ka arritur me shitjen e energjisë elektrike të gjeneruar në tregun me shumicë. "Në fushë e re e bashkëpunimit në periudhën e ardhshme pritet edhe në fushën e gazifikimit, sepse sipas studimit të fizibilitetit për sistemin e gazifikimit të Republikës së Maqedonisë me projekt ideor, pavarësisht interkoneksionit ekzistues me Bullgarinë në Deve Bair janë paraparë edhe 6 ndërlidhje potenciale shtesë duke përfshirë edhe bashkimin me Kosovën në Shkup", tha ministri i Ekonomisë i Maqedonisë.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik i Kosovës, Valdrin Lluka, shprehu interes në projektin e gazifikimit pasi hap mundësi për zhvillimin e këtij rrjeti në të dy vendet, duke theksuar se shkëmbimi i përvojave në zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë do të ishte e dobishme për të arritur qëllimet brenda përmbushjes së kërkesave të Komunitetit të Energjisë. "Përgatitja e projekteve të përbashkëta do t'u mundësojë dy vendeve prezantim të përbashkët para institucioneve të huaja financiare në mënyrë që të angazhohen fonde për realizimin e projekteve të përbashkëta," u shpreh ministri Lluka.

Ndër temat e diskutuara në këtë takim ishin termocentrali i Oslomejit dhe furnizimi i saj i mundshëm me thëngjill me kalori të lartë nga Kosova, i cili do duhej hulumtuar, pastaj HC Çebren dhe Galishtë, si balancues potencial në sistemet e elektroenergjetik në rajon, si dhe projektet investuese të të dyja palëve që nënkupton monitorimin e tranzicionit evropian të energjisë. Rruga e realizimit të autostradës Shkup-Bllacë, e cila është një nga prioritetet e Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore, si dhe përgatitja e dokumentacionit të projektit për pjesët rrugore Tetovë-Jazhincë dhe Opajë-Stanqiq, ishin ndër temat e diskutuara nga të dyja palët, si dhe mundësitë për zgjerim me projektin për sistemin e sistemit njësportel ndërsa operacionalizimi i disa prej projekteve të lartpërmendura mund të sjell edhe mbledhja e përbashkët mes Qeverisë së Maqedonisë dhe Qeverisë së Kosovës, planifikuar të mbahet kah mesi i këtij viti. Pas përfundimit të takimit të punës, ministri Bekteshi dhe ministri Lluka nënshkruan edhe Memorandum mirëkuptimi në fushën e energjetikës mes dy ministrive, i cili pritet të intensifikojë marrëdhëniet dypalëshe në sektorin e energjisë, në përputhje me politikat dhe strategjitë kombëtare, duke përcaktuar fushat prioritare për bashkëpunim të tillë si sektorin e energjisë elektrike, thëngjillin, gaz natyror, burime të ripërtëritshme të energjisë, efikasitetin energjetik, furnizim të sigurt me energji, si dhe përgatitja e projekteve të rëndësishme infrastrukturore për ndërlidhje me energji elektrike dhe gaz dhe nisma të tjera projektuese.

ZGJIDHJET E PROBLEMIT ME AJRIN E NDOTUR

# VITI 2019, VIT I AUTOMJETEVE ELEKTRIKE NË MAQEDONI

*Shkup 11 shkurt* - Subvencione, stacione për mbushje dhe paralajmërime për modele të reja të automjeteve elektrike. Sipas paralajmërimeve, 2019-ta duhet të jetë vit i automjeteve me zero emision të gazrave të dëmshme në rrugët e Maqedonisë. Megjithatë, vala e këtillë "e gjelbër" ende është vetëm në paralajmërim në tregun e automjeteve në Maqedoni. Automjetet elektrike shikohen si një nga zgjidhjet e problemit me ajrin e ndotur dhe masat me të cilat nxitet përdorimi i tyre. Ata janë pjesë e planeve afatshkurtra dhe afatgjata për uljen e ndotjes së ajrit në qytete.

Zëvendësministri i Mjedisit të Jetesës dhe Planifikim Hapësinor, Jani Makraduli, në nëntor të vitit të kaluar paralajmëroi subvencione për automjete elektrike dhe hibride. Me Propozimin e ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për automjete parashikohen Programe për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve për blerjen e automjeteve me motor elektrik, për instalimin e pajisjeve për motor me TNG ose ndonjë lloj tjetër të karburantit alternativ dhe për blerjen e automjetit të ri me ç'lajmërimin e automjetit të vjetër në përputhje me nenin 41 paragrafin (1) të këtij ligji, ku është parashikuar me konstatimet e Qeverisë që subvencionimi të jetë nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Me programet për subvencionim janë parashikuar mjete financiare në shumë prej 170.000.000 denarë në vitin 2019, 245.000.000 denarë në vitin 2020 dhe 320.000.000 denarë në vitin 2021. Janë parashikuar subvencione prej 5.000 eurove me kundërvlerë në denarë për furnizimin e automjeteve elektrike, ndërsa 3.000 euro me kundërvlerë në denarë për furnizimin e automjetit hibrid, ndërsa në vitin e parë parashikohet të ndahen subvencione për 200 automjete. Ndonëse sivjet për subvencione janë parashikuar rreth 2,7 milionë euro, nga Ministria e Ekonomisë, përmes të cilës duhet të bëhet subvencionimi, informojnë se Ligji për automjet është ende në Kuvend dhe momentalisht nuk kanë informacione më të hollësishme për paralajmërimet për subvencione për automjete elektrike dhe hibride. Në tregun e Maqedonisë mund të blihen automjete elektrike prej disa prodhuesve të ndryshëm, por shumica nuk kanë çmime zyrtare për modelet.

Automjeti i parë elektrik i Maqedonisë ZAS G20 është prezantuar javën e kaluar nga ekipi i "BB Klasik Kars". Sipas prodhuesit të automjetit ka emision zero të dyoksid-karbonit, rreze qarkullimi me një mbushje deri 150 kilometra në kushte reale të vozitjes, si dhe shpejtësi maksimale deri 130 kilometra në orë. Koha e mbushjes arrin tre orë në lidhje të rrjetës shtëpiake, po aq edhe në lidhje të alternuar publike, ndërsa në mbushës të shpejtë të njëkohshëm publik mjaftojnë 15 minuta. Çmimi i modelit themelor është rreth 20 mijë euro dhe koha e dërgimit është dy muaj. Nga EVN-ja informojnë se janë vendosur më shumë se 40 stacione për mbushjen e automjeteve elektrike në lokalitete qendrore publike në 17 qytete në Maqedoni. Pronarët e interesuar të automjeteve elektrike për t'i përdorur mbushësit së pari duhet të paraqiten për kartelë elektronike, derisa përdorimi i mbushësve elektronik në periudhë prej një viti, siç paralajmërojnë nga EVN-ja, është falas për të gjithë përdoruesit.

# Implikime të sigurisë nga përzierja ruse në Maqedoni

*Nga*
**Timurlenk ÇEKOVIQ**

Maqedonia që më 23 dhjetor të vitit 1993, me Vendim të Kuvendit vendosi të bëhet anëtare e NATO-s. Prej atëherë, ajo e nënshkroi Marrëveshjen për Partneritet për paqe, morri pjesë në 6 misione paqësore me mbi 4000 ushtarë, e profesionalizoi armatën sipas NATO standardet, kreu 17 plane rekorde aksionare dhe e filloi të 18-tin plan aksionar. Plani aksionar (PAÇ) tani është në dhomën e pritjes së NATO-s bashkë me BeH, Gjeorgjinë dhe Ukrainën.

Deri para disa vitesh, Rusia nuk e kundërshtonte hapur dëshirën të cilën Maqedonia e shprehte në çdo NATO samit dhe të cilën e konfirmonte çdo pushtet yni i zgjedhur nga shumica e qytetarëve. NATO integrimet ishin proces normal me rëndësi nacionale dhe pjesë e pashmangshme nga Strategjia për siguri nacionale. Por, prej para do kohësh shteti Rus paralajmëroi hapur se do ta kundërshtojë aktin e tillë, sepse ai mund ti prish marrëdhëniet dypalëshe midis dy vendeve. Çfarë ndryshoi ndërkohë? Shpërbërja e ish BRSS e solli kolapsin e një sistemi të sigurisë dhe u asgjësuan kërcënimet klasike të njohura deri atëherë. Sot, furnizuesi më i madh me gaz për tregun evropian është Rusia dhe kjo e bën Evropën në masë të madhe të lëndueshme, ndërsa qëndrimin që do ta ketë në ardhmen ndaj çështjeve të sigurisë do të varet nga hegjemonizmi në rritje e sipër  të Rusisë të trashëguar që nga koha e BRSS.

Me fuqizimin e Rusisë në planin ekonomik u forcua edhe roli i saj i fuqisë botërore dhe i faktorit politik i cili nuk mund të anashkalohet. Dilema e tillë nuk ekziston për SHBA të cilat në periudhën e fundit në mënyrë të hapur e kundërshton përzierjen e Rusisë në pikëpamje të zgjerimit të NATO-s, si në Evropën Lindore, ashtu edhe në Ballkanin. Një pjesë e analistëve politik në Maqedoni dhe Evropë konsiderojnë se Maqedonia, e madje as i tërë Ballkani, nuk është qëllimi strategjik i Rusisë, por është reagim i zgjerimit të sforcuar të NATO-s në drejtim të lindjes. Ata konsiderojnë se për ta penguar atë, Rusia përdor politikë agresive tejet të madhe.

**RAPORTET NATO - RUSI**

NATO vendosi lidhje të afërta me të gjitha republikat e mëparshme sovjetike dhe vazhdon ta përkrah pavarësinë e tyre politike. Qëllimet parandaluese të reja të NATO-s duhet tu ndihmojnë anëtareve të mëparshme të Traktatit të Varshavës dhe ti mbrojë nga kërcënimet eventuale nga ana e Rusisë.

Krahas asaj, NATO i shtriu dorë Rusisë me qëllim që ti zbusë dyshimet në lidhje me zgjerimin e NATO-s në fqinjësinë e saj. Më 27 maj të vitit 1997, liderët e vendeve anëtare të NATO-s dhe të Federatës Ruse nënshkruan akt themelues për marrëdhënie të përbashkëta dhe bashkëpunim në fushën e sigurisë. Rusia e pranoi bashkëpunimin e ofruar edhe në vitin 1998 me propozimin e saj u formua Qendra koordinuese euroatlantike për reagime gjatë fatkeqësive natyrore (EADRCC). Bashkëpunimi në fushat e interesit të përbashkët të sigurimit, siç janë zvogëlimi i ndërsjellë i rreziqeve të sigurisë dhe bashkëpunim në operacionet anti-terroriste, sipas Planit strategjik nga viti 2010 vë në pah atë se NATO-ja nuk dëshiron konflikt me Rusinë.

Aneksimi i Krimesë në vitin 2014, përkeqësimi i vazhdueshëm i raporteve me NATO-n pas aksionit luftarak në Gjeorgji dhe përkrahja luftarake për separatistët rus në Ukrainë e kyçën alarmin e kuq të NATO-s. Për shkak të trazirave në atë rajon, në kohën e afërt bëhet i pamundur anëtarësimi i Ukrainës dhe të Gjeorgjisë në NATO. Gjendja në atë rajon edhe në Ballkan, pas atyre ngjarjeve u ndërlikua.

**SULMET KIBERNETIKE SI PARALAJMËRUES TË PARAROJËS TË STUHISË NË MAQEDONI**

Mbrojtja kibernetike e NATO-s u imponua nga përzierja e fuqishme ruse në proceset që zhvillohen në Evropë. Ato kërcënime me konceptin e ri strategjik nga viti 2010 konsiderohen si kërcënim, por anëtaret e NATO-s prapëseprapë nuk mund të thirren në nenin 5 të Kartës së Atlantikut  për mbrojtje të përbashkët. Më shpesh sulmet e tilla nuk mund të dëshmohen, por edhe në se dëshmohen, pala e involvuar mund ta mohojë lehtë atë fakt me hedhje poshtë të përgjegjësisë. Hapi i parë i tillë në historinë e sulmeve kibernetike të kombinuara me veprime të armatosura, ndodhi gjatë luftës me Gjeorgjinë në vitin2008, kur shumë serverë qeveritar gjeorgjian u sulmuan dhe u asgjësuan. Qeveria e SHBA në një studim konkludoi se sulmi kibernetik në Ukrainë, prapa të cilit qëndron qeveria ruse, ka shkaktuar ndërprerje të furnizimit me rrymë elektrike për mbi 200.000 njerëz në vitin 2015. Sërish nuk kishte përgjigje zyrtare nga Moska. Në rastin e sulmit kibernetik mbi Estoninë, askush nga Aleanca nuk u inkurajua që ta drejtojë gishtin kah Rusia. Në të njëjtin vit 2015, Si-En-En (CNN) publikoi se hakerë rus, të cilët me siguri punojnë për qeverinë ruse, janë të dyshuar për më të pamëshirshmin sulm hakerësh  mbi Stejt Departamentin. Qeveria ruse i hodhi poshtë këto akuza. Si pjesë e mbrojtjes, Republika e Maqedonisë miratoi koncept të ri strategjik nacional për mbrojtje kibernetike, si sfidë më bashkëkohore e sigurisë së një vendi. Sivjet Republika e Maqedonisë u ballafaqua me të gjitha sfidat bashkëkohore të luftimit kibernetik midis të cilave janë lajmet e rreme dhe propaganda. Gjatë verës së vitit 2018 u paraqitën qindra faqe të reja të internetit të cilat ftojnë në votim dhe poste në Fejsbuk dhe Tuiter të cilët i ftojnë Maqedonasit që të mos votojnë në referendum. Sipas përfaqësuesve maqedonas dhe amerikan, ato profile u krijuan për përhapjen e dezinformatave klasike nga grupe të përkrahura nga Rusia.

> **Deri tani u bë fjalë për përzierjen e hapur të Rusisë në punët e brendshme të Republikës së Maqedonisë, por shumë pak vihet në pah se çfarë implikime mund të ketë ajo për sigurinë e RM**

Në Republikën e Maqedonisë janë zbatuar hulumtime të caktuara gazetareske në pikëpamje të përzierjes ruse dhe rrezikimit të sigurisë. Midis tyre mund të përmendet hulumtimi i realizuar në qershor të vitit 2017 nga TV Nova me partnerët nga "OSSRP" dhe rrjeti Serb i hulumtimit të krimit dhe të korrupsionit – "KRIK", në partneritet me gazetën britanike "Gardian". Sipas hulumtimit, në fillim të vitit 2017 është përgatitur raport nga

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

**Botues: Koha Production SHPK** | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë, 11 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
**E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222** | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

**NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772**

Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim ku vihet në pah se në 9 vitet e fundit Republika e Maqedonisë është nën propagandën subversive dhe aktiviteteve të zbulimit të zbatuara përmes Ambasadës së Federatës Ruse dhe kjo koinçidon me përpjekjet e Maqedonisë që ti bashkëngjitet NATO-s. Përveç kësaj, është vërejtur edhe burimi i lajmeve të rreme dhe të propagandës i cili më së shumti ndikoi në përhapjen e euforisë para-luftarake në vendin tonë, dhe atë nga askush tjetër, por nga agjencia e njohur ruse "Sputnik", pronësi e Kremlinit. Sipas një tjetër hulumtim gazetaresk, "Sputnik" në mënyrë të hapur publikonte shkrime me të cilat paralajmërohej luftë në Maqedoni dhe citoheshin se "ekziston rreziku që të ndodhin sulme të organizuara, siç ishte ai në Kumanovë, në maj të vitit 2015". E dukshme është se interesi i Rusisë ishte i orientuar drejt asaj që të përhapen zëra të ndryshëm në pikëpamje të rreziqeve të cilat mund të ndodhin në Republikën e Maqedonisë në raport me raportet kosovare - serbe.

Përkundër të gjitha gjërave, përfaqësuesit amerikan konsiderojnë se zbulimi i qëllimeve të personit Ivan Savidis, biznesmen grek me origjinë ruse, në Greqi dhe dëbimi i diplomatëve rusë nga Maqedonia dhe Greqia është fitore e rrallë në betejën kundër fushatës ruse të dezinformimit në Evropë dhe në SHBA.

**SFIDA RAJONALE TË SIGURISË**

Padyshim, me dinamikën e shpejtë të ndryshimeve në rajonin në mënyrë të përshkallëzuar do të ndërlikohet edhe siguria jonë. Në një kohë të afërt, themelimi i partive pro-ruse nuk do të jetë karakteristikë vetëm e Republikës së Maqedonisë, por edhe të tërë rajonit. Prapëseprapë, ekzistojnë parti dhe organizata për miqësi ruse, ndërtohen kisha me arkitekturë ruse, e madje përhapen ndikesa pansllave pagane, por ato nuk janë kyç në rrezikimin e sigurisë së Republikës së Maqedonisë. Ndikesa në rritje e sipër e Rusisë dhe interesi i saj që të imponohet si fuqi politike në Ballkan, i cili në njëfarë mënyre është shpallur si fushëbetejë virtuale e re, do të vazhdojë edhe në periudhën e ardhshme, gjë e cila lë hapësirë për pasiguri në rajonin dhe më gjerë. Aktiviteti diplomatik i gjerë i SHBA, Gjermanisë, Unionit Evropian dhe NATO-s në periudhën e fundit në Maqedoni janë tregues se implikimet e sigurisë në rajonin do të ndërlikohen të shkaktuara nga përzierja ruse. Republika e Maqedonisë me hyrjen në NATO do ta hedh poshtë pjesën më të madhe të kërcënimeve dhe rreziqeve për sigurinë e saj dhe me atë do të pengohet involvimi i elementeve të huaja të cilat në të ardhmen mund të reflektohen për potencialin e saj ushtarak dhe të sigurisë.

# Perëndimi pa busull

*Nga*
**Bret Stephens**

Në gushtin e vitit 1990, Xhorxh. H.W Bush u takua me Margaret Theçërin në Aspen, menjëherë pas pushtimit të Kuvajtit nga Sadam Huseini. Ata vendosën të mos lejojnë "agresionin e hapur" të Irakut, dhe nuk e lejuan atë. Kjo ishte mënyra se si Perëndimi duhej të funksiononte - dhe se si ndonjëherë, funksiononte. Sot, SHBA-ja dhe Britania e Madhe mezi po qeverisin vetveten, për të mos folur pastaj për rendin botëror. Tereza Mej, e cila si kryeministre nuk i ngjan Theçërit në asnjë respekt, përveç gjinisë dhe partisë, pësoi humbjen më të rëndë parlamentare në gati një shekull mbi marrëveshjen e saj Brexit.

Donald Trump, i cili si president nuk i ngjan Bushit të vjetër në asnjë aspekt tjetër, përveç gjinisë dhe partisë, drejton një qeveri të mbyllur, një administratë të çoroditur, një komb tejet të ndarë, dhe një superfuqi që tallet dhe shihet me dyshim nëpër botë. Perëndimi, është tani si një anije pa timon. Dhe dihet që të qenit pa timon, e vendos udhëtarin në mëshirën e elementeve të jashtëm. Forcat thelbësore të politikës sot janë tribalizmi, populizmi, autoritarizmi dhe 'tubacionet e kanalizimeve' të mediave sociale. Secila prej tyre, kundërshton angazhimet themelore të Perëndimit ndaj universalizmit, përfaqësimit, të drejtave të patjetërsueshme dhe një epistemologjie të ndërtuar mbi faktin dhe arsyet, dhe jo mbi klikimet dhe ndjenjat. Ne po shkojmë, në mungesë të mendjes dhe vullnetit, drejt një momenti të vetë-mohimit civilizues.

Kur filloi ndryshimi? Ndoshta në vitin 1989, kur Frensis Fukujama botoi esenë e tij historike "Fundi i Historisë?". Dhe pasoi një dekadë e vetëkënaqësisë demokratike. E pse duhet të shqetësoheshim për shëndetin dhe fatin e demokracisë liberale, kur triumfi i saj ishte i pashmangshëm dhe i pakthyeshëm? Pse duhet të mësonim përfitimet nga tregjet e lira dhe emigracioni - apo rreziqet e socializmit dhe të nativizmit - kur historia i kishte dhënë tashmë verdiktet e veta? Dhe pse lipsej puna e lodhshme e ruajtjes së themeleve të qeverisë së lirë, kur është shumë më interesante ta rishpikësh atë?

Mburrja sjell pasiguri. Liberalët qenë të pakujdesshëm kur hoqën karakterin moral, si një tipar thelbësor i një presidence të mirë. Konservatorët (si unë) ishin të pavëmendshëm, kur u shqetësuam më shumë për gjendjen e demokracisë në Irak, se sa në Ajoua. Liberalët ishin të pakujdesshëm, kur përqafuan politikën e identitetit, pa menduar ndonjëherë se ajo mund të përdoret gjithashtu kundër tyre. Konservatorët (sërish si unë), nuk e vranë mendjen kur e minimizuan rëndësinë e populizmit, dhe efekteve ngjitëse të lëvizjes propagandistike nëpërmjet radios dhe Fox News.

Mendjelehtësi pati edhe në anën tjetër të Atlantikut. Integrimi evropian është një bekim; por jo integrimi pa llogaridhënie, dhe pa një pëlqim të vërtetë demokratik. Ngjashëm, emigracioni është një bekim; kurse emigracioni pa asimilim është një mallkim. Dy gjenerata të liderëve europianë, i lejuan të parat pa kërkuar të dytat, dhe pastaj me hile e shpërfillën pakënaqësinë publike si politikisht të parëndësishme dhe moralisht të paligjshme. Tani ata po përballen me pasojat.

Sa për Brexit-in, vendimi i 2016-ës me 52 për qind të elektoratit britanik, që u shpreh në favor të largimit nga Bashkimi Evropian, pavarësisht kundërshtimeve të forta nga 48 për qind e britanikëve, duhet të konsiderohen si një nga historitë më të këqija të ndodhura ndonjëherë në historinë e ndritur të ishullit. Por jo aq i marrë sa vendimi i ish-kryeministrit Dejvid Kameron, për të shtruar një çështje jetike në një votim popullor - ashtu siç kishte vënë në pikëpyetje një tjetër çështje themelore, pavarësia e Skocisë, në një votim dy vjet më parë - pa marrë seriozisht në konsideratë pasojat, nëse gjërat do të shkonin në drejtimin e gabuar. Problemi këtu nuk ishte dështimi i Kameron dhe kampit "Remain", për ta paraqitur si një kauzë më të fortë qëndrimin në Bashkimin Evropian, apo për të lexuar më mirë sondazhet. Ishte një dështim filozofik - një dështim që lë në kuptohet se qëllimi i qeverisë përfaqësuese, është të shpëtojë demokracinë nga vetja. Tani e gjej veten duke hedhur poshtë nga një përkrahës i një Brexit të ashpër, me teorinë se leksionet e qëndrueshme mësohen vetëm përmes rrugëve të vështira. Ose ndoshta jo. E keqja zakonisht sjell më të keqen, dhe një Brexit i ashpër do të përshpejtojë çdo tendencë tjetër të rrezikshme në politikën britanike:një shtytje të re për pavarësi nga Skocia dhe ndoshta Irlanda e Veriut dhe Uellsi; një shans më i madh i Xheremin Korbinit, skeptik i NATO-s, anti-semit, për t'u bërë kryeministër; një mungesë e zgjeruar e Britanisë, si një prani domethënëse dhe aktive në skenën botërore.

> **Perëndimi nuk po lundron drejt ujërave të qeta. Me burime të kufizuara, por me metoda të pamëshirshme, Vladimir Putin ka arritur të minojë demokracisë nga Kievi në Kansas. Me mjete njëlloj të pamëshirshme, dhe burime shumë më të mëdha, Xi Jinping ka ngritur flamurin e autoritarizmit efikas, si modeli i preferuar i qeverisjes së shekullit XXI-të**

Po në lidhje me Shtetet e Bashkuara? Në mesin e shumë konservatorëve që unë njoh, pikëpamja mbi Trump është se menaxhimi kaotik, sjelljet klonike dhe braktisjet ideologjike janë irrituese, me asnjë fatkeqësi dhe çmim që ia vlen të paguhet për derregullimin, shkurtimet e taksave dhe gjykatat konservatore. Vërtet? Të njëjtët konservatorë, i kaluan 30 vitet e fundit duke predikuar rëndësinë e gjykimit, karakterit të mirë dhe respektit për institucionet në personin e presidentit. Ata kishin të drejtë. Çfarë do të thonë ata kur i gjejnë këto atribute që mungojnë në personin e presidentit, dhe që nuk ndajnë preferencat dhe përkatësinë politike të tij?

Perëndimi nuk po lundron drejt ujërave të qeta. Me burime të kufizuara, por me metoda të pamëshirshme, Vladimir Putin ka arritur të minojë demokracisë nga Kievi në Kansas. Me mjete njëlloj të pamëshirshme, dhe burime shumë më të mëdha, Xi Jinping ka ngritur flamurin e autoritarizmit efikas, si modeli i preferuar i qeverisjes së shekullit XXI-të. Çfarë duhet të thotë Perëndimi për mbrojtjen e sistemit dhe vlerave të veta? Kush duhet ta thotë këtë? Dhe kush do të sistemojë situatën aktuale, dhe rivendosë timonin në drejtimin e duhur, deri në konfliktin e ardhshëm?

*(The Wall Street Journal)*

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Koha për Kulturë

Koha, e martë, 12 shkurt 2019

E PARA SHQIPTARE QË FITON ÇMIMET "GRAMMY"

# DUA LIPA BËN HISTORI

Dua Lipa ka qenë femra e dytë më e dëgjuar në vitin 2018 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e para në Mbretërinë e Bashkuar. Pos muzikës, ajo është shndërruar edhe në një yll stili duke zbukuruar ballinat e revistave të popullarizuara. Një prej tyre ka qenë edhe versioni britanik i Vogue

Dua Lipa kap majat e suksesit në karrierën e saj si këngëtare duke fituar dy çmimet prestigjioze në "Grammy Awards". Artistja e talentuar, e bë e para shqiptare që arrin të marrë një trofe kaq të rëndësishëm.

Dua Lipa mori çmimin ne kategorinë "Kënga më e mirë në zhanrin dance". Ky çmim iu dha për bashkëpunimin e suksesshëm me Mar Ronson dhe Diplon ne superhitin "Electricity", mjaft i pëlqyer në të gjithë botën. Por shqiptarja nga Kosova ajo nuk është mjaftuar me kaq pasi ka triumfuar edhe në kategorinë "Artistja më e mirë e re". Këtij lajmi padyshim që i është gëzuar këngëtarja, e cila në një video të publikuar nga MTV duket tejet e lumtur.

Dua Lipa ka qenë femra e dytë më e dëgjuar në vitin 2018 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e para në Mbretërinë e Bashkuar. Albumi që mban emrin e saj e që udhëhiqet nga hitet "New Rules" dhe "IDGAF, ka qenë albumi i katërt më i dëgjuar në Spotify në SHBA në vitin e kaluar.

Karriera e saj ka nisur që në moshë të re dhe ngjashëm sikur Justin Bieber, Shawn Mendes e shumtë të tjerë – duke publikuar në YouTube versione të saj të këngëve të popullarizuara (që njihen si 'cover') – shkruan Vanity Fair.

Pos muzikës, ajo është shndërruar edhe në një yll stili duke zbukuruar ballinat e revistave të popullarizuara. Një prej tyre ka qenë edhe versioni britanik i Vogue. Ndërkaq, me postimin e fotografive nga evenimentet e ndryshme, në profilin e saj në Instagram ka arritur afro 26 milionë ndjekës.

Ajo ka kënduar vitin e kaluar në Kosovë, në kuadër të Festivalit "Sunny Hill", duke falënderuar vendin e saj për përkrahjen në fillimet e saj ndërsa ka premtuar se do të kthehet përsëri në koncerte të tjera.

Ambasadori britanik në Kosovë, Ruairi O'Connell ka uruar Dua Lipën, duke e vlerësuar lart rolin e saj. "Urime Dua Lipa, krenaria e dy shtetave.", ka shkruar ai në Facebook.

Kandidate në këtë kategori ishte edhe një tjetër artiste e njohur me origjine shqiptare, Bebe Rexha.

Disa nga artistët që ishin prezent në këtë event ishin nominuar për herë të parë për një çmim "Grammy". Ky është çmimi më i madh që një këngëtar mund të marrë në industrinë muzikore.

ZIJA ÇELA

## Kam frikë të vdes, pa pasur afër një dorë gruaje

*Isha njëzet vjeç dhe pyeta: "Kur do ta njoh?"*
*Në njëzet e pesë thashë: "Kur ta kem njohur, do të jemi gjithmonë bashkë."*
*U bëra tridhjetë dhe ne ishim bashkë. Në tridhjetë e pesë ishim përsëri bashkë.*
*Po mbushja dyzet, kur bëmë udhëtimin e madh. Nuk mbaj mend se ku vajtëm, por kthimi ishte njëlloj si prej botës së përtejme: njëri prej nesh u tjetërsua aq shumë, sa e humbi toruan edhe tjetri.*
*Në dyzet e pesë u ndamë.*
*Pesëdhjetë vjeç i trokita në derë. Doli dikush dhe më tha:*
*"Ajo po fle. Ke ndonjë porosi?"*
*"Jo", thashë, "vetëm desha të dija nëse është mirë."*
*"Ajo është mirë", tha.*
*Ende s'jam pesëdhjetë e pesë që ta di nëse është zgjuar nga gjumi dhe vazhdon të jetë mirë. Ndoshta kur të bëhem gjashtëdhjetë, do të pyes veten: "A do ta shoh përsëri?" Nëse në gjashtëdhjetë e pesë nuk do të jetë ajo që do të trokasë tek unë, shtatëdhjetë vjeç do të martohem me një tjetër.*
*Kam frikë të plakem, por sidomos kam frikë të vdes, pa pasur afër një dorë gruaje.*

## "The Favourite" merr më së shumti çmime BAFTA, "Roma" kryesorin

Filmi i Netflixit "Roma" ka marrë çmimin kryesor në ceremoninë prestigjioze BAFTA të dielën, duke marrë çmimin për Filmin më të mirë dhe për Regji, teksa "The Favourite" mori më së shumti çmime. Filmi për jetën e një punëtori të viteve të 70'-a në Meksikë ka fituar një varg çmimesh, duke përfshirë edhe suksesin potencial me nominimin për Oscar. Të dielën, ai fitoi katër çmime, përfshirë edhe çmimin për Filmin më të mirë jo në gjuhën angleze. Në anën tjetër, drama "The Favourite" në të cilën Olivia Colman luan rolin e Mbretëreshës Anne të shekullit 18 në Britani, ka fituar shtatë çmime, përfshirë Filmin më të mirë britanik, çmimin për Skenarin, për Dizajn e Kostumografi. Rami Malek fitoi çmimin për Aktorin më të mirë për rolin e Freddie Mercuryt në "Bohemian Rhapsody". Olivia Colman mori çmimin për Aktoren më të mirë.

## Fjalimi madhështor i Skënderbeut

Nga Marin Barleti

Ju epirotët, mund të gjenit një tjetër mbrojtës të lirisë, një tjetër përkryes të qëllimeve dhe të aspiratave tuaja, sepse, në këtë vend, s'kanë munguar mendjet e ndritura. Ju, si burra aq të fortë, të rritur në liri, që qëndruat kaq kohë nën mynxyrën barbare, nuk u mërzitët derisa të më shihnit. Po përse doni që unë ta mbaj për vete me të padrejtë emrin e çlirimtarit? Lirinë nuk e solla unë, por e gjeta këtu. Sapo më shkeli këmba truallin tuaj, sapo dëgjuat emrin tim, m'u derdhët me vrap të gjithë, më dolët përpara kush e kush më parë...

Ju më latë prapa, ju m'i lidhët menjëherë duart, ju më mbytët me shërbime aq të mëdha dhe me një gaz shpirtëror aq të madh, saqë duket se ju më keni bërë tani aq rob, sa edhe të lirë.

Mbretërinë dhe këtë qytet nuk jua dhashë unë, por ju gjeta të armatosur. Lirinë e pashë se e keni kudo, në kraharor, në ballë, në shpatat e në ushtat, dhe si kujdestarë të pashoq, të lënë nga ati im, e vutë përsëri në vend, me kujdes e besnikëri të pandryshuar, skeptrin, që ma ruajtët gjer në këtë ditë, dhe më bëtë përsëri, me mundin e punën tuaj të papërtuar, zotërues të mbretërisë së të parëve të mi, pa derdhur gjak...

Pjesën më të madhe të punës e kemi mbaruar. Kruja është fituar, krahina e gjithë është jona, Dibrat dhe pastaj popullsitë e tjera janë bashkuar me ne dhe emri i armiqve është zhdukur nga fusha; mbeten qytetet. Po të mendoj gjendjen e tyre të vështirë, duke parë se të gjitha janë të rrethuara nga ne, të zëna në befasi, se të rrethuarve u kanë mbetur vetëm muret e zhveshura, kam shpresa të mira. Po të marr parasysh vështirësitë që paraqitin këto vende dhe trupat që janë vendosur brenda nga Tirani, duket se do të jetë nevoja të përdorim ndonjë zgjuarsi apo këmbëngulje shumë të madhe.

Por këto do t'i gjykojmë më mirë, kur të ndodhemi në vend e të kemi përpara armikun e kur të mbajmë shpatën në këtë të djathtën tonë shkrumbuese, sesa për së largu e në tym. Të nisemi, pra, pa ngurrim dhe kudo të tregohemi me guxim prej fitimtarësh; fati do të na ndihmojë në përpjekjet tona, fati, që gjer më sot s'na është ndarë në çdo punë e na ka ecur për bukuri.

Megjithëkëtë, duhet t'ia nisim, para së gjithash, nga Petrela, jo sepse kjo kështjellë mbetet prapa të tjerave për nga vështirësia e pozitës apo nga mbrojtja natyrore, por sepse është më afër këtij qyteti.

Unë besoj se ne do t'a gjejmë atje emrin dhe frikën e fatit të Krujës më të madhe, sepse ata i panë me sy edhe trimëritë tuaja, edhe fatkeqësitë e veta. Këto do të mund t'u kallin atyre një frikë ndoshta jo të vogël e, në mos ua kallshin tamam këtë, atëherë do të veprojë sigurisht këmbëngulja jonë. Një gjë vetëm duhet të na ngulet mirë në kokë dhe të mos na dalë asnjërit nga mendja; në mos u pushtoftë ai qytet e në mos qofshim të aftë t'i plotësojmë dëshirat tona, atëherë s'kemi sepse të kthehemi prapë në shtëpi. Na duhet të provojmë çdo mjet, mundin, durimin, shpatën, arin dhe argjendin, me qëllim që fitores sonë t'ia fillojmë që këndej...Në qoftë se do të na jepet mundësia që ta shtiem qytetin në dorë pa derdhur gjak, duke na e dorëzuar vetë vendasit, atëherë do të na duhet që të gjithëve të veprojmë me urtësi të madhe si publikisht ashtu dhe privatisht, me qëllim që të nxitim kështu edhe të tjerët për dorëzim.

*(Nga Marin Barleti: "Historia e Skënderbeut", përkthyer nga Stefan J. Prifti)*

Subjekti i autocesurës - është sozia e shkrimtarit, një sozi, e cila e ndjek, duke e vështruar prapa zverkut në tekst, in statu nascend duke e paralajmëruar, që ai të mos bëjë ndonjë gabim ideologjik. Dhe me këtë sozi-censor është e pamundur të lash hesapet. Ai është mu si një Zot gjithëvrojtues e i gjithëdijshëm, sepse është i lindur prej vetë trurit tonë, prej vetë frikërave tona, prej vetë iluzioneve tona

# CENSURA DHE AUROCENSURA

Nga Danilo KISH

Në kohën e kulminimit të ngjarjeve, lidhur me ndalimin e veprimtarisë së sindikatës polake "Solidarnost", pata marrë një letër me shënimin E PACENSURUAR. Çfarë domethënieje të kishin këto fjalë? Ndoshta me to duan të thonë, se në vendin prej nga është dërguar kjo letër, nuk ka më censurë. Ose mund të nënkuptojë gjithashtu, se letrat pa këtë shënim i janë nënshtruar censurës, çka do të dëshmonte për një përzgjedhje nga ana e organeve zyrtare, të cilët një pale i besojnë, dhe një pale tjetër jo. Sigurisht, mund ta merrje edhe kështu: që pikërisht zarfi me shënimin E PACENSURUAR ka kaluar nëpër duart e censurës. Në një mënyrë a në një tjetër, kjo vule emblematike shumëkuptimore dëshmon për frymën e censurës, e cila përpiqet të nënvizojë plotëfuqinë e saj dhe njëkohësisht të maskohet me alibi. Ajo hiqet sikur të ishte e përkohshme, por një e keqe e domosdoshme e sistemit në gjendje permanente lufte. Kështu, censura na del si i vetmi mjet i përkohshëm, i cili menjëherë do të hiqet, kur të gjithë, kush shkruan (pa dallim, letra ose libra), të ketë arritur pubertetin politik dhe pjekurinë, ndërsa tutela e shtetit dhe pushtetit mbi qytetarët nuk do të hyjë më në punë.

**CENSURA NUK E PRANON EKZISTENCËN E VET**

Si një vepër e domosdoshmërisë (dhe gjithë çfarë ajo shkakton) - mjeti i përkohshëm - censura e konsideron veten të konsumuar, të likuiduar. Prandaj ajo nuk e pranon ekzistencën e vet, duke u përpjekur të maskohet nën pamjen e instituteve demokratike, të cilët përmbushin gjithashtu edhe funksione të tjera (redaksitë, e po ashtu këshillat e shtëpive botuese apo të revistave), apo t'i gjejë vetes një pasardhës të denjë në figurat e drejtorëve të shtëpive botuese, redaktorëve të ndonjë serie apo kolane botimesh në shtëpi botuese apo në revista, e kështu deri tek recensenti, korrektori etj.

Tek hipostaset më pak të njohura të censurës duhet përfshirë kategorikisht edhe dukuria e censurës shoqërore, e cila është një formë tranzitore nga censura në autocensurë - kur redaktori (duke qenë dhe vetë një njeri i penës) këshillon, që zoti N për të mirën e tij flaku nga libri i vet fragmente të caktuara apo strofa. Kur ai nuk ia del t'ju bindë, se këtë e ka bërë nisur nga qëllime të mira, ai operon me shantazhin moral dhe frikën e tij ai e hedh mbi ndërgjegjen tuaj: pra, nga gjerësia e natyrës suaj - ju duhet t'i merrni mbi vete prerogativat e censurës dhe me këtë rast ta fshihni atë para opinionit publik. Dhe mandej: ose zoti N do të bëhet censor i vetvetes, ose do të shkatërrojë ekzistencën apo karrierën e dikujt. Dhe si këmbim njeriu jo vetëm do ta botojë librin e zotit N, por gjithashtu do ta fshehë faktin, se kishte në të vende të atilla, të cilat - nëse do të kishin shpëtuar, do t'ju kishin shfarosur dhe ju, dhe atë.

Pavarësisht se si e përfton formën e saj, censura është, megjithatë, vetëm një shfaqje e jashtme e gjendjes patologjike, një sinjal i sëmundjes kronike, sëmundje, që zhvillohet paralelisht dhe lind autocensurën. Lufta është e padukshme, duke u projektuar larg syrit të opinionit shoqëror, e strukur në skutën më të errët të shpirtit, autocensura e përmbush punën e vet në mënyrë më të efektshme, se sa çdo censurë. Megjithëse të dyja rendin tek të njëjtat mjete - kanosja, frika, shantazhi - autocensura i fsheh ose, tek e fundit, nuk e zbulon ekzistencën e shtrëngimit/detyrimit. Lufta me censurën është e hapur dhe e rrezikshme, ndërsa lufta me autocensurën - është heroike. Një luftë anonime, e braktisur nga dëshmitarët dhe e vetmuar.

**CENSORIT TË PËRFYTYRUAR I VISHNI ATRIBUTE, QË VETË NUK I KENI**

Autocesura - është leximi i tekstit tënd personal me sytë e huaj, kur ju vetë bëheni i vetëgjykuar, madje i vetëgjykuar më ashpër, se sa ndonjë tjetër, përderisa e dini gjithashtu, edhe atë, të cilën censori asnjëherë nuk do ta zbulojë në tekstin tuaj, pra, atë për të cilën ju keni heshtur dhe të cilën ju kurrë nuk do ta hidhni në letër, por, që juve ju duket se ka mbetur "ndërmjet rreshtave". Prandaj censorit të përfytyruar ju i vishni dhe të atilla atribute, që vetë nuk i keni... Kështu sozia juaj ju përndjek mendimet deri në absurd, deri në ekstrem, atje, ku gjithçka është e luhatshme, e pasigurtë, ndërsa shtegdalje nuk ka: diçka e rrezikshme dhe ndëshkuese ju pret.

Subjekti i autocesurës - është sozia e shkrimtarit, një sozi, e cila e ndjek, duke e vështruar prapa zverkut në tekst, in statu nascend duke e paralajmëruar, që ai të mos bëjë ndonjë gabim ideologjik. Dhe me këtë sozi-censor është e pamundur të lash hesapet. Ai është mu si një Zot gjithëvrojtues e i gjithëdijshëm, sepse është i lindur prej vetë trurit tonë, prej vetë frikërave tona, prej vetë iluzioneve tona. Duke rivalizuar me sozinë tonë, përqendrimi ynë intelektual dhe moral duhet të lerë në letër gjurmë të dukshme, përderisa të gjitha tendosjet tona nuk reduktohen në një gjest të vetëm moral - deri në shfarosjen e dorëshkrimit dhe heqjen dorë nga planet. Mirëpo, dhe refuzimi nga lufta, dhe fitorja na shpien tek i njëjti rezultat: ndjenja e turpit dhe e disfatës. Sepse sado që ju të përpiqeni, prapë se prapë sozia juaj do të ngadhënjejë gjithmonë: sa herë që ju e tejkaloni, ajo qesh me ankthin tuaj, sa herë ju i nënshtroheni, ajo gajaset me frikën tuaj.

Nëse shkrimtari arrin ta kapërcejë gjestin radikal të vetëposhtërimit dhe me forcën e talentit, përqendrimin, burrërinë, zhdërvjelltësinë e mashtron sozinë-tunduese, gjurma e kësaj lufte mbetet e fiksuar në dorëshkrim - në trajtën e metaforës. Kemi të bëjmë me një fitore të dyfishtë: teksti, përkundër tundimeve, ka merituar lëvdata, ndërsa falë dinakërive mashtrimtare - e ka rritur idenë deri në metaforë (në kuptimin etimologjik, zhvendosja e një kuptimi të caktuar në atë stad sa ai të bëhet figurativ) - autocensura e ka shpërngulur figurën stilistike në sferën e poetikës.

**AUTOCENSURA, NJË OPERACION I RREZIKSHËM MENDOR**

Nisur nga këto që thamë, ne mund të nxjerrim disa pohime që na çojnë larg në sferat historike dhe teoriko-letrare, sikundërse dhe për një fenomen tjetër - me nënshtrimin e metaforës - të shpjegojmë ekzistencën e shumë veprave letrare, së paku nga përvoja e letërsisë ruse të avangardës. Proza e Boris Pilnjakut dhe Isak Babelit, poezitë e Osip Mandelshtamit dhe Marina Cvjetajevës, që përmes luftës me cenzurën përftuan një efekt letrar maksimal. Një fitore tragjike, e hidhur.

Autocensura është një kategori krijuese me energji negative, e cila kufizon, përqesh, ndërsa konfrontimi me kategorinë pozitive mund të ndezë shkëndijën. Atëherë, kur shkrimtari, i cili i poshtëruar prej frikës së vet, arrin ta vrasë sozinë e tij, ndërsa si rezultat i këtij shpërthimi të fuqishëm që është akumuluar gjatë prej kujdesit vigjilent, turpit dhe poshtërimit metaforat bien, perifrazat shkërmoqen dhe mbetet e vetme gjuha e zhveshur e fakteve - pamfleti. Censori juaj-sozi s'ka më asgjë për të fshehur ndërmjet rreshtash, sepse gjithçka tanimë është e shkruar e zezë mbi të bardhë - deri në atomin e fundit të pakënaqësisë suaj. (Në një minutë të tillë Osip Mandelshtami shkruajti poezinë kundër Stalinit - atë, të dytën, që donte të thoshte çlirim nga autocensura dhe poshtërimi. Atë poezi, të cilën ai e pagoi me kokën e tij.) Ngadhënjimi i parimit moral vret ose shkrimtarin, ose veprën.

"Uni" i censuruar, i cili ka pësuar shumë nga frika dhe tirania, rend menjëherë tek pamfleti, si tek shpata e hakmarrjes. Dhe pikërisht një fitore e tillë mbi sozinë personale ka "kastruar" jo vetëm një shkrimtar në emigrim. Si viktima të një autocensura me vite e vite, ata e kaluan shpejt atë kufi hapësinor, i cili e ndan artin nga propaganda; dhe ka ngjarë ajo, që Çesllav Milloshi e quan "kufizim".

Prej sa thamë mund të nxjerrim një konkluzion të tillë: ndikimi i gjatë i autocensurës shpie pashmangshëm tek katastrofat njerëzore apo krijuese, jo më pak, se ato, të cilat i shkakton censura; autocensura - është një operacion i rrezikshëm mendor me pasoja shumë të rënda për letërsinë dhe shpirtin njerëzor.

*P.S. Danillo Kish është një ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të shekullit XX, poet, prozator, teoricien, eseist, autor i vëllimeve poetike "Mansarda"1962; "Psalmi dyzetë e katër" 1962; romanet "Kopshti, hiri" 1972; "Klepsidra"1965; "Po-etika", 1972;"Një varr për Boris Davidoviqin"1978; "Mësimi i anatomisë" 1978; Nata dhe magjia"1983; "Homo poeticus" 1983; "Enciklopedia e të vdekurve" 1983; "Llumi i hidhur i përvojës"1990;*

*(Përktheu: Agron TUFA)*

# XHUZEPE UNGARETI

## Kush ishte Xhuzepe Nngareti

*( Giuseppe Ungaretti )*
Më 8 shkurt 1888 Lindi në Aleksandri poeti i shquar italian Xhuzepe Ungareti. Mori pjesë në Luftën e parë botërore duke luftuar në frontet e Italisë dhe Francës. Kjo luftë i la gjurmë të thella, të dhimbshme në shpirt duke i zbuluar tmerrin e vdekjes, por edhe vlerën e solidaritetit njerëzor . Përmbledhja e tij poetike Ndjenja e kohës (1933 ) zgjoi debate të pasionuara. Nga viti 1947 deri më 1960 botoi lirikat e përmbledhjes Dhimbja, Tokë e premtuar, Një britmë, Peizazhe, Bllokim i planetit . Për Ungaretin poezia duhet të jetë pasqyrë e kohës dhe poeti duhet t'i rikthej fjalës pastërtinë e vet të origjinës që kishte humbur me ndikimin e sensualitetit dhe muzikalitetit të D'Anuncios. Ungareti synon te sublimimi i fjalës që e ngre poezinë në lartësinë e një himni pothuajse fetar për jetën. Në bazë të poetikës së Ungaretit qëndron analogjia. Poeti afron midis tyre objekte dhe ndijime të largëta në dukje, po që nga sinteza fitojnë një unitet organik që shtrihet në figura lirike. Ungreti ka një vend më vete midis hermetikëve.

### *XHUZEPE UNGARETI*
### *ESHTE ORA E URITUR*

*Është ora e uritur, ora jote o i marrë.*
*Shkule zemrën*
*Erë kripë bie gjaku i saj*
*Dhe bie era athtësirë, është ëmbëlak,*
*duke qenë gjak.*
*Shumë vaje*
*e bëjnë gjithnjë më të shijshme zemrën*
*tënde.*
*Frutë i shumë vajeve zemra jote,*
*Shqyeje, haje, ngopu.*

### *YLLI*

*Yll, i vetmi ylli im,*
*Në varfërinë e natës,*
*Vetëm për mua ti ndrit.*
*Në vetminë time ti shkëlqen ;*
*Po për mua,*
*Yll që kurrë s'do të pushosh së ndrituri,*
*Një kohë tepër e shkurtër të është dhënë,*
*Më jep një dritë*
*Që dëshpërimin tek unë*
*Veç sa e mpreh, e thellon.*

### *UNIVERS*

*Me detin*
*një arkivol freskie*
*i bëra*
*vetes sime*
*që qëndisi yjet*
*me jehonën kristalore*
*të zemrës*
*Cila festë buronte nga zemra*
*në dasmë*
*Kam qenë një moçal*
*errësire*
*Tani kafshoj errësirën*
*si fëmija*
*gjirin*
*Tani jam i dehur*
*me univers*

### *KUJTIM NGA AFRIKA*

*Dielli pushton qytetin*
*Nuk shihet më*
*As edhe varret s'rezistojnë më më shumë*

*Pylli i Kurtonës, korrik 1918*

### *NA ISHTE NJEHERË*

*Pylli Kapuçio*
*ka një rrëpirë*
*me blerim të kadifejtë*
*si një kolltuk*
*i butë*
*përgjumem*
*vetëm*
*në një kafene të moçme*
*me një dritë të mekur*
*si drita*
*e kësaj hëne.*

### *PESHA*

*Ai fshatar*
*i beson medaljes*
*së Shën Antonit*
*dhe ikën ngadalë*
*Por krejt i vetmuar dhe krejt lakuriq*
*pa mirazh*
*sjell ai shpirtin tim.*
*1916*

### *PORTI I VARROSUR*

*Atje arrin poeti*
*dhe pastaj kthehet në dritë me këngët e tij*
*dhe i shpërndan ato*
*Nga kjo poezi*
*më mbetet*
*asgjëja e së fshehtës*
*së pashtershme*
*Mariano,29 qershor 1916*

### *SHKEPUTJE*

*Ja një njeri*
*uniformë.*
*Ja një shpirt*
*Shkretirë,*
*ja një pasqyrë e patundshme.*
*Më rastis shpesh të zgjohem*
*dhe të bashkohem*
*dhe të zotëroj*
*e mira që më lind rrallë*
*më lind kaq ngadalë*
*dhe si zgjati kaq*
*u shua pa u ndierë*

### *GONIA*

*Të vdesësh si laureshat*
*e etura*
*në një mirazh*
*Ose si shkurta*
*në shkurret e para*
*me të kaluar detin*
*sepse s'ka më dëshirë për fluturim*
*Dhe jo të jetosh me ankime*
*Si një gardalinë e verbuar në kafaz*

***Përktheu: Faslli Hliti***

TREGIM

# KORRIDORI I BUJTINËS SË MADHE

Nga Dino BUXATI

Në dhomën e bujtinës u ktheva shumë vonë; isha gjysmë i zhveshur, kur ndjeva nevojë të shkoja në banjë.

Dhoma ime ndodhej në fund të një korridori të pafund dhe paska të ndriçuar; thuajse në çdo njëzet metra, disa llambatina të mugëta ngjyrë vjollcë që lëshonin tufëza drite mbi tapetin e kuq. Gati kisha mbërritur te banjoja, kur u ndodha përballë një burri, i cili sikur mbiu nga hija; edhe ai kishte veshur një palë rroba dhome dhe vinte nga ana e kundërt. Ishte një zotëri i gjatë dhe i shëndoshë, me një mjekër të rrumbullakët si Eduardi VII. Mos qe nisur dhe ai për në banjë? Siç ndodh në këto raste, të dy sikur e ndjemë veten ngushtë e për pak desh u përplasëm. Unë, s'e di se si, u turpërova që po hyja në nevojtore në sytë i tij dhe vijova rrugën sikur po shkoja diku tjetër. Edhe ai bëri po atë veprim.

Sa përshkova disa hapa, e pashë që kisha bërë një marrëzi.

Po çfarë të bëja? Kisha dy mundësi: ose të vijoja rrugën deri në fund të korridorit, pastaj të kthehesha prapa, duke shpresuar që zotëria, ndërkohë do të ishte larguar. Po nuk ishte e thënë që ai të hynte në ndonjë dhomë e të më linte rrugën e lirë; mbase edhe ai donte të shkonte në banjë, por duke u ndeshur me mua, qe turpëruar, ashtu si unë; tani ndodhej po në gjendjen time të bezdisshme. Duke kthyer prapa kishte rrezik që ta takoja përsëri dhe kështu do të dukesha tamam si një budalla.

Ose, kjo ishte mundësia e dytë, të fshihesha në thellësi të korridorit, para ndonjë dere dhome mundësisht të ndriçuar pak dhe të hetoja, derisa të bindesha se kisha mbetur vetëm. Dhe ashtu bëra, pasi e studiova mirë gjendjen e krijuar.

Nisa të arsyetoj vetëm pasi u fsheha si hajdut, në njërën nga hapësirat e vogla para derës së dhomës me numër 90. Së pari, nëse dhoma do të qe e zënë dhe klienti do të dilte ose do të hynte, çfarë do të thoshte kur të dilte kur të më shihte të fshehur para derës? Edhe më keq akoma: po sikur kjo të ishte dhoma e burrit me mjekër? I cili, po të kthehej do më bllokonte? Atij me siguri që manovrat e mia do t'i dukeshin shumë të çuditshme. Me një fjalë, të qëndroja aty ishte një punë jo e mençur.

Ngadalë, ngadalë nxorra kokën për të hetuar korridorin.

Ishte plotësisht i zbrazur. S'dëgjohej asnjë zhurmë, asnjë hap apo zë njerëzor, asnjë gërvimë dere. Ishte çast i mirë: dola nga vendi i fshehtë me hapa të shkujdesur, shkova drejt dhomës sime.

Gjatë rrugës mendoja se do të kthehesha një çast në banjo.

Po pikërisht atë çast – e kuptova shumë vonë dhe nuk kisha si të veproja ndryshe, - zotëria me mjekër, i cili siç duket kishte arsyetuar njëlloj si unë, po dilte nga hapësira e ndonjë dere para dhomës, ndoshta dhoma ime, dhe po vinte përballë me vendosmëri.

Për të dytën herë, madje më shumë herën e parë, e ndjeva veten keq që po takoheshim para banjës; dhe për të dytën herë asnjëri prej nesh nuk guxoi të hyjë, duke u turpëruar që po e shihte tjetri; tani vërtetë që ishte rrezik të bëheshim qesharakë.

Duke mallkuar me vete respektin për njerëzit, nisa i mundur drejt dhomës time. Kur mbërrita, para se të hapja derën, u ktheva dhe pashë atje në gjysmë hije, pashë burrin me mjekër, i cili në mënyrë simetrike me lëvizjet e mia, po hynte në dhomë me kokën e kthyer nga ana ime.

U tërbova fare. Pse, a s'ishte faji im? Mora një gazetë dhe prita një orë. Pastaj hapa derën me kujdes në bujtinë ishte qetësi e madhe; si në një kazermë të braktisur; korridori ishte fare i shkretë. Më në fund. Brofa gati me vrap të mbërrija sa më parë në banjë.

Po nga ana tjetër, me një sinkronizëm të habitshëm, sikur të kishte vepruar telepatia, zotëria me mjekër doli nga dhoma e tij dhe me shpejtësi të madhe u nis drejt nevojtores.

U ndodhëm përballë njëri-tjetrit, për të tretën herë përpara derës me xhama akulli. Për herë të tretë simuluam dhe për herë të tretë vijuam rrugën pa hyrë brenda. Situata ishte kaq komike, sa do të mjaftonte pak gjë, një lëvizje, një buzëqeshje e lehtë që ta thyente akullin dhe gjithçka të kalonte me të qeshur. Po as unë, e siç duket as ai, nuk kishim dëshirë të talleshim; përkundrazi, mbretëronte një acarim i egër. Një ndjesi ankthi sikur ishte një makinacion që në mënyrë misterioze qe kurdisur kundra nesh.

Ashtu si në daljen e parë, rrëshqita e u fsheha para një dere të panjohur, duke pritur se si do të zhvilloheshin ngjarjet. Tani duhej të prisja që mjekroshi, me siguri i fshehur në cepin tjetër të korridorit, të dilte i pari nga llogorja: do ta lija të ecte një copë rrugë dhe vetëm në fund do të dilja edhe unë në mënyrë që të ndeshesha me të, jo para banjës, po shumë më larg, kështu që pasi ta kapërceja takimin me të, të isha i lirë të veproja pa dëshmitarë të bezdisshëm. Nëse ai, para se të më takonte, vendoste të futej në banjë, aq më mirë: do të kryente punë, do të kthehej në dhomë dhe tërë natën nuk do të dukej më.

Nxora syrin nga kasa e derës (nga largësia nuk mund të shikoja a po vepronte njëlloj edhe tjetri) dhe mbeta në pritë për një kohë të gjatë. U këputa duke ndenjur në këmbë, më në fund u ula në gjunjë pa e ndërprerë vëzhgimin. Po burri nuk po vendoste të dilte. E para, ai ishte me siguri atje, i fshehur atje në të njëjtën situatë si unë.

Dëgjova që ora ra dy e gjysmë, tre, tre e një çerek, tre e gjysmë. Nuk duroja dot më. U kuptua dhe më mori gjumi. U zgjova me eshtrat e dërrmuara në orën gjashtë të mëngjesit. Në fillim nuk më kujtohej asgjë. Çfarë kishte ngjarë? Pse ndodhesha përtokë?

Pastaj pashë të tjerë ashtu si unë; të veshur me rroba dhome, të fshehur në hyrjet e njëqind dyerve, të cilët ishin duke fjetur: dikush në gjunjë, dikush i ulur në dysheme, dikush duke fjetur në këmbë si mushkat: të gjithë ishin të zbehtë, të shpartalluar sipas një natë-beteje.




## "Shakaja" u ble nga 8% e numrit të përgjithshëm të popullsisë

Botimi i parë i romanit "Shakaja", i Milan Kunderës, në vitin 1967, është shitur në Çekosllovaki me një tirazh rekord prej 117.000 kopjesh? Ku në një vend (Çeki + Sllovaki) që s'i kalonte 15 milion banorët, u ble nga 8% e numrit të përgjithshëm të popullsisë?

Megjithëse një libër thellësisht disident që demaskonte komunizmin, romani çuditërisht nuk u censurua, megjithëse ndenji rreth 2 vjet në sirtarët e shtëpisë botuese.

Pak muaj më pas, kur Çekosllovakia u pushtua nga ish Bashkimi Sovjetik, libri u zhduk nga të gjithë libraritë.

Porse, me një modesti të mahnitshme, shkrimtari i madh Kundera, është shprehur "se ai nuk është ndjerë trim dhe disident kur ka shkruar librin, por kam patur vetëm një ndjesi të veçantë estetike". Në fakt, "Shakaja" përshkohet nga një frymë ekzistencialiste, kështu bëhet i kuptueshëm ky merak i autorit. Ndërkohë, në fillim romani injorohet nga Sh.B. "Gallimard" në Francë. Por, për fatin e tij të mirë, vepra bie në dorën e poetit Lui Aragon, i cili i entuziazmuar nga libri, e bind botuesin dhe "Shakaja" shkon në duart e lexuesit francez, tre javë pas pushtimit të Çekosllovakisë. Edhe kjo një rastësi fatlume që romani të shitej edhe atje në shifra rekord, duke u bërë më pas i famshëm në gjithë botën.

Milan Kundera është ndër shkrimtarët e paktë të gjallë të mëdhenj në botë. Ai ka shkëlqyer edhe në fushën eseistike, ku njëra nga veprat e tij "Mbi romanin" është përkthyer edhe në shqip.

# "Logos Hope"- Libraria gjigande lundruese

(Ka shkuar në çdo kontinent që nga viti 2008, kur zëvendësoi anijen tjetër "Doulos")

• *Anijet librari "Logos Hope" dhe "Doulos". Fotoja e "Doulos", i përket aparatit tim, shkrepur në Durrës, më 2004).*

E shihni anijen në foto? Është "Logos Hope"- libraria më e madhe lundruese në botë. Që nga vitit 2008, ajo ka prekur portet e 5 kontinenteve, 90 shteteve të ndryshme, midis të cilëve edhe në Shqipëri, rreth 10 vjet më parë.

"Logos Hope" është iniciativë e një organizate gjermane "GBA", që tregëton libra kryesisht në anglisht në gjithë botën. Anija gjigande u ble nga pronarët aktualë në vitin 2004 dhe pas 4 vjetësh, kreu udhëtimin e parë transoqeanik. Salla e saj kryesore s'është gjë tjetër, vecse një librari e madhe e modeluar hijshëm me literaturë për të gjithë moshat dhe zhanret. Ajo ka një kapacitet të tillë, që mund të presë deri në 800 vizitorë, ndërkohë që për ta shërben një ekuipazh prej rreth 100 personash. Këta të fundit, përzgjidhen të racave dhe kombësive të ndryshme, në mënyrë që t'i përshtaten kombësive dhe vendeve që vizitojnë. "Logos Hope" udhëton dhe tregton libra, thuajse në gjithë muajt dhe diku rreth vitit 2008-2009, ka qenë 1 javë edhe në Shqipëri, ankoruar në Portin e Durrësit. Anija zëvendësoi në një farë mënyre, anijen "Doulos", sërish e poseduar nga organizata "GBA", e cila me të njëjtën madhësi dhe formulë, shkoi pranë lexuesit të globit për gati 2 dekada. Edhe "Doulos" e ka vizituar Shqipërinë në vitin 2004 dhe është interesant fakti, që Durrësi ka qenë porti i fundit që ajo është ankoruar për lexuesin e botës, para se të shitej nga poseduesit.

# NË UDHËKRYQ PËR DIALOGUN

Lidhja Demokratike e Kosovës, Ekipin negociator vazhdon ta konsiderojë si jolegjitim për ta përfaqësuar Kosovën në procesin e dialogut, Kosovë-Serbi. Ky subjekt politik thekson se Ekipi negociator, nuk e përfaqëson askënd dhe nuk e përfaqëson shumicën parlamentare. Këtë qëndrim e ndan edhe Vetëvendosja e Albin Kurtit

Përfaqësuesit e Ekipit negociator të Kosovës thonë se po punohet në platformën për fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi, që po zhvillohet në Bruksel me lehtësimin e Bashkimit Evropian. Autoritetet qeverisëse në Kosovë, pa dy partitë më të mëdha opozitare, po hartojnë platformë dhe miratojnë Ligjin për dialogun, ndërkohë që nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian u bëhet e qartë se vazhdimi i dialogut ndërlidhet me pezullimin e tarifës doganore që u është vendosur importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Njëri nga kryesuesit e Ekipit negociator, Fatmir Limaj, i cili është edhe zëvendëskryeministër i Kosovës tha për Radion Evropa e Lirë, se në javën e ardhshme do të përfundojë puna në platformën për bisedime dhe më pas ajo do t'i dërgohet Kuvendit të Kosovës.

"Nëse nuk do të mund ta unifikojmë faktorin politik në Kosovë, të paktën duhet të unifikojmë qëndrimet dhe jeni duke punuar fort në draftimin dhe përfundimin e platformës për dialogun dhe shpresoj që ajo platformë të paraqesë ose të reflektojë qëndrimet e përbashkëta të faktorit politik të Kosovës që do të dërgonte një mesazh dhe Kosova përfundimisht ta ketë një pozicion zyrtar në raport me dialogun me Serbinë", tha Limaj. Limaj tha se partitë politike opozitare do të ftohen për të kontribuuar në këtë proces dhe po ashtu do të informohen me takimet e zhvilluara deri më tash në Bruksel dhe punën e bërë.

"Qëndrimi i Republikës së Kosovës, ose platforma jonë, konsiston në ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës. Dokumentet bazë që kanë sjellë pavarësinë e Kosovës, deklarata e pavarësisë, pakoja e Ahtisaarit, vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e kështu me radhë. Me një fjalë, e gjithë platforma është ndërtuar në frymën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës", tha Limaj. Nga ana tjetër, Lidhja Demokratike e Kosovës, Ekipin negociator vazhdon ta konsiderojë si jolegjitim për ta përfaqësuar Kosovën në procesin e dialogut, Kosovë-Serbi. Ky subjekt politik thekson se Ekipi negociator, nuk e përfaqëson askënd dhe nuk e përfaqëson shumicën parlamentare. Nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, tha për Radion Evropa e Lirë, se LDK-ja pavarësisht kërkesave të ndryshme që të jetë pjesë e dialogut, nuk ka ndryshuar mendje. "I ashtuquajturi Ekip negociator është vetëm duke prodhuar mjegull për shitje në politiken e Kosovës dhe që ka konsum të brendshëm. Formati i negociatave është presidencial dhe natyrisht agjenda dhe parimet e negociatave janë vendosur nga Grupi i Kontaktit qysh në qershor të vitit të kaluar. Ky mekanizëm është në funksion të agjendës që presidenti i republikës në negociata do ta ketë. Ndërsa opozita është në Prishtinë. Opozita vazhdon të ndërtojë veprime opozitare me të gjitha kapacitetet e saja për t'i qëndruar gardian politik Republikës së Kosovës", tha Haziri.

Haziri thekson se Partia Socialdemokrate që është ndarë nga subjekti opozitar Lëvizja Vetëvendosje është bërë urë në koalicionin aktual qeverisës dhe për të marrë pjesë në dialog dhe pjesëmarrje indirekte në qeverisje. Për me tepër, Haziri thekson se deri tash, asnjë veprim serioz nuk është ndërmarrë nga institucionet apo partnerët e koalicionit qeverisës për një zgjerim apo pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në negociata Kosovë- Serbi.

"Për shembull, kryetari i PDK-së mund ta bëjë aktin e tij, të largimit nga ulësja e kryetarit të Kuvendit dhe të krijojë mundësinë që partitë e opozitës edhe në qeveri edhe në Kuvend të hapin një dialog për pjesëmarrje në mënyrë që të shkaktohet një marrëveshje e brendshme politike për një unitet gjithëpërfshirës në Kosovës. Kjo nuk po ndodh përkundrazi", tha Haziri. Sipas modelit politik që partitë e koalicionit janë duke ushtruar, Haziri thotë ato janë duke ushtruar detyrën e administrimit dhe nuk bëhet fjalë për qeverisje. Kurse, Jeta Krasniqi, njohëse e procesit të dialogut politik Kosovë-Serbi, nga Instituti Demokratik i Kosovës, tha se procesi aktual i delegacionit të Kosovës, mungesa e transparencës vazhdon të jetë e njëjtë, siç ka qenë edhe me herët. "Mjegulla vazhdon dhe duhet të shikohet se si te ecet përpara, por ne ketë version edhe pse kemi një delegacion shtetëror, fragmentimi në skenën politike në vend ende është duke vazhduar ashtu siç ka qenë edhe me parë. Në ndërkohë, mungesa e një konsensusi edhe një qëndrimi unik të shtetit të Kosovës është duke vazhduar veçanërisht mbi çështjen e integritetit territorial të Kosovës apo kufjve të Kosovës", tha Krasniqi.

Lidhur me mosraportimin në Kuvend për takimet e deritanishme në Bruksel, Limaj tha se deri tash nuk ka pasur ndonjë gjë të rëndësishme për të cilën është parë e nevojshme që të raportohet në Kuvend. "Takimet që kemi pasur deri tani në Bruksel, kemi biseduar për modalitetet se si duhet të fillohet dialogu gjithëpërfshirës final dhe më tepër janë takime të përgatitjeve teknike se si duhet të fillojë dialogu", shpjegoj Limaj. Sidoqoftë, Kuvendi i Kosovës ka arritur ta krijojë një Ekip negociator, i përbërë nga përfaqësuesit e partive politike në pushtet, si dhe nga subjekti opozitar, Partia Socialdemokrate. Dy partitë tjera më të mëdha në opozitë, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, kanë refuzuar të jenë pjesë e këtij ekipi.

## Shqipëria ka blerë energji çdo ditë nga 1 milion euro!

Mbi 1 milion euro në ditë ka shpenzuar Shqipëria për të blerë energji nga importi gjatë 2019-s. Ndryshimi i situatës hidrike me pasojë rënien e nivelit të ujit në Liqenin e Fierzës ka detyruar OSHEE që për janarin dhe javën e parë të shkurtit të importojë energji me vlerë 38,5 milionë euro për të siguruar furnizim pa ndërprerje.

"Gjatë vitit 2019, në janar është bërë një blerje energjie rreth 390 mijë megavat orë me një kosto të përafërt i bie 35 milionë euro pa TVSh e njëjta situatë e vështirë në furnizim i shfaq edhe gjatë periudhës 1 deri në 7 shkurt, sasia e energjisë prej 50 mijë mega u kontraktua për një kosto totale prej 3,8 milionë euro", tha Elton Sevrani, drejtor i Divizionit Tregtar në OSHEE, raporton Top Channel. Importet ndikojnë jo pak në financat e OSHEE dhe për rrjedhojë edhe në çmimin final të energjisë për konsumatorët familjare qe prej disa vitesh paguajnë 9,5 leke për çdo kilovat ore energji.

Gjithsesi OSHEE thotë çmimi për qytetarët nuk do të preket. Sipas saj ka një përmirësim të situatës dhe kostot e larta e importit me rritje nga 60-70% do të përmirësohen gjatë pranverës. "Në krahasim me 2018-n, janari ka rritur kostot për njësi një masë prej 60-70%, në krahasim me 2018, ne shpresojmë që në muajt e pranverës ta reduktojmë këtë kosto. Reduktimi i kostos për njësi nënkupton më shumë mundësi për mirëmbajtje dhe investime ne rrjetin e shpërndarjes dhe asnjë rast rritje të çmimit për klientë fundore", tha Sevrani.

Nga gjithë sasia e energjisë së hedhur në rrjet deri e më tani për 2019-ën rreth 70% ka qenë nga importi.

# Kompromis me Kosovën nëse shfuqizohet taksa

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se nëse Kosova e shfuqizon taksën, Serbia do të përpiqet të bëjë kompromis

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se shteti i tij gjithmonë do të tentojë që të bëj kompromis me Kosovën vetëm nëse kjo e fundit e shfuqizon taksën që ka vendosur ndaj mallrave serbe. "Ne po presim që të shfuqizohen këto tarifa të pavlera. Nëse nuk i ndalojnë ato, do të jetojmë me këtë problem, do të jetojmë me këto probleme dhe do të ndihmojmë popullin tonë në Kosovë, e nëse i heqin ato, ne gjithmonë do të përpiqemi të bëjmë një kompromis, por kurrë nuk do të lejojmë që askush të shkatërrojë Serbinë dhe të mendojë se Serbia është e vogël dhe e dobët dhe se mund ta poshtërojë atë që nga 2012-ta", ka thënë sot Vuçiq, i cili shtoi se ai nuk mund të flasë sikur të tjerët pasi thotë se nuk është gënjeshtar.

"Ne do të punojmë së bashku", tha tutje Vuçiq, duke shtuar se Serbia gjithmonë do të tentojë të bëjë kompromis me kosovarët, nëse shfuqizohet taksa doganore. Ndryshe që nga 21 nëntori i vitit të kaluar, Qeveria e Kosovës kishte futur në fuqi taksën prej 100 për qind për mallrat serbe dhe boshnjake, kurse më vonë, Qeveria kishte marrë vendim që në këtë taksë të përfshihen edhe brendet e njohura botërore të cilat hyjnë nga këto dy shtete.

Që nga vendosja e taksës Serbia ka bllokuar edhe bisedimet me Kosovën. Ndërkaq heqjen apo pezullimin e taksës nga Kosova e kanë kërkuar edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe Bashkimi Evropian, pasi që në këtë mënyrë sipas tyre, do të mund të vazhdohet edhe dialogu me Serbinë.

# FRANCA NUK BËHET RAHAT

**Për të 13 herë në Francë "jelekverdhët" kanë protestuar dhe sërish ka pasur trazira mes policisë dhe protestuesve**

Në Francë sërish lëvizja "jelekverdhët" organizoi protesta në rrugë për të 13 herë. Disa mijëra vetë marshuan në Paris nga harku i Triumfit përgjatë bulevardit Champs-Elysées në drejtim të kullës Eiffel. Gjatë konfrontimeve mes policisë dhe demonstruesve para godinës së parlamentit të paktën një person u plagos rëndë. Televizioni BFM TV duke iu referuar prefekturës së policisë, njoftoi se një burrë ka humbur katër gishta. Bëhet fjalë për fotografin e lëvizjes "jelekverdhët".

Një dëshmitar okular i ka thënë agjencisë së lajmeve AFP, se plaga është shkaktuar prej një granate me tym. Me këtë forcat e rendit synonin t'i mbanin demonstruesit larg godinës së parlamentit. Personi i plagosur ka dashur të mbrohej me dorë prej granatës. Kur ai e preku atë, ajo shpërtheu. Dëshmitari okular Cyprien Royer i tha RT Francë se ai dhe i plagosuri ishin pranë Asamblesë Kombëtare, ku një grup njerëzish të veshur me të zeza po përpiqeshin të ndalnin rrugën e tyre. "Ai djali po vëzhgonte. Policia mbërriti dhe filloi të hidhte granata. Një granatë fluturoi drejt e nën këmbët e djaloshit dhe ai u përpoq ta shtyjë me dorë, por ajo shpërtheu dhe dora e tij u 'shpërbë'", shpjegoi Royer.

Më tej dëshmitari shtoi: "Ai u mbajt mbi ne. Ne e mbështetëm atë në një mur ku nuk kishte njerëz. Ai po bërtiste, pasi ishte në një gjendje të tmerrshme. Ne thirrëm për ndihmë mjekësore dhe shumë, edhe mjekë erdhën aty. Në fillim as nuk e kuptuam nëse ai e kishte apo jo dorën e tij". Ndërkohë, ky nuk është incidenti i parë i rëndë që ndodh në protestat e Jelekverdhëve, pasi pak kohë më parë një nga liderët e tyre humbi një sy, teksa u godit drejtpërdrejtë nga policia me plumb gome.

Të dielën ka pasur edhe disa incidente tjera. Demonstruesit hidhnin sende ndaj forcave të rendit, që vunë pjesërisht në përdorim gazin lotsjellës dhe shkopinjtë e gomës. Sipas të dhënave të policisë, deri pasdite u arrestuan dhjetë vetë. Kësaj radhe protesta drejtohej kundër një ligji të planifikuar, që parashikon lehtësimin e ndalimit të demonstratave dhe dënime më të ashpra për demonstruesit e maskuar. Disa aktivistë qëllimisht kishin dalë të maskuar në protesta. Edhe në qytete të tjera të Francës si në Bordeaux, Toulouse dhe Nantes ka pasur manifestime proteste.

Pjesëmarrja në protestat e nisura para gati tre muajsh kohët e fundit është ulur. Të shtunën e kaluar, sipas të dhënave të ministrisë franceze të Punëve të Brendshme dolën në protesta në rrugë 58.600 vetë kundër politikës së presidentit Emmanuel Macron. Vet "jelekverdhët" bënë fjalë për 116.000 demonstrues. Në fillim të lëvizjes së protestës në mes të nëntorit numri i pjesëmarrësve në demonstrata ka qenë mbi 280.000.

## "ITALIA PO NA PROVOKON", FRANCA TËRHEQ AMBASADORIN NGA ROMA

**Pas grindjeve prej disa javësh mes qeverisë së Francës dhe qeverisë populiste të djathtë në Romë, Parisi ka tërhequr për konsultime ambasadorin e vet nga Roma. "Ndërhyrjet e fundit të Italisë në politikën e brendshme franceze janë një provokim i papranueshëm. Mbështetja e lëvizjes së jelek-verdhëve nga politika e Romës cenon respektin, për të cilin janë të detyruara ndaj njëra-tjetrës qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike dhe të lirë", komunikoi Ministria e Jashtme franceze. Përfaqësuesi i qeverisë franceze u shpreh i indinjuar edhe ndaj takimit të fshehtë të zëvendëskryeministrit italian Luigi Di Maio me përfaqësues të "jelekverdhëve" të martën në Paris. Vetëm katër muaj para zgjedhjeve për Parlamentin Europian qeveria në Romë fare hapur është angazhuar për lëvizjen e protestës, që kërkon tërheqjen e presidentit Macron. Kalkulimi që me sa duket bëjnë populistët është të fitojnë pikë në elektorat për zgjedhjet europiane.**

## Beteja e fundit me ISIS-in

Forcat e sigurisë të mbështetura nga Shtetet e Bashkuara në Siri, u bllokuan të dielën në mëngjes në luftime të ashpra gjatë operacionit për të luftuar kundër enklavës së fundit të kontrolluar nga grupi ekstremist Shteti Islamik, afër kufirit me Irakun. Monitoruesi britanik i të Drejtave të Njeriut në Siri ka raportuar luftime të ashpra në mes të dyja palëve, gjatë sulmit ajror të koalicionit të udhëhequr nga SHBA-ja, me artileri të fuqishme për të shkatërruar zonat e militantëve. Pas një pauze më shumë se një javë, që lejonte largimin e 20.000 civilëve nga zona, Forcat Demokratike të Sirisë thanë se janë duke lansuar një luftim të fundit për të larguar grupin ekstremist nga territori. Dy vjet më parë, grupi militant Shteti Islamik ka kontrolluar pjesë të mëdha të Sirisë dhe Irakut. Më 6 shkurt, presidenti i SHBA-së, Donald Trump tha se "duhet të njoftohet se ndoshta gjatë javës tjetër, ne do të zotërojmë 100 për qind të kalifatit".Trump tha në dhjetor se militantët e Shtetit Islamik kryesisht janë larguar dhe njoftoi për largimin e 2000 trupave amerikane nga Siria.

## Viti i ri në Kinë, myslimanët detyrohet të hanë mish derri

Komuniteti i myslimanëve që jetojnë në Kinë në rajonin Xianjiang, janë detyruar dhunshëm të konsumojnë mishin e derrit dhe të pinë alkool gjatë një eventi për festimin e Vitit të ru lunar, që këtë herë përkon me derrin si kafshë. Banorët në Ili Kazakh kanë rrëfyer për "Daily Mail" se ishin ftuar në darkën e shtruar me rastin e festimit të Vitit të Ri kinez, ku është servirur mish derri dhe alkool.

"Zyrtarët kinezë i kanë kërcënuar ata se do t'i dërgojnë në kampet e riedukimit, nëse refuzojnë të marrin pjesë në event", raporton Radio Free Asia. Fotot e eventit shfaqin zyrtarët kinezë në qytetin Yining duke vizituar komunitetin mysliman, ku në ambiente shihet mishi i derrit që servilet kudo. Ata madje janë detyruar dhunshëm nga autoritetet të dekorojnë shtëpitë sikurse kinezët me rastin e Vitit të Ri kinez. Kujtojmë se konsumimi i mishit të derrit nga myslimanët përbën një shkelje të besimit, pasi libri i tyre i shenjtë tregon se në Islam, derri dhe alkooli janë të ndaluara.

## Përdhunimet nuk ndalen, presidenti shpall emergjencë kombëtare

Kaos, tension dhe frikë në Sierra Leone! Presidenti i vendit ka shpallur një emergjencë kombëtare, për shkak të përhapjes së gjerë të përdhunimeve dhe dhunës seksuale në vend. Julius Maada Bio tha se gjithkush që gjendet fajtor për dhunë seksuale ndaj të miturve do të përballet me burgim të përjetshëm.

Një e treta e mbi 8 mijë rasteve të dhunës seksuale dhe për shkak të gjinisë, që njoftohet në Sierra Leone vitin e kaluar, ishte ndaj të miturve.

Numri i saktë mendohet të jetë edhe më i lartë, por në përgjithësi në vendin afrikano-perëndimor, është tabu të flasësh për krimet seksuale. "Ne si vend, duhet të ngrihemi dhe ta godasim këtë plagë të rëndë", Tha presidenti Bio kur shpalli emergjencën.

Ai tha se spitalet qeveritare do të ofrojnë trajtim mjekësor falas për viktimat e përdhunimit dhe abuzimit seksual. Përveç kësaj, Bio tha se një divizion i veçantë për viktimat e përdhunimit dhe dhunës seksuale dhe një gjykatë e posaçme do të ngrihet për t'i trajtuar me shpejtësi këto raste.

# "TOPLESS" NË PLAZH, LIHET NË FUQI DËNIMI NDAJ 3 AKTIVISTEVE

**Heidi Lilley, Kia Sinclair dhe Ginger Pierro ishin pjesë e fushatës "Çlironi thithkat", një fushatë globale në mbrojtje të të drejtave të grave për të dalë "topless". Ato u arrestuan në vitin 2016, pasi hoqën veshjet e sipërme në një plazh të Laconias dhe refuzuan të visheshin kur plazhistë të rastit u ankuan**

Gjykata më e lartë e New Hampshire në Shtetet e Bashkuara ka lënë në fuqi dënimin e 3 femrave, të cilat kishin dalë "topless" në plazh, duke argumentuar se të drejtat e tyre kushtetuese nuk janë shkelur. Në vendimin me 3 vota pro lënies në fuqi dhe dy kundër, gjykata vendosi se ligji për ekspozimin e pahijshëm në qytetin Laconia të New Hampshire nuk është diskriminues mbi baza gjinore, e aq më pak të shkelë lirinë e shprehjes për gratë.

Duke cituar vendimet nga disa gjykata të tjera, gjykatësja Anna Barbara Hantz Marconi shkroi se gjykatat "përgjithësisht lënë në fuqi ligjet që pengojnë femrat, por jo meshkujt, të ekspozojnë gjoksin kundër sfidave të mbrojtjes së barabartë". "Ne kemi zbuluar se urdhëresa nuk shkel të drejtat kushtetuese të të pandehurave për mbrojtje të barabartë ose lirinë e shprehjes sipas Kushtetutës shtetërore dhe asaj Federale, - shkroi më tej Marconi. - Si e tillë, ajo nuk kufizon padrejtësisht të drejtat themelore të të pandehurave. Kështu që ne biem dakord se qyteti në fjalë ka autoritetin për të nxjerrë urdhëresa të tilla".

Por, në një mendim ndryshe, gjykatësit James P. Bassett dhe Gary E. Hicks dolën në përfundimin se urdhëresa ishte antikushtetuese, sepse i trajton meshkujt dhe femrat në mënyra të ndryshme.

Heidi Lilley, Kia Sinclair dhe Ginger Pierro ishin pjesë e fushatës "Çlironi thithkat", një fushatë globale në mbrojtje të të drejtave të grave për të dalë "topless". Ato u arrestuan në vitin 2016, pasi hoqën veshjet e sipërme në një plazh të Laconias dhe refuzuan të visheshin kur plazhistë të rastit u ankuan. Pierro, asokohe ishte duke bërë joga, ndërsa dy femrat e tjera banjo dielli. Ligji kundër ekspozimeve të pahijshme në Laconia ndalon seksin, ndërsa veçon femrat kur ndalon "shfaqjen e gjoksit femëror pa të paktën një mbulesë të errët të thithkave".

## Kujtimet e humbura mund të rizgjohen

Kujtimet e humbura mund të rizgjohen tek të sëmurët me alzheimer dhe ndihma për këtë vjen nga lazerët. Një ekip shkencëtarësh të Universitetit të Columbias pretendon se kujtimet në fakt nuk zhduken, thjesht bëhet më e vështirë që të mbërrish deri tek ato. Kërkuesit morën dy grupe minjsh, një me prirje për sëmundje të tilla e tjetri jo dhe pas testeve të memories, zbuluan se neuronet e lidhura me kujtesën arrijnë të stimulohen me lazer duke risjellë në mendje informacione që konsideroheshin të zhdukura. Eksperimenti ushqen shpresat se metoda mund të funksionojë edhe mbi të sëmurët me alzheimer, për të cilët deri tani mendohej se sëmundja ua fshinte krejtësisht kujtimet. Por të dhënat e reja tregojnë se kujtimet e humbura mund të rizgjohen përmes aktivizimit artificial të neuroneve ku ato janë depozituar. Alzheimeri është një sëmundje progresive e trurit që prek zakonisht personat e moshës së mesme apo të thyer, duke i shkatërruar kujtesën dhe funksione të tjera bazike. Ajo përbën llojin më të shpeshtë të demencës dhe probleme të ndryshme mendore. Simptomat e para janë boshllëqet e memories që vijnë dalëngadalë në përkeqësim, duke ia bërë të vështirë të sëmurit jetesën normale. Edhe pse ilaçet mund të ndihmojnë në përmirësimin e situatës, për alzheimer-in nuk ka shërim të plotë.

## Kafshimi i thonjve, i rrezikshëm për shëndetin

Jo vetëm që kafshimi i thonjve është një zakon i keq, por ai gjithashtu është shumë i rrezikshëm për shëndetin tuaj. Çdo herë që kafshojmë thonjtë tanë, ne rrezikojmë "të tërheqim në fyt" viruset dhe bakteret, të cilat në afat të gjatë dobësojnë imunitetin dhe pastaj çdo sulm i ri i mikroorganizmave patogjene bëhet gjithnjë e më e rrezikshme, paralajmëron Adam Friedman, profesor i dermatologjisë në Universitetin e Uashingtonit DC. "Kur vendosni thonjtë në gojën tuaj, nuk ka kufizim të baktereve dhe viruseve, dhe futja e tyre në trup mund të rezultojë me ftohje, por edhe virus serioz të stomakut. Nëse kafshoni një pjesë të tepërt, është e mundur që të ekspozoni lëkurën e ndjeshme nën thua ndaj miliona mikroorganizmave patogjenë, andaj shumë lehtë mund të infektoheni", shpjegon Friedman. Ai paralajmëron se kjo është një nga format më të zakonshme të infeksionit të paronihisë, që mund të shkaktojë ënjtje, skuqje, dhembje dhe shfaqje të gungave plagësh.

## Efekti i çuditshëm që ka Peppa Pig te fëmijët po shqetëson prindërit

Fëmijët kanë nisur të gërhasin në fund të fjalive pasi shohin shumë Peppa Pig në televizor, laptop, tableta apo celularë. Disa prindër po shqetësohen shumë nga ai që e quajnë "Efekti Pepa". Në faqen e prindërve Romper, disa amerikanë kanë shtruar shqetësimin se fëmijët po imitojnë derrkucët e serialit. "Në fillim u kënaqa që vajza po tërhiqej nga një serial, por tani ka filluar të bëjë si derrkuc pasi përfundon fjalitë", shkruajnë prindërit. Seriali vizatimor është shumë i famshëm te fëmijët e vegjël të grupmoshës 2-6 vjeç.

## Eksperimenti "i dështuar": 560 euro në muaj të papunëve dhe...

Një eksperiment që iu ofronte të papunëve 560 euro në muaj për dy vite, duket se ka rritur mirëqenien e përgjithshme të përfituesve, por ka dështuar t'i nxisë ata të gjejnë një punë dhe të fitojnë më shumë, siç kishin shpresuar zyrtarët finlandezë. Të përzgjedhur në mënyrë rastësore, 2.000 finlandezë të papunë të moshës nga 25 deri në 58 vjeç u bënë të parët europianë që gëzonin një të ardhur bazë të garantuar.

Ata marrin çeqe mujore prej 560 eurosh nga shteti për dy vite, pa kushte, pavarësisht nëse gjejnë punë apo jo. Sipas ideusve të projektit, të ardhurat bazë mund të nxisin njerëzit të nisin një biznes të ri, duke e ditur se do të vazhdojnë të marrin pagesën për çdo muaj, pavarësisht sesi do të shkojë sipërmarrja e tyre. Kritikët, ndërkohë, thonë se pagesa redukton dëshirën e njerëzve për të kërkuar punë. Në mesin e projektit, zyrtarët finlandezë thonë se pasojat te punësimi duken se kanë qenë minimale. Sidoqoftë, ata që marrin pjesë në projekt, raportohet se janë më të lumtur dhe më të shëndetshëm sesa të tjerët.

Finlanda po kërkon mënyra të reja për të rindërtuar sistemin e saj të sigurisë sociale dhe u bë në janar të vitit 2017, vendi i parë europian që nisi një eksperiment të tillë, që do të përfundojë në vitin 2020. Projekti ofron siguri për ata që nuk munden, ose që zgjedhin të mos punojnë, me qëllim që t'i inkurajojë ata të bëjnë ndoshta edhe punë jo të paguara mirë, apo punë të përkohshme, pa frikën se do të humbin përfitimet e tyre.

# NUHIU ZËVENDËSON DURON TE DRITA

**Pas largimit të trajnerit Shpëtim Duro nga ekipi i Dritës, pritet që drejtimin e klubit kosovar ta merr trajneri shkupjan Ardian Nuhiu i cili deri më tani ishte ndihmës trajner i Shpëtim Duros**

Shkup, 11 shkurt - Një ditë pasi Drita u eliminua nga Kupa e Kosovës, trajneri Shpëtim Duro ka dhënë dorëheqje duke i dhënë fund qëndrimit të shkurtër pothuajse pesëmujor në drejtim të klubit kosovar. Kampioni në fuqi i Kosovës, u eliminua nga Digitalb Kupa e Kosovës pasi humbi 1-0 në çerekfinale ndaj Vëllaznimit, klubit që bën gara në Ligën e Parë, nivelin e dytë të futbollit kosovar. Si pasojë, trajneri nga Shqipëria Duro dhe Drita kanë vendosur t'i ndajnë rrugët një ditë më vonë. Në një njoftim në faqen e vet zyrtare në Facebook, klubi nga Gjilani njoftoi se Duro ka dhënë dorëheqje pas një mbledhjeje me kryesinë e klubit. "Klubi jonë FC Drita ju njofton që ka dhënë dorëheqje kryetrajneri Duro! Pas një takimi që kishim menjëherë pas ndeshjes së djeshme, me një marrëveshje mes dy palësh është vendosur që të ndërpritet bashkëpunimi", thuhet në njoftimin e Dritës. Duke qenë se Drita e nisi në mënyrën më të keqe të mundshme mbrojtjen e titullit në Superligë këtë sezon, synimi i vetëm i klubit mbeti kupa shtetërore. Por, me eliminimin e befasishëm nga kjo garë, vjen edhe largimi i Duros. "Pas eliminimit nga kupa e Kosovës, dhe dalja nga objektivi i vetëm i klubit për këtë sezon, z.Duro ka ofruar dorëheqjen, gjë që është pranuar nga klubi bardh e kaltër. FC Drita e falënderon profesor Duron për punën profesionale që ka bërë me klubin dhe i dëshiron shumë suksese", thuhet në njoftimin e klubit kosovar. Në 12 ndeshje sa e udhëhoqi Dritën në Superligë, Duro regjistroi 6 fitore, 4 humbje dhe dy barazime dhe tani, pak ditë para fillimit të stinorit pranveror, e lë klubit gjilanas në pozitën e gjashtë me 23 pikë. Nga ana tjetër drejtimin e ekipit të Dritës, tani sipas shumë gjasave pritet ta merr trajneri shkupjan Ardian Nuhiu i cili deri më tani ishte ndihmës trajner i Shpëtim Duros. Nuhiu më herët ka udhëhequr skuadrën e FC Shkupit, ndërsa Drita do të jetë klubi i dytë në karrierën e tij si shef i shtabit.

## Maqedonia U21 në "Antalia Kup"

Shkup, 11 shkurt - Reprezentacioni i Maqedonisë, në futboll deri në moshën 21 vjeçare, muajin e ardhshëm pritet të zhvilloj disa ndeshje kontrollues para fillimit të kualifikimeve për Kampionati Europian 2021, që do të zhvillohet në Hungari dhe Slloveni. Siç njoftojnë nga Federata e Futbollit të Maqedonisë, nga data 20 deri me 27 mars, ekipi i shpresave të Maqedonisë në futboll do të marrë pjesë në turneun "Antalia Kup 2019", në Turqi. Në grupin që merr pjesë Maqedonia, po ashtu renditen edhe Lituania, Kazakistani, Ukraina dhe Estonia. Fakti më interesat është se në këtë turne, Maqedonia do të ballafaqohet me ekipin e shpresave të Kazakistanit, me të cilin po ashtu pritet të përballet në ndeshjen kualifikuese për KE 2021, që fillojnë në shtator të këtij viti. Ndryshe, në këto kualifikime Maqedoni, si rival për kualifikime do ti ketë edhe shtetet si Spanja, Izraeli, Mali i Zi dhe Ishujt Faroe. *(F.N)*

## Renova fiton miqësoren ndaj Teteksit

*Shkup, 11 shkurt* - Skuadra e Renovës në mënyrën më të mirë ka përfunduar përgatitjet për sezonin pranveror. Të dielën ekipi nga Xhepçishti i Tetovës zhvilloi testin e fundit para fillim të pjesës së dytë të kampionatit. Renova me rezultatin e thellë 7:1 shënoi fitore ndaj Teteksit. Për Renovës nga dy gola shënuan Vllatko Stojanovski dhe Bilali, ndërsa në listën e golashënuesve u shënuan, Gafuri, Miovski si dhe transferimi më i ri i "gjipspunuesve" Mbella. Ekipi i Renovës ndeshjen e parë për sezonin pranveror do ta zhvillon me 17 shkurt, ku do të jetë mysafire e Rabotniçkit. *(F.N)*

KARATE U21

## Osmani shpallet kampion i evropian

*Shkup, 11 shkurt* - Reprezentacioni i Maqedonisë nga data 8 deri më 10 shkurt mori pjesë në kampionatin evropian në karate për kadet, junior dhe U21, ku garuan 1200 garues nga 51 shtete. Maqedonia u radhit në vendin e shtatë që është një rekord për të parën herë, ku arritën të fitojnë dy vendet të para dhe dy vende të dyta. Karateisti, Doan Osmani është shpallur kampion i Evropës për junior në karate, pasi që në finale mundi karateistin nga Gjeorgjia, Nikita Beljavskin me 4-0. Pas dy medaljeve të argjendit që arkëtoi Maqedonia në dy ditët e kaluar në Alborg të Danimarkës, Doan Osmani siguroi medaljen e artë për Maqedoninë, duke deklasuar konkurentët e tij në kategorinë e luftërave dhe në peshat deri më 75 kg. "Jam i kënaqur shumë pasi e vërtetova edhe si trajner i KK Fatit me garuesin e klubit tonë Doan Osmani. Dëshmuam se ky klub është serioz dhe fabrikë e kampionëve Evropian si Berat Jakupi dhe tani Doan Osmani. Jam shumë i kënaqur nga ky rezultat madhor i Doanit, gjithçka u bë me punë të madhe dhe serioze me një disiplinë dhe program vite me radhë, por tani erdhi koha që të del në sipërfaqe rezultati. Urime Doanit, anëtareve të klubit të karatesë "Fati", prindërve dhe kontribuuesve të klubit", deklaroi Arlind Huseini, seleksionues i reprezentacionit të Maqedonisë në karate në kategorinë U21. *(F.N)*



ZAEVI NGA SARAJEVA

## Bashkimin që e krijon sporti, të reflektojë në gjithë Ballkanin

*Shkup, 11 shkurt* - Bashkimi dhe uniteti të cilat i krijon sporti duhet të reflektojnë në gjithë Ballkanin dhe së bashku të lëvizim drejtë së ardhmes evropiane, theksoi kryeministri Zoran Zaev në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, pas ceremonisë së hapjes së Lojërave Olimpike Rinore në stadiumin "Asim Ferhatoviq Hase". Shtetin tonë në këtë festival e përfaqësojnë Ana-Marija Zafirovska dhe Nikolla Petkovski. Ato nesër do të garojnë në disiplinën "kros kantri". Për ta pjesëmarrja në Lojërat Rinore Olimpike është përvojë e re dhe e parë internacionale për parapërgatitje për lojërat e ardhshme olimpike në vitin 2022. Kryeministri Zaev

duke e shfaqur mbështetjen për këta dy të rinj", tha se për një vend nuk ka ambasador më të madh se sa sporti. "E shfrytëzoj mundësinë që t'i shprehë ndjenjat, të shkëlqyeshme këtu në hapjen e Lojërave Olimpike Rinore ose Festivalin Evropian Olimpik Rinor, çka me rastin e 35 vjetorit të Lojërave Olimpike Sarajevë '84 dhe Vuçko i njohur hapen këtu. Me të vërtetë ndjenja është e shkëlqyer. Mua më kujton ato 10 vite kur i kisha, kur bukvalisht e gjithë Jugosllavia, e gjithë Evropa dhe besoj se e gjithë bota ishte përqendruar me sytë hapur drejtë Sarajeva '84. Ndërsa tani kisha rastin edhe që të shoh ndjenjat e kryeministrit Denis Zvizdiq, i cili personalisht ishte para 35 viteve këtu në hapjen e Lojërave Olimpike në Sarajevë", theksoi Zaev. Ai shtoi se kjo ngjarje është e shkëlqyer, sepse e dërgon porosinë e sportit për unitet, bashkim, prezantim të të gjitha vendeve, kategorive të reja dhe të të rinjve të cilët vinë pas nesh. "Besoj se këto lojëra olimpike edhe një herë do t'i ndihmojnë gjithë Ballkanit, gjithë rajonit që të lëvizë përpara", theksoi kryeministri Zaev, i cili ishte i shoqëruar nga bashkëshortja Zorica.

# HIRUSHJA QË PO ÇMEND ARGJENTINËN, KLUBI I TRAJNERIT "ROCKSTAR" QË REFUZOI TË STËRVISTE MESSI & CO

Vit i ri, zakone të vjetra. Të paktën, në Argjentinë, ku 2019 ka nisur me reflektorët drejtuar te një "hirushe", thuajse e panjohur. Emër pak i gjatë dhe që të ngjan me një nga ato sloganët në sallat e gjyqit: mbrojtje dhe drejtësi: Defensa Y Justicia

Boca Juniors, River Plate, Estudiantes, Indipendiente... Harrojini këto emra. Në Argjentinë, hegjemonia ka kaluar, të paktën këtë vit, në duart e dy ekipeve që nuk gëzonin respekt dhe sidomos pritshmëri në fillim të sezonit. Tashmë, kanë krijuar shkëputje dhe që po garojnë për titullin kampion. Vit i ri, zakone të vjetra. Të paktën, në Argjentinë, ku 2019 ka nisur me reflektorët drejtuar te një "hirushe", thuajse e panjohur. Emër pak i gjatë dhe që të ngjan me një nga ato sloganët në sallat e gjyqit: mbrojtje dhe drejtësi: Defensa Y Justicia. Realitet i vogël në rajonqë vitet e fundit ka vendosur të shtrohet në sofrën e të mëdhenjve. "Defe", siç thërritet ndryshe, është një klub që nuk ka shumë gjëra për të ndarë me elitën e futbollit argjentinas: edhe pse ka një histori të rëndësishme pas krahëve - e nisur në vitin 1933 - vetëm kohët e fundit është afirmuar në Superligën argjentinase, por këtë sezon ka ndër mend që të lërë shenjë dhe shkruajë një faqe embelatike, tipi "Leicester" në Angli dy vite më parë.

Historia - 20 mars i vitit 1935... Katër djem që janë ulur në një trotuar në lagje dhe bisedojnë për futboll... Pak metra më larg, një fushë me dhe dhe një makinë e braktisur. Vendosin të organizohen dhe krijojnë një skuadër, e cila do të luante pikërisht aty, çdo të shtunë, me kundërshtarë të lagjeve të tjera ose qyteteve të tjera. Ideja i pëlqen, por nuk kanë një emër. Njëri propozon: "Podemos llamarlo Defenca Y Justicia, que pareces?!" ("Mund ta quajmë Mbrojtje dhe Drejtësi, si ju duket?"). Votimi mbyllet me 4 "pro" dhe asnjë kundër... Këtu nis historia e jashtëzakonshme e klubit që sot po mahnit Argjentinën. Për të kuptuar se "Def" e ka shumë seriozisht, mjafton të shkojmë t'i hedhim një sy klasifikimit: 17 ndeshje deri tani në kampionat dhe ende asnjë humbje. Madje, ecuri edhe më mirë se sa kryesuesi i kampionatit, Racing Club i Avejanedas. Me mbrojtjen më të mirë të turneut, Defensa është e vetmja që mund të ndjekë Racing, duke përfituar edhe nga fakti që shumë klube "big" kanë impenjime të tjera ndërkombëtare. As pushimi veror nuk ka ulur aspak interesin e gjeneruar nga ky klub i vogël model, një skuadër e cila që kur është ngjitur në Primera Division jo vetëm që ka arritur që të sigurojë mbijetesën për katër vite radhazi, por në dy sezonet e fundit ka debutuar edhe në Kupën AmerikanoJugore. Një triumf historik, i arritur falë vizionit të presidentit Jose Lemme dhe intuitës së Sebastian Beçacece, trajneri me "look" rockstar dhe ide taktike të veçanta.

Beccacece është 38 vjeç dhe është një nga trajnerët më të rinj në Argjentinë, vendi ku ka lindur dhe - pas një karriere modeste si futbollist - i ka dhënë mundësi të realizohet profesionalisht. Në pamje si Claudio Caniggia, me flokë të gjata dhe biond, nuk është e vetmja gjë që e bën të veçantë: trajner i shkollës "Bielsa", ka nisur si zëvendës i Jorge Sampaolit gjatë eksperiencës në Peru dhe, kur Bielsa i propozoi të bëhej zëvendës te Seleçion, pra Argjentina, refuzoi me mirësjellje pasi do të vijonte të respektonte kontratën me Sampaolin.

Mbërritja e tij te Defensa përkon me rritjen e klubit: Lemme, në 2016, i jep pankinën Beccaceces për të arritur objektivin mbijetesë, por ai bën edhe më shumë, duke e çuar klubin në Copa Sudamericana. Më pas, thirrja te Argjentina U-20, por nuk qëndron shumë, pasi i mungon përditshmëria dhe fusha. Te "Def" e presin krahëhapur dhe ai nuk mendohet dy herë. "Pranova të rimarr drejtimin e ekipit sepse besoj se mund të bëjmë gjëra të mëdha"

Një investim i rëndësishëm, sepse përpara firmës si trajner, argjentinasi vinte nga eksperienca në Kili, aty ku kishin punësuar mentorin e tij, Sampaoli. Te Universidad de Chile zgjat pak, aq sa lojtarët, stafi dhe ambjenti nuk lënë gjë pa i thënë dhe pa e sharë. Becacece "është një njeri nuk respekton njerëzit" shkruajnë të përditshmet kilene mes 2015 dhe 2016. Futbolli i tij është spektakolar, por edhe të shpenzon shumë energji, ndaj kërkon që intepretuesit të jenë në maksimum përherë. Te Defensa çdo gjë po funksionon siç duhet, duke konfirmuar edhe rritjen e një trajneri që humbi pak mes kritikave.

Strategjia - Idetë e tij futbollistike shkojnë "për dore" me mënyrën për të sulmuar jetën. Sapo mori në dorë "Def", Becacece varion një 4-3-3 ku nuk janë të pranishëm shumë yje, por lojtarë funksionalë të projektit. Klubi nuk ka shumë para për të investuar, ndaj përpiqet të marrë të paafirmuar, për t'i afirmuar. Por, te Defensa kanë një tjetër strategji: presidenti Lemme ka shtrënguar duart me të gjitha klubet "big" në Argjentinë, për të huazuar lojtarët që nuk gjejnë hapësira dhe për t'i rritur vlerën, duke i kthyer në shtëpi më pas. Në Florencio Varela, qytet me 400 mijë banorë, 38 km larg La Platas, këto vite kanë kaluar shumë djem të ardhur nga River Plate, Boca Juniors, Independiente, Velez dhe shumë ekipe të tjera. Atyre, drejtuesit e klubit i kanë shtuar një grup futbollistësh që janë më veteranë në moshë, por që duan trampolinën. Shënojini këto emra: Lisandro Martinez, Alejandro Barboza, Gaston Togni dhe Leonel Miranda. Do të dëgjojmë për ata. Defensa luan futbollin më të bukur në Argjentinë, bashkë me Racing, që humbi në përballjen me River Plate dhe tashmë mund të humbë terren, nëse skuadra e Becaceces do të fitojë ndeshjen e saj.

## NBA

### Warriors mposhtin Heat në frymën e fundit, fitojnë 76ERS dhe Mavericks

U luajtën 5 ndeshje në NBA, ku spikat fitorja në frymën e fundit e Golden State Warriors 120-118 në "Oracle Arena" ndaj Miami Heat. 5 sekonda para rënies së sirenës për përfundimin e takimit, kur rezultati ishte në ekuilibër të plotë 118-118, DeMarcus Cousins fitoi dy gjuajtje të lira, të cilat i realizoi me gjakftohtësi. Spikati në statistika Kevin Durant me 39 pikë, ndërsa Klay Thompson dhe Stephen Curry shtuan respektivisht 29 dhe 25 pikë. Për Miamin nuk morën vlerën e duhur 37 pikët e Richardson. Vjen fitorja e dytë radhazi e Philadelphia 76ers, pas marrveshjes për blerjen e Tobias Harris. Ish-basketbollisti i Los Angeles Clippers ishte një nga protagonistët e fitores shtëpiake ndaj Los Angeles Lakers me rezultatin 143-120. Joel Embiid spikati me "doble-double", plot 37 pikë dhe 14 topa të kontrolluar poshtë koshit, ndërsa Harris shtoi edhe 22 pikë të tjera. Lakers lanë për të dëshiruar në fazën mbrojtëse dhe kur LeBron James shënon vetëm 18 pikë, disfata është e paralajmëruar. Në këtë ndeshje nuk vlejtën as 39 pikët e Kyle Kuzmas. Luka Doncic vijon sezonin magjik në radhët e Dallas Mavericks, që edhe pse u ndodhën -14 pikë në fund të periodës së tretë, në fund arritën të triumfonin 102-101 ndaj Blazers. Talenti sllloven e mbylli takimin 28 pikë, 6 asistime dhe 8 "rebound", ndërsa Portlandi nuk diti të maksimizonte 30 pikët e Damian Lillard. Phoenix Suns pësuan humbjen e 14-të radhazi me shifrat 117-104 ndaj Sacramento Kings, ndërsa Atlanta Hawks kaluan me lehtësi 124-108 Orlando Magic.

# Nadal s'heq dorë nga ëndrra

Në Lojërat Olimpike "Rio 2016", spanjolli Rafael Nadal deklaroi se prania e tij pas 4 vitesh, në "Tokio 2020" nuk ishte e sigurtë. "Po shijoj këtë Olimpiadë, pasi mund të jetë e fundit për mua", tha asokohe tenisti spanjoll, që aktualisht është numri 2 në botë. Gjithsesi, 18 muaj nga Olimpiada japoneze, Nadal i ka të qarta idetë e tij: "Di që Olimpiada e Tokios do të jetë një tjetër event i jashtëzakonshëm, ndaj do të bëj maksimumin për të qenë pjesë e saj". Në këtë event olimpik mund të mungojnë Federer e Djokovic, pasi ata nuk janë dakord që të luajnë në Kupën Davis, eventi që të ofron mundësinë e vetme për të qenë në Olimpiadë. Nadal ka fituar dy medalja të arta në Lojërat Olimpike, një në lojën teke në Pekin dhe një në lojën dyshe, në Rio.

"Nuk e di nëse ata do të luajnë në këtë turne, që tani ka një format të ri. unë do të jem në Kupën Davis për të mbrojtur ngjyrat e Spanjës. E dua Olimpiadën dhe një tjetër medalje e artë aty do të ishte fantastike për mua", tha Nadal.

# SERIE A: CHAMPIONSI SI GARA PËR TITULL, PESË EKIPE "LUFTË" PËR DY BILETA

Lufta për të siguruar një vend në Champions sa vjen dhe bëhet akoma më e ndërlikuar. Inter, Milan, Atalanta, Roma dhe Lacio. 5 ekipe në garë për të marrë dy bileta. Aktualisht, kur kemi lënë pas 23 javë të luajtura, renditja tregon Interin të tretin me 43 pik, i cili ndiqet nga kushërinjtë e urryer të Milanit me 4 pikë më pak. Atalanta, Roma dhe Lacio, qëndrojnë së bashku pas Milanit, në kuotën e 38 pikëve

Në Serie A, lufta për të siguruar një vend në Champions sa vjen dhe bëhet akoma më e ndërlikuar. Inter, Milan, Atalanta, Roma dhe Lacio. 5 ekipe në garë për të marrë dy bileta. Aktualisht, kur kemi lënë pas 23 javë të luajtura, renditja tregon Interin të tretin me 43 pik, i cili ndiqet nga kushërinjtë e urryer të Milanit me 4 pikë më pak. Atalanta, Roma dhe Lacio, qëndrojnë së bashku pas Milanit, në kuotën e 38 pikëve. Thënë ndryshe, 5 ekipe ndahen nga 5 pikë. Ndeshjet deri në fund për t'u luajtur janë dhe 15, teksa këtë javë do të kemi përballjen direkte mes Atalantës dhe Milanit në Bergamo. Interi, me triumfin në ndeshjen e fundit ndaj Parmës ka treguar se po rikthehet. Ndërkohë, Milani dhe tre ndjekësët e tjera nuk gabuan në ndeshjet respektive, duke treguar se jemi futur në një fazë, ku gabimet nuk falen. Interi bëri një fillim sezoni perfekt, deri në atë pikë sa u mendua për një moment si ekipi anti-Juve, por muajt e fundit zikaltrit kanë rrëshkitur dhe tashmë kërkojnë të bëjnë gjithçka për të siguruar të paktën zonën Champions. Milani nga ana tjetër, duket një ekip i tjetërsuar këtë vit të ri. Ardhja e Paketës dhe Piatek, ka sjellë një entuziazëm të madh në ekipin e Gatuzos dhe kualifikimi për në Champions pas plot 6 vitesh do të ishte një arritje e madhe për "djallin". Atalanta po konsolidohet dhe po konfirmon veten vit pas viti. Bergamaskët e kanë treguar dhe në sezonet e fundit se janë një ekip solid dhe që e meritojnë një shpërblim për punën e bërë. Pse jo, ndoshta ky shpërblim mund të jetë kualifikimi për në Champions. Roma kishte vite që nuk ishte parë në ujërat që ndodhet sivjet. Verdhekuqtë bënë një nisje sezoni me mjaft uljengritje, ku përfunduan deri në vendin e 11-të për një periudhë. Tashmë, kryeqytetasit kanë rikuperuar dhe ndodhen vetëm një pikë larg Milanit, ku kërkojnë me çdo kusht dhe për një vit tjetër kualifikimin për në Champions. Për ta mbyllur me Lacion. Bardhekaltrit kanë akoma makthet e sezonit të kaluar, kur panë që ne minutën e 93-të t'u rrëshqiste i gjithë sezoni pas golit të Matias Vesinos. Ekipi i Inzagit është përsëri aty dhe këtë sezon, ku objektivi është i njëjti: kualifikimi për në Champions. 5 ekipe në garë për dy bileta. Me një Juventus, i cili duket nga një planet tjetër në Itali, titulli luhet për zonën Champions.

## United e ka vendosur, Solskjaer trajner me kohë të plotë

Ole Gunnar Solskjaer nuk do të jetë thjesht trajneri i përkohshëm i Manchester United. Sikurse raporton "The Sun", bordi drejtues ka vendosur që norvegjezi të emërohet me kohë të plotë, por ky vendim nuk do të bëhet zyrtar para përfundimit të sezonit. Drejtuesi i lartë i United, Avram Glazer, foli gjatë me teknikun pas fitores 3-0 me Fulhamin, duke qenë i bindur se Solskajer e meriton të vazhdojë në krye të "Djajve të Kuq". Familja Glazer ka patur si objektiv trajnerin aktual të Tottenhamit, Maurizio Pochetino, të cilit do t'i ofrohej një kontratë e majme për ta shkëputur nga Spursat. Por drejtuesit e klubit tashmë janë bindur plotësisht për aftësitë e Solskjaer, për punën e të cilit flasin vetë shifrat. Që kur mori drejtimin e skuadrës në muajin dhjetor, pas shkarkimit të Jose Mourinhos, United ka mundur të fitojë 10 nga 11 ndeshjet e zhvilluara. Barazimi i vetëm ishte ndaj Bunrleyt, 2-2 në "Old Trafford". Forma e jashtëzakonshme, e përkthyer në rezultate impresionuese, e ka katapultuar Manchester United në vendin e katërt, në zonën Champions, duke lënë pas Chelsea-n dhe Arsenalin.

## City ofron 75 milionë euro për Iscon

Isco pritet të largohet përfundimisht nga Real Madridi gjatë verës që vjen Manchester City është duke e përgatitur një ofertë të majme prej 75 milionë eurosh për ta bindur Real Madridin që t'ia shesë Iscon. Trajneri Pep Guardiola e do një zëvendësues afatgjatë të David Silvas, i cili i ka mbushur tashmë 33 vjet. Dhe mesfushori kualitativ i Realit është në krye të listës së dëshirave të kampionit spanjoll. Isco është i pakënaqur në "Santiago Bernabeu" pasi nuk po ka hapësira të mjaftueshme në ekipin e Santiago Solarit. Andaj largimi i tij gjatë verës duket se është i pashmangshëm.

## Salah ose Asensio në vend të Dybalas

Juventusi i ka zgjedhur dy pista të rëndësishme për pasardhësin e sulmuesit argjentinas. Juventusi po mendon qysh tash për pasardhësin e Paulo Dybalas. Sulmuesi argjentinas mund të largohet gjatë verës nga Torino dhe interesim për të kanë shprehur Interi dhe Real Madridi. Dhe, në rast se mbetet pa ish-sulmuesin e Palermos, kampioni italian i ka në opsion Mohamed Salahun e Liverpoolit dhe Marco Asension e Real Madridit. Që prej transferimit të Cristiano Ronaldos në Juventus, Dybala ka mbetur nën hije të portugezit. Prandaj, largimi i

tij duket i pashmangshëm. Ronaldo e rekomandon Asension si zëvendësues të argjentinasit, pasi ka luajtur me të në Madrid, por ylli i Liverpoolit është po ashtu në radarin e "Bianconeri".

## "Sarri out", sondazhet vendosin legjendën angleze në krye të Chelsea

Ecuria negative e skuadrës dhe një shpërfytyrim 6-0 në fushën e Manchester City janë shumë për një skuadër si Chelsea. Për këtë, e ardhmja e trajnerit Sarri është vënë në pikëpyetje të madhe. Metoda e lojës së tij, e njohur si "Sarri ball" nuk po jep efekt dhe skuadra është në pikiatë duke përfunduar në vend të gjashtë të Premier League. Kompanitë e basteve në Angli kanë filluar të vendosin kuotat për pasuesin e italianit në krye të "Bluve" të Londrës.

Në krye të listës qëndron emri i Frank Lampard, i cili ka bërë një punë të shkëlqyer me Derby Country në Championship, që në vitin e parë të tij si trajner. Lampard është vendosur si alternativa me koeficientin më të ulët për të marrë drejtimin e Chelsea, ndërsa pas tij renditet Zinedine Zidane. Ndërkohë që surprizë është emri i Jose Mourinho, i cili është renditur i treti, për një rikthim të mundshëm te Chelsea pas shkarkimit që i bëri Manchester United. Emra të tjerë që janë përfshirë në këtë listë është edhe trajneri i Francës, Didier Deschamps dhe ai i Wolves, portugezi Nuno.

# NGA NEYMAR TE HARRY KANE, CHAMPIONSI RIFILLON PA DISA NGA YJET KRYESORË

Rikthehet Liga e Kampionëve, me fazën e "nokaut"-it, ku na presin duele interesante. Sytë janë nga yjet e ekipeve, veçanërisht, por disa prej tyre nuk do të jenë në gjendje të luajnë, të paktën ndeshjen e parë të 1/8 finale, pasi janë të lënduar

Këtë mesjavë rikthehet Liga e Kampionëve, me fazën e "nokaut"-it, ku na presin duele interesante. Sytë janë nga yjet e ekipeve, veçanërisht, por disa prej tyre nuk do të jenë në gjendje të luajnë, të paktën ndeshjen e parë të 1/8 finale, pasi janë të lënduar. Gjithsej bëhet fjalë për 40 lojtarë të lënduar, përveç ndryshimeve të këtij numri të madh në minutën e fundit.

**OLYMPIQUE LYON – BARCELONA -** Skuadra franceze ka vetëm një mungesë, por që nuk ndikon në formacionin fillestar. Ai është sulmuesi i ri 18-vjeçar, Gouiri Amine, i cili nuk e ka bërë debutimin e tij këtë sezon, pas problemeve me ligamentin krucial. Barcelona, nga ana tjetër, nuk e ka të gatshëm Rafinha, i cili nuk luan prej një kohe disi të gjatë. Lojtari nuk është federuar për pjesën tjetër të garës. Kthimi i Samuel Umtiti në mbrojtje mbetet ende një mister. Së fundi, katalanasit nuk mund të llogarisin edhe Jasper Cillessen, nëse diçka e papritur ndodh me Marc-André Ter Stegen. Mungesa më e ndjeshme duket ajo e Arthur, i cili e kapi shpejt formacionin e Ernesto Valverde.

**MANCHESTER CITY - SCHALKE -** Ekipi i Pep Guardiolës nuk do të ketë mungesa të rëndësishme. Kiliani Claudio Bravo dhe mbrojtësi qendror, Vincent Kompany, janë të vetmit lojtarë në infermieri, edhe pse nuk i prishin punë trajnerit katalanas. Schalke 04, nga ana tjetër, ka mungesa më të ndjeshme. Stambouli dhe Embolo janë dy lojtarët kryesorë, që nuk do të jenë në ndeshjen e parë. Atyre duhet t'u shtojmë edhe mungesat e Schöpf, Skrzybski dhe Burgstaller.

**ATLÉTICO MADRID – JUVENTUS -** Të dy, Simeone dhe Allegri, nuk duhet të bëjnë pa lojtarë shumë të rëndësishëm në ndeshjen e parë. Atlético Madrid tashmë mund të llogarisë edhe Saviç, Koke e Diego Costa, kështu që trajneri argjentinas do ta ketë të gjithë skuadrën në dispozicion. Juventusi duket në një situatë të ngjashme, sepse tridenti BBC i mbrojtjes duket gati për lojë. Lajmet nga kampi bardhezi ëjnë me dije se janë riaftësuar Chiellini, Barzagli dhe Bonucci, të cilët kanë pasur probleme kohët e fundit. Humbja e vetme e konfirmuar për ndeshjen është ajo e kolumbianit Cuadrado.

**LIVERPOOL - BAYERN MUNICH -** Klopp nuk do të jetë në gjendje të bazohet te qendrori Joe Gómez në "Anfield". Trajneri gjerman nuk llogarit as Oxlade-Chamberlain, me dëmtim të hershëm të ligamenteve. Te Bayern Munich, Thiago i ka tejkaluar tashmë problemet e tij muskulore. I vetmi që do të mungojë është Tolisso, me probleme të ligamenteve.

**TOTTENHAM - BORUSSIA DORTMUND -** Pochettino ka një ndeshje të vështirë kundër Borussia Dortmundit. Trajneri i Tottenham ka të dëmtuar Delle Alli dhe Harry Kane, ndoshta lojtarët më të mirë. Ngushëllim përbën danezi Christian Eriksen, i cili do të jetë në dispozicion. Ekipi gjerman ka humbur dy pjesë të rëndësishme, qendrorin Manuel Akanji dhe kapitenin Marco Reus.

**ROMA – PORTO -** Roma do të duhet të luajë me portierin zëvendësues, pasi Robin Olsen është dëmtuar. Të tilla problemeve iu shtohen edhe emrat e Perotti në sulm, aty ku edhe Schick do të mungojë. Kësisoji, reparti ofensiv mund të përbëhet nga treshja Dzeko-Kluivert-El Shaarawy. Te Porto, e njëjta gjë ndodh me pjesën e përparme të skuadrës. Dy sulmuesit e saj më të mirë, Marega dhe Aboubakar, nuk janë gati, as meksikani Jesus Corona, i pezulluar nga UEFA për ndeshjen e parë.

**MANCHESTER UNITED – PSG** - Manchester United, i cili nuk e njeh humbjen nën drejtimin e Solskjaer, e ka tërë skuadrën në dispozicion për të përballuar një nga duelet më të mrekullueshme të raundit të dytë të Champions-it. PSG-ja, në teori favorite, do të duhet të bëjë pa dy yjet e veta. Mungesa e Neymar ishte e njohur prej gati dhjetë ditësh, por asaj i është shtuar së fundi uruguajani Edinson Cavani.

**AJAX - REAL MADRID -** Klubi holandez ka katër "viktima", edhe pse nuk kemi të bëjmë me futbollistë thelbësorë. Ata nuk do të jenë në ndeshjen e parë kundër Real Madridit: Varela, Magallán, Eiting dhe Bandé. Klubi i bardhë, nga ana tjetër, nuk do të ketë në dispozicion Luca Zidane, Jesús Vallejo dhe Marcos Llorente. Isco, i cili pavarësisht se nuk hyn në planet e Solarit, është mënjanë grupit me një problem, ndoshta të shkaktuar nga stresi. Kësisoji, ylli spanjoll nuk do të grumbullohet.



## Nuk ka probleme mes Interit dhe Icardit

Beppe Marotta i ka siguruar tifozët e Interit se vazhdimi i kontratës së Mauro Icardit nuk është aspak problem, duke premtuar se do ta menaxhojë këtë situatë në mënyrën më të mirë. Icardi është në bisedime me Interit për vazhdimin e kontratës, por raportohet se ai mund ta mos e nënshkruajë vazhdimin e kontratës, me trajnerin Luciano Spallettin dhe agjenten dhe bashkëshorten e tij, Wanda Nara, që kanë bërë deklarata publike për këtë. Madje, Wanda tha se Interi nuk është duke e mbrojtur mjaftueshëm sulmuesin argjentinas. "Fitorja ndaj Parmës ishte e rëndësishme dhe bindëse. Ekipi dhe trajneri performuan mirë. Ne rigjetëm vetëbesimin tanë dhe pashë një Nainggolan dhe Perisic në formë të mirë", tha Marotta. "Kam folur me Spalletin në telefon dhe do ta flas me të prapë nesër. Do ta menaxhojmë situatën në mënyrën më të mirë në interes të secilit. Rinovimi i Icardit nuk është aspak problem", shtoi ai. Ai insistoi se nuk do të ketë probleme në këtë drejtim dhe se vetë ai do të kujdeset për ta rregulluar këtë situatë.

## Ilicic i Atalantës, sinjale "dashurie" Romës

Një nga lojtarët më të mirë të Atalantës këtë sezon ka qenë pikërisht slloveni Josip Ilicic. I lidhur shpesh me zërat rreth merkatos, mesfushori i avancuar ka zbuluar së fundmi se edhe Roma është një nga ekipet që ka kërkuar shërbimet e tij, por marrëveshje mes palëve nuk pati. Ilicic deklaroi se atij do t'i pëlqente të vishte fanellën verdhekuqe, por gjithsesi në Bergamo ndihet shumë mirë. 31-vjeëari u bashkua me Atalantën në verën e vitit 2017, ndërkohë që kontrata e tij përfundon në qershor të vitit të ardhshëm.

**DASHI** — **21. mars - 20. prill**

Do ëndërroni me shumë nga sa duhet sot! I te dashuraritë dhe realiteti do ju duket akoma me zhgënjyes. Ata që kane pasur zëmka do vazhdojnë të jetojnë ne një ambient elektrizues. Begaret me mire te ëndrojnë edhe sot ashtu si janë sepse mundësitë me te mira do jene pas disa ditësh. Financat do jene interesante dhe tejet delikate. Mos kryeni asnjë lloj shpenzimi.

**DEMI** — **21. prill - 21. maj**

Ndajini te gjitha mendimet dhe idetë që keni për lidhjen ne çift sot dhe mundohuni që për gjithçka te bashkëpunoni se bashku. Begaret do jene te ngarkuar me pune dhe nuk do kenë mundësi te dalin me personat që do i fto jnë. Me financat treguhuni sa me vëgjilente që te mundeni te paktën derisa gjendja te stabilizohet disi. Ju mund ta bëni këtë.

**BINJAKET** — **22. maj - 21. qershor**

Do mbyllen ne vetvete sot! I te dashuraritë dhe nuk do keni një marrëdhënie te mire me partnerin. Begaret do kërkojnë pa fund dhe ne çdo vend që do shkojnë për princin e tyre te kalter. Vetëm një pjese e vogël do mund t'ia arrijë qëllimit. Gjendja e financave do jete krysisht e kënaqshme për shkak te ndihmës se madhe që do ju ofrojnë disa te afërm.

**CAFORRJA** — **22. qershor - 22. korrik**

Nëse keni nevojë për me shume liri ne jetën tuaj ne çift sot, duhet t'ia kërkoni partnerit dhe jo te veproni sipas mendjes suaj. Begaret do ndihen te qete dhe do joshin çdo person që do ju duket interesant. Shume gjera kane për te ndodhur sot. Gjendja e financave do jete goxha me e qëndrueshme dhe kjo fale ndihmës se madhe te familjarëve te cilët duan me te mirën për ju.

**LUANI** — **23. korrik - 22. gusht**

Do jeni te zënë me pune sot! ju te dashuraritë dhe do e lini pas dore jetën ne çift. Është mire që te flisni hapur me partnerin ne mënyrë që te mos lindin keqkuptime te kota. Begaret duhet ta leni veten te lire dhe te bëjnë atë që do ju thotë zemra për momentin. Sektori i financave nuk do ketë asnjë lloj tronditjeje për shkak te mashtrisë që keni tregua r gjithë këtë kohe.

**VIRGJERESHA** — **23. gusht - 23. shtator**

Do jeni me te vendosur se kurrë sot te bëni disa ndryshime rrënjësore te jetës ne çift dhe falë bashkëpunimin me partnerin do arrini atje ku keni dashur. Për begaret do jete një dite normale dhe pa takime te rëndësishme. Beni edhe pak me tepër durim. Ne planin financiar do jeni me te organizuar dhe do mateni mire para se te kryeni shpenzime te konsiderueshme.

**PESHORJA** — **24. shtator - 23. tetor**

Planetët do ju ndihmoje gjate gjithë kohës sot për te zgjidhur problemet që keni pasur ne çift prandaj do ndihemi me te qete. Edhe begaret do ndikohen pozitivisht nga yjet dhe mund te gjejnë person që kane ëndërruar gjithë këtë kohe. Buxheti do jete i turbullt dhe delikat. Po shpenzuat kuturu dhe po ju dhatë para hua miqve, ka mundësi te mbetemi pa para.

**AKREPI** — **24. tetor - 22. nëntor**

Do e adhuroni me shume se kurrë sot atë që keni ne krah dhe do jeni te gatshëm te bëni çdo llloj sakrifice që gjenat te ecin sa me mire. Begaret duhet t'i bëjnë syrë katër ne mënyrë që te gjejnë personin me te përshtatshëm. Po u mbyllen ne shtëpi e te presin do mbeten si janë. Me financat duhet te mos luanë dhe te mos rrezikoni. Do pendohemi shpejt për gabimet e bëra.

**DASHI** — **21. mars - 20. prill**

Do ëndërroni me shumë ngë sa duhet sot! ju te dashuraritë dhe realiteti do ju duket akoma me zhgënjyes. Ata që kane pasur zëmka do vazhdojnë te jetojnë ne një ambient elektrizues. Begaret me mire te ëndrojnë edhe sot ashtu si janë sepse mundësitë me te mira do jene pas disa ditësh. Financat do jene interesante dhe tejet delikate. Mos kryeni asnjë llojë shpenzimi.

**DEMI** — **21. prill - 21. maj**

Ndajini te gjitha mendimet dhe idetë që keni për lidhjen ne çift sot dhe mundohuni që për gjithçka te bashkëpunoni se bashku. Begaret do jene te ngarkuar me pune dhe nuk do kenë mundësi te dalin me personat që do i fto jnë. Me financat treguhuni sa me vëgjilente que te mundeni te paktën derisa gjendja te stabilizohet disi. Ju mund ta bëni këtë.

**BINJAKET** — **22. maj - 21. qershor**

Do mbyllen ne vetvete sot! ju te dashuraritë dhe nuk do keni një marrëdhënie te mire me partnerin. Begaret do kërkojnë pa fund dhe ne çdo vend que do shkojnë për princin e tyre te kalter. Vetëm një pjese e vogël do mund t'ia arrijë qëllimit. Gjendja e financave do jete krysisht e kënaqshme për shkak te ndihmës se madhe que do ju ofrojnë disa te afërm.

**CAFORRJA** — **22. qershor - 22. korrik**

Nëse keni nevojë për me shume liri ne jetën tuaj ne çift sot, duhet t'ia kërkoni partnerit dhe jo te veproni sipas mendjes suaj. Begaret do ndihen te qete dhe do joshin çdo person que do ju duket interesant. Shume gjera kane për te ndodhur sot. Gjendja e financave do jete goxha me e qëndrueshme dhe kjo fale ndihmës se madhe te familjarëve te cilët duan me te mirën për ju.

**LUANI** — **23. korrik - 22. gusht**

Do jeni te zënë me pune sot! ju te dashuraritë dhe do e lini pas dore jetën ne çift. Është mire que te flisni hapur me partnerin ne mënyrë que te mos lindin keqkuptime te kota. Begaret duhet ta leni veten te lire dhe te bëjnë atë que do ju thotë zemra për momentin. Sektori i financave nuk do ketë asnjë llojë trondityje për shkak te mashtrisë que keni tregua r gjithë këtë kohe.

**VIRGJERESHA** — **23. gusht - 23. shtator**

Do jeni me te vendosur se kurrë sot te bëni disa ndryshime rrënjësore te jetës ne çift dhe falë bashkëpunimin me partnerin do arrini atje ku keni dashur. Për begaret do jete një dite normale dhe pa takime te rëndësishme. Beni edhe pak me tepër durim. Ne planin financiar do jeni me te organizuar dhe do mateni mire para se te kryeni shpenzime te konsiderueshme.

**PESHORJA** — **24. shtator - 23. tetor**

Planetët do ju ndihmoje gjate gjithë kohës sot për te zgjidhur problemet que keni pasur ne çift prandaj do ndihemi me te qete. Edhe begaret do ndikohen pozitivisht nga yjet dhe mund te gjejnë person que kane ëndërruar gjithë këtë kohe. Buxheti do jete i turbullt dhe delikat. Po shpenzuat kuturu dhe po ju dhatë para hua miqve, ka mundësi te mbetemi pa para.

**AKREPI** — **24. tetor - 22. nëntor**

Do e adhuroni me shume se kurrë sot atë que keni ne krah dhe do jeni te gatshëm te bëni çdo llojë sakrifice que gjenat te ecin sa me mire. Begaret duhet t'i bëjnë syrë katër ne mënyrë que te gjejnë personin me te përshtatshëm. Po u mbyllen ne shtëpi e te presin do mbeten si janë. Me financat duhet te mos luanë dhe te mos rrezikoni. Do pendohemi shpejt për gabimet e bëra.

**SHIGJETARI** — **23. nëntor - 21. dhjetor**

Te gjithë planetët do ua mbrojnë sot jetën sentimentale dhe e arkhinja do jete me e vegjante. Ne çdo moment do ja shprehni ndjenjat partnerit dhe do ndihemi për mrekullli. Begaret do kenë dashuri me shikim te pare que ne orët e para te mëngjesit. Ne planin financiar nuk do ketë probleme dhe kjo per shkak te masave que keni marre se fundmi.

**BRIGJAPI** — **22. dhjetor - 20. janar**

Përpara se te merrni vendime te rëndësishme për jetën tuaj ne çift, duhet te reflektoni gjere e gjate sot. Jeta nuk është loje dhe po u rezuat njëherë është e vështirë te ringrihemi. Begaret do vazhdojnë ende te ëndërojnë për princin e kalter. Ne planin financiar tregohuni sa me te matur me çdo shpenzim que do kryeni ne mënyrë que te mos keni probleme dhe vështirësi.

**UJORI** — **21. janar - 19. shkurt**

Do përjetoni emocione te forta sot ne jetën tuaj sentimentale dhe do ndihemi me mire se kurrë me pare. Edheata que janë vetëm do kenë një dite te veçante dhe tejet te rëndësishme. Ne orët e mesditës mund te hetë edhe takime impresionuese que do i lënë me sy hapur. Ne planin financiar do ju gjeni zgjidhje te gjitha telashevë que keni pasur dhe do jeni te qete.

**PESHQIT** — **20. shkurt - 20. mars**

Ju qe jeni ne një lidhje mos mendoni për asnjë moment t'i hidhni syrë dikë tjetër sepse do keni probleme seriozë me partnerin dhe mund te shkoni deri ne ndarje. Begaret do fiksohen pas dikuj t dhe nuk do pranojnë asnjë fterë tjetër que do ju behet. Ky do jete gabim sepse me atë nuk kane asgjë te sigurte. Financat do jene me te mira për shkak te mënyrës sua j organizative.

# Sudoku

zhanrë: i lehtë

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | | 7 | | 2 | 3 | | | |
| | | | | | | 2 | | |
| | 1 | 5 | 6 | | | | | |
| 5 | | | 1 | | | | | |
| 2 | | | | | | 4 | | |
| 3 | 4 | 6 | | | | 1 | 5 | 2 |
| | 5 | | | | | | | 3 |
| | 7 | | | 3 | | | 2 | 1 |
| | | | | 8 | 4 | | | |
| | | | 1 | 9 | | 4 | | 8 |

mesatar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 6 | 4 | | 5 |
| | | 4 | | | | | | |
| | | 6 | 5 | | | | 3 | 1 |
| 1 | | 7 | 6 | | 9 | | | |
| 2 | 8 | | | | | | 7 | 6 |
| | | | 8 | | 7 | 1 | | 3 |
| 6 | 7 | | | | 1 | 2 | 8 | |
| | | | | | | | | |
| 3 | | | 2 | 7 | | | | |

**Shumë i lehtë:** 467823519, 981567234, 523419786, 219356847, 346978152, 758241693, 874635921, 192784365, 635192478. **Mesatar:** 831964725, 524713698, 796582431, 157639842, 283145976, 469827153, 675391284, 912458367, 348276519.

**ZGJIDHJET:** THELE, ETUR, MRIZ, ZEUSI, LSR, P, KUKEL, KAPROLLE, NI, ABA, ROSTOK, PESHKOPIA, E, PASTEL, IBAN, BURGU FREN, LAI, KRELOJ, ARKA, ENARE, N, URINORET, KI, ABISE, O, ANATEMË, IJ.

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mensur Mamuti** | ZBULIMI I SPERMARRËSIT NË FOTO | P.JESËTAR I NJË POPULSIE TË VJETËR (NË TOSKANËN E SOTME) | SPERMARRËSI FRENG (NË FOTO) | NDERI (VJET.) | | | | | | | |
| GOZHDË E MADHE (SH. PASHQ.) | | | | | | | | | | | |
| ETSHËM | | | | | | | | | | | |
| VËND I FRESKËT PËR BAGETË, HUE | | | | | | | | | | | |
| ZOTI SUPREM I GREKËVE | | | | | | | | | | | |
| Z | | | | | | | | | | | |
| LABEL SWITCH ROUTER | | | | | | | | | | | |
| TRAJNERI GJER-MAN, JVRGEN | | | | | | | | | | | |
| ALGA QË JETOJNË NË LËVORET E DRUREVE | | | | | | | | | | | |




| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **KOHA** | PABESUESHËM SHAHISTI KUBAN, HOZE | P | MAL NË KOSOVË | REOMIRI | FSHAT NË SHKODËR (PASHQ.) ISHULL KORAL NË MIKRONEZI | | | | | | |
| FEMRA E KAPROLLIT, SORKADHE | | | | | | | NIKEL TË DHËNA QË PARAQITEN ME TABELA | | | | |
| SHJAJAK PËR TIRQ | | | | SHTET NË GJERMANI LLOJI FUQIE E VOGËL | | | | | | | |
| QYTET NË SHQIPËRI LLOJI NGJYRE PËR PIKTURIM | | | | | | | ENERGJIA QILIMI I VOGËL QE SHTROHET ANES VATRËS | | | | |
| P | | | | | NUMRI NDËRKOM. BETAR I LLOGARISË BANKARE NDALIM I VETURËS | | | | | | |
| VENDVEKJA E ZBULUESIT NË FOTO (I AKUZUAR PËR BASHKËPUNIM ME NAZITË) | | | | | | | | | | | JAM NË JETË, RROJ |
| REGJISORI TALVANO-AMERIKAN, STEN | | | | BËJ KAÇURRELA, DREDH FLOKET TOKAT E PUNUARA | | | | | | | |
| KASAFORTA | | | | | LIGEN NË FINLANDË AKTIVISTJA PALIKUQI | | | | | | |
| AZOTI | | PISOARET INDIUMI | | | | | | | | | |
| KËRÇOVA | | | | HUMNERA, HONE ATOMI | | | OZONI INTENSITETI | | | | |
| MALLKIM KISHTAR | | | | | | | SHKRONJA FOINJE | | | | |

# BLEN ARKIVOLIN PËR T'U "PËRGATITUR", DHE ËSHTË MË E SHËNDOSHË SE KURRË

Një grua ka postuar në rrjetet sociale një fotografi në të cilën shihet se duke blerë një arkivol për vete, edhe pse ajo është më e shëndoshë se kurrë më parë. Zodwa Wabantu, nga Afrika e Jugut, ka postuar foton në Instagram ku shihet duke provuar një arkivol të shtrenjtë dhe kjo ka shkaktuar konfuzion mes ndjekësve të saj. "Vdekja! Shoqëria është aq shumë e frikësuar për të folur rreth vdekjes. Të gjithë do të vdesim, dhe unë mora një vendim për të blerë arkivolin tim ndërsa jam ende gjallë. Kushton 8.540 funte", ka shkruar ajo në Instagram, shkruan Mirror.

Edhe pse vendimi i saj për blerjen e arkivolit duket shumë bizar, në fakt ka një arsye të dhimbshme pse e ka bërë këtë. Duke folur për Tshisa Live, Wabantu ka sqaruar se kur nëna e saj ka ndërruar jetë ajo është varrosur me një arkivol të lirë dhe se këtë nuk e donte për veten. Gjithashtu, ajo shtoi se nuk dëshiron që familja e saj, veçanërisht djali i saj, të mundohen së bashku që të mbledhin paratë për shpenzimet funerale nëse do t'i ndodhte asaj ndonjë gjë. "Kur e varrosëm nënën time, ishte një gjë e tmerrshme. Ajo është varrosur në një arkivol të lirë", tregoi ajo për Tshisa Live. Ndjekësit e saj në Instagram ka reaguar shumë në lidhje me këtë blerje të saj të pazakonshme.

## Pikturat e Hitlerit nuk i blen asnjë!

Polemika për pesë piktura që i atribuohen Adolf Hitlerit, në një ankand në Nuremberg. Çmimet e relikeve naziste varionin nga 19 mijë deri në 45 mijë euro. Asnjë blerës nuk është gjetur deri më tani, por shtëpia e ankandit "Weidler" nuk ka komentuar për arsyen e dështimit dhe ka njoftuar se pikturat do të ripropozohen në një datë të mëvonshme. Kryebashkiaku i Nurembergut, Ulrich Maly, kishte dënuar më parë shitjen, duke e quajtur atë "një shije të keqe". Shfaqjet publike të simboleve naziste janë të ndaluara me ligj në Gjermani, përveç disa rasteve, si ato arsimore apo historike.

## Alfa Romeo i vitit 1939 shitet për gati 17 milionë euro

Modeli legjendar i Alfa Romeos, 8C 2900B Touring Berlinetta, përmes shtëpisë së ankandit Artcurial Motorcars për veturat e vjetra është shitur me një çmim marramendës prej 16.745.600 euro. Ky model i vitit 1939 ishte pronë e koleksionistit të njohur holandez, Jan-Willem Martnes, për 42 vjet rresht. Çmimet kaq të larta nuk kanë të bëjnë vetëm me modelet e Ferrarit apo modeleve të ngjashme klasike dhe përveç 8C 2900B Touring Berlinetta, Alfa Romeo ka konfirmuar se ky model nuk është i vetmi që është shitur me çmim marramendës. Së fundmi, një tjetër model, Alfa Romeo 8C 2900B Lungo Spider Touring i vitit 1939, me një çmim prej 23 milionë euro, është bërë vetura e shitur me çmim më të lartë ndonjëherë në botë.

## Dhëndri nuk i qëndron besnik nuses as në dasmë

Një i ri i sapomartuar po përballet me një listë akuzash në Pennsylvania të SHBA-ve pasi akuzohet se ka sulmuar seksualisht një kameriere adoleshente në dasmën e tij. 31-vjeçari Matthew Aimers nga Willingboro i Pennsylvanisë përfundoi në pranga të mërkurën e kaluar pas një përvoje të dhunshme dhe kaotike në dasmën e tij gjatë muajit Nëntor.

Sipas "USA Today", policia tha se Aimers iu afrua kamerieres adoleshente në "Northampton County Club" gjatë dasmës së tij dhe i propozoi për seks. Pas refuzimit, dhëndri akuzohet se e ka ndjekur më vonë gjatë natës kamerieren në banjë ku edhe e ka sulmuar seksualisht. Dhëndri më pas akuzohet se ka nisur grindjet me shumë persona të tjerë para se të sulmonte verbalist edhe policinë. Mes të tjerash, tanimë 31-vjeçari përballet me akuzat për sulm seksual dhe mbajtje me force në ambiente të mbyllura të një minoreneje.

Matthew Aimers u lirua me kusht po të mërkurën pasi dorëzoi në polici një garanci prej 35 000 dollarësh. Seanca e parë gjyqësore ndaj tij pritet të zhvillohet me 21 Shkurt në Philadelphia.

## KALENDARI HISTORIK 12 SHKURT

1502 - Myslimanët e Granadës detyrohen të konvertohen në të krishterë.

1502 - Vasco da Gama fillon lundrimin e tij të dytë prej Lisbone për në Indi.

1771 - Gustav III emërohet Mbreti i Suedisë.

1818 - Kili fiton pavarësinë nga Spanja

1876 - Spalding hap shitoren për pajisje sportive.

1921 - Trupat sovjetike pushtojnë Gjeorgjinë.

1925 - Estonia ndalon Partinë Komuniste.

1934 - Fillon lufta civile në Austri.

1950 - Albert Einstein paralajmëron për bombën hidrogjenike.

1963 - Argjentina kërkon ekstradimin e ish kryetarit Peron.

2002 - Fillon gjykimi i ish Kryetarit të Republikës Federative të Jugosllavisë, Sllobodan Millosheviq në Tribunalin e Hagës.

## A E DINI SE...

### MARGARINA SHKAKTON DEPRESION

"Margarina nxit depresionin", ndërsa gjalpi "ndikon pozitivisht në të mësuarit", tregon një hulumtim i zhvilluar nga shkencëtarët e Fakultetit të Mjekësisë në Universitetin "Dokuz Eylül" në qytetin perëndimor të Turqisë, Izmir. Prof. Dr. Nazan Uysal Harzadın nga Fakulteti i Fiziologjisë, në një prononcim për Anadolu Agency (AA), foli lidhur me hulumtimin e zhvilluar mbi minjtë. Ajo tregoi se kanë ushqyer minjtë me ushqime që kanë 10 për qind vajra dhe kanë hulumtuar se si këto vajra ndikojnë në sjelljen e tyre. Harzadın potencoi se si rezultat i punimit shkencor, kanë vërejtur se në rastet kur kanë përdorur vaj luledielli, kanë konkluduar se niveli i depresioni dhe ankthit është më i lartë.

"Kur i vendosnim kafshët në mekanizëm, nuk mundeshin të vendosin se ku të shkojnë. Kështu që mendojmë se vaji i luledielli ndikon negativisht në korteksin prefrontal, gjegjësisht pjesën për vendime të trurit", tha Harzadın. "Niveli i ankthit tek kafshët që konsumojnë vaj ulliri është tejet i ulët. Këto kafshë ishin të rehatshme, të relaksuara. Gjithashtu edhe kapaciteti i të mësuarit ishte i lartë tek ato", shtoi ajo. Ajo theksoi se periudha kohore e testimit tek minjtë prej 2 muajsh, korrespondon me 10 vite tek njeriu. Harzadın, gjithashtu duke folur për hulumtimin e bërë me margarinë, tha se në këtë kategori rezultatet janë "dëshpëruese"."Simptomat e depresionit më lartë ishin në këtë grup", tha Harzadın.

## THËNIA E DITËS

Pakica gjithmonë nuk është e detyruar të pajtohet me mendimin e shumicës.
**(Bizmarku)**